

VENDIM
Nr. 847, datë 26.12.2024

PËR MIRATIMIN E STRATEGJISË AFATMESME TË TË ARDHURAVE
DHE PLANIT TË VEPRIMIT 2024–2027

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e Strategjisë Afatmesme të të Ardhurave dhe planit të veprimit 2024–2027, sipas dokumentit që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Ngarkohen Ministria e Financave dhe institucionet përgjegjëse, sipas përcaktimeve, referuar dokumentit strategjik dhe planit të veprimit, për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

STRATEGJIA AFATMESME E TË ARDHURAVE 2024–2027 DHE PLANI I VEPRIMIT
2024–2027

Tabela e përmbajtjes

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

I. Hyrje

II. Nevoja për hartimin e Strategjisë Afatmesme të të Ardhurave

II.1 Përputhshmëria me qëndrueshmërinë fiskale

II.2 Problematika e identifikuar në “pajtueshmërinë tatimore”

II.2.1 Rritja e pajtueshmërisë vullnetare të tatimpaguesve

II.2.2 Politikat tatimore – Përgjashtimet dhe normat e reduktuara

II.3 Politikat fiskale të ndërmarra gjatë 2013–2023-shit

II.4 Bashkëpunimi me FMN-në, lidhur me Strategjinë Afatmesme të të Ardhurave, 2019–2023

III. Vizioni, qëllimet dhe objektivat e Strategjisë Afatmesme të të Ardhurave

III.1 Vizioni dhe qëllimet e SAA-së

III.2 Objektivat e SAA-së

III.3 Përmbledhja e Strategjisë së të Ardhurave

III.1 Përputhshmëria e Strategjisë me Dokumentet Strategjike

IV. Shtylla 1: Rishikimi i politikave tatimore

IV.1 Hyrje

IV. 2 Komponenti 1.1 Rishikimi i politikës tatimore të tatimeve indirekte (taksave mbi konsumin)

IV.3 Komponenti 1.2 Rishikimi i politikës tatimore lidhur me tatimet dhe taksat direkte

IV.3 Komponenti 1.3 Rishikimi i politikës tatimore të taksës mbi pasuritë e paluajtshme

V. Shtylla 2 Mirëadministrimi Tatimor

V.1 Hyrje

V.2 Komponenti 2.1 Zvogëlimi i hendekut të pajtueshmërisë në lidhje me TVSh-në

V.3 Komponenti 2.2 Ulja e pagesave me para në dorë në ekonomi

V.4 Komponenti 2.3 Verifikimi i të ardhurave dhe kontrolli i pasurive të pajustificuara

V.5 Komponenti 2.4 Zvogëlimi i shmangies tatimore

V.5 Komponenti 2.5 Reduktimi i punës së padeklaruar dhe nëndeklarimit të pagës reale

V.6 Komponenti 2.6 Reduktimi i kostove të pajtueshmërisë dhe rritja e besimit tek administrata tatimore

V.6 Komponenti 2.7 Përmirësimi i cilësisë së shërbimit të ofruar nga administratës tatimore nëpërmjet zhvillimit të kapaciteteve institucionale

VI. Shtylla 3: Mirëadministrimi doganor

VI.1 Hyrje

VI.2 Komponenti 3.1 Modernizimi i proceseve të biznesit, duke përfshirë centralizimin e funksionit të profilizimit të riskut

VI.3 Komponenti 3.2 Zhvillimi i aftësive të zgjeruara analitike të të dhënave

VI.4 Komponenti 3.3 Rritja e investimeve në zhvillimin e sistemeve të Teknologjisë së Informacionit

VI.5 Komponenti 3.4 Zhvillimi dhe zbatimi plotësisht i një kornize integriteti për të ndihmuar në ndërtimin e besimit të komunitetit

VI.6 Komponenti 3.5 Rritja e numrit të Operatorëve Ekonomikë të Autorizuar

VI.7 Komponenti 3.6 Implementimi i Dritares së Vetme Kombëtare (*National Single Window*)

VI.8 Komponenti 3.7 Implementimi i Sistemit të Ri të Kompjuterizuar të Transitit (NCTS)

VI.9 Komponenti 3.8 Rritja e bashkëpunimit në luftën kundër informalitetit, kontrabandës, korrupsionit dhe importit të mallrave të falsifikuara

VI.10 Komponenti 3.9 Zgjerimi i shkëmbimit të informacionit me partnerët vendas dhe ndërkombëtarë për të përmirësuar profilin e riskut

VII. Risqet dhe masat zbutëse

VIII. Monitorimi i Strategjisë

IX. Vlerësimi i kostove dhe financimi

Shtojca 1. Plani i Veprimit të Strategjisë Afatmesme të të Ardhurave 2024–2027

Shtojca 2. Pasaporta e Treguesve të Strategjisë Afatmesme të të Ardhurave 2024–2027

Shtojca 3. Vlerësimi i kostove dhe financimi sipas objektivave specifike (komponentëve)

Lista e shkurttimeve:

ASYCUDA World	Sistem i Automatizuar për të Dhënat Doganore
ADSH	Administrata Doganore Shqiptare
AT	Administrata Tatimore
AKSHI	Ajencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit
AKEP	Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare
BSH	Banka e Shqipërisë
BE	Bashkimi Evropian
BP	Ballkani Perëndimor
DIVA	Deklarata Individuale Vjetore e të Ardhurave
DPD	Drejtoria e Përgjithshme e Doganave
DPT	Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
ILO	Organizata Botërore e Punës
ITMS	Sistemi i Integruar i Menaxhimit të Tarifave
IT	Teknologjia e Informacionit
ISHPSHSH	Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve
	Shoqërore
ISSH-	Instituti i Sigurimeve Shoqërore
MF	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë e Financave
MIE	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë

MRP	Menaxhimi i Riskut të Pajtueshmërisë
NCTS	Sistemi i Ri i Kompjuterizuar i Transiti
KE	Komisioni Evropian
OECD	Organizata për Bashkëpunimin Ekonomik dhe Zhvillim
OEA	Operatorë Ekonomikë të Autorizuar
PBA	Projekt Buxheti Afatmesëm
PBB	Produkti i Brendshëm Bruto
PFM	Strategjia e Financave Publike
SAA	Strategjia Afatmesme e të Ardhurave
AEOI	Standardet e Shkëmbimit Automatik të Informacionit
SKZHI	Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim
TTHF	Tatimi i Thjeshtuar mbi Fitimin
T-F	Tatim-Fitimi
TP	Tatimpagues
TVSH	Tatimi mbi Vlerën e Shtuar
QTATD	Qendra e Trajnimit të Administratës Tatimore dhe Doganore
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave

Lista e Grafikëve:

- Grafik 1: Të ardhurat, shpenzimet dhe deficit, për periudhën 2019–2027, në % të PPB-së
 Grafik 2: Përbërja e të ardhurave të buxhetit të shtetit, viti 2023
 Grafik 3: Përbërja e të ardhurave tatimore, viti 2023
 Grafik 4: Struktura e të ardhurave nga tatimet dhe doganat, 2023
 Grafik 5: Të ardhurat nga TVSh në % ndaj PBB-së në Shqipëri
 Grafik 6: Sektorët kontribues në TVSh-në e brendshme
 Grafik 7: Pagesat e TVSh-së sipas qarkullimit të bizneseve në sektorin e ndërtimit
 Grafik 8: Terminale POS (*Point of Sale*) gjatë viteve
 Grafik 9: Indikator Terminal POS për 100.000 banorë

Lista e tabelave:

- Tabela 1: Rritja e të ardhurave tatimore në përqindje të PBB-së, 2019, 2023 dhe 2027
 Tabela 2: Shpenzimi tatimor, vitet 2021 dhe 2022, në miliardë lekë dhe në % të PBB-së
 Tabela 3: Shpenzimi tatimor i TVSh-së në vitet 2021 dhe 2022
 Tabela 4: Shpenzimi tatimor i tatimit mbi fitimin në vitet 2021 dhe 2022
 Tabela 5 : Efektet buxhetore të politikave tatimore për periudhën 2022–2024
 Tabela 6: Rritja e të ardhurave vjetore nga zbatimi i Strategjisë
 Tabela 7: Rritja e të ardhurave vjetore nga zbatimi i Strategjisë, sipas shtyllave
 Tabela 8: Tatimpaguesit e regjistruar në skemën e TVSh-së në vitin 2023
 Tabela 9: Përrjashtimet tatimore dhe normat e reduktuara në ligjin për tatimin mbi të ardhurat
 Tabela 10: Të ardhura në buxhetin e shtetit nga Shtylla 2 “Mirëadministrimi tatimor”, sipas zërave të taksave
 Tabela 11: Realizimi i TVSh-së sipas administratave fiskale, në vlerë dhe % ndaj PBB-së
 Tabela 12: Të ardhurat nga TVSh-ja në % të PBB-së dhe numri i subjekteve në sektorin “Akomodim” dhe “Aktivitetet e shërbimit të ushqimit dhe pijeve”, me më shumë se 100.000 lekë shitje të tatueshme me 6 %
 Tabela 13: Numri i subjekteve aktive me përgjegjësi TVSh-je
 Tabela 14: Rritja e të ardhurave nga tatimi mbi fitimin dhe mbi qiratë
 Tabela 15: Numri i pozicioneve të punës, 2019–2023

Tabela 16: Të ardhurat nga kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, që mbliidhen nga AT, 2019–2023

Tabela 17: Të ardhurat shitesë nga komponenti 2.2, sipas zërave të taksave

Tabela 18: Të ardhura shitesë nga shtylla 3 “Mirëadministrimi doganor”, sipas komponentëve

Tabela 19: Risqet kryesore të mundshme

Tabela 20: Kostimi i Strategjisë

Lista e figurave:

Figura 1: Përmbledhja e Strategjisë Afatmesme të të Ardhurave

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Në këtë dokument prezantohet Strategjia Afatmesme e të Ardhurave (SAA) në Republikën e Shqipërisë për periudhën 2024–2027, e cila pasqyron reformat në fushën e politikave tatimore, administrimit tatimor e doganor që parashikohen të ndërmerren gjatë kësaj periudhe katërvjeçare, me synim, rritjen e të hyrave në buxhetin e shtetit nga sistemi tatimor, përmirësimin e efektivitetit në punën e administratës tatimore dhe doganore, si elemente të rëndësishme për konsolidimin e financave publike.

Strategjia Afatmesme e të Ardhurave (SAA) 2024–2027 dhe Plani i Veprimit, paraqet të detajuara reformat që do të ndërmerren në politikat tatimore, mirëadministrimin tatimor dhe doganor, të cilat së bashku do të sjellin rritje të të ardhurave tatimore prej 64.85 miliardë lekë gjatë viteve 2024–2027. Kjo rritje e të ardhurave do të vij nga rritja e të ardhurave nga politikat fiskale me rreth 9.28 miliardë lekë ose 0.33% të PBB-së, rritja e të ardhurave nga mirëadministrimi tatimor me 51 miliardë lekë ose 1,96% e PBB-së dhe rritja e të ardhurave nga mirëadministrimi doganor, me 4,5 miliardë lekë ose 0,17% e PBB-së.

Në total, të ardhurat nga tatimet¹ do të rriten me 1.8% të PBB-së, nga 25.9% e PBB-së në 2023-shin në 27.7% e PBB-së në 2027-ën.

Kjo Strategji është një nga kushtet që Shqipëria duhet të përmbushë në kuadër të dokumentit të politikave “Agjenda e Reformës Kombëtare 2024–2027”, në kuadër të instrumentit të Bashkimit Evropian “Reforma dhe Lehtësia e Rritjes për Ballkanin Perëndimor” dhe përfshin kushtet, masat dhe hapat që do të ndërmarrë Shqipëria për zbatimin e këtyre kushteve të tjera të vëna nga KE-ja në këtë dokument që lidhen me tatimet dhe mirëadministrimin tatimor.

Kjo strategji është në përputhje me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian (SKZHIE) 2022–2030, Kuadrin Makroekonomik dhe Fiskal 2025–2027, si dhe rekomandimet e Bashkimit Evropian dhe rekomandimet e Fondit Monetar Ndërkombëtar.

Qëllimi i përgjithshëm është mobilizimi i të ardhurave përmes politikave të qëndrueshme fiskale dhe reformave administrative tatimore e doganore, duke thjeshtuar procedurat, kostot e pajtimit, luftën ndaj shmangieve dhe evazionit tatimor, me qëllim krijimin e hapësirave fiskale për më shumë investime dhe zhvillim të qëndrueshëm.

Reformat kryesore tatimore dhe administrative të parashikuara në SAA janë hartuar me asistencën teknike të Fondit Monetar Ndërkombëtar, dhe janë të bazuara në direktivat e Bashkimit Evropian në fushën e tatimeve, taksave dhe doganave.

Nevoja për një strategji gjithëpërfshirëse të rritjes së të ardhurave të buxhetit është identifikuar herët dhe në vitin 2019, Ministria e Financave, e mbështetur nga asistenca e FMN-së identifikoi masat konkrete të politikës fiskale dhe mirëadministrimit tatimor e doganor, të cilat duhej të ndërmerreshin në vitet në vijim, me qëllim që sistemi tatimor të garantonte gjenerimin e të ardhurave shitesë për mbulimin e shpenzimeve buxhetore.

¹ Vlerësimet e të ardhurave tatimore (si % e PBB-së) bazohen në vlerat nominale të PBB-së para rishikimit të të dhënave të shtatorit 2024.

Për arsye të impaktit negativ në ekonomi në vitet 2019–2021 të ngjarjeve dhe situatave të paparashikuara (pasojat e tërmetit 2019 dhe të pandemisë COVID-19), zbatimi i masave të dizenuara në fushën e politikave tatimore filloi të materializohej në vitin 2022 dhe më tej në vitin 2023.

Nga janari i vitit 2022, Shqipëria filloi zbatimin e masave të parashikuara në draft Strategjinë Afatmesme të të Ardhurave (SAA), 2022–2026, megjithëse nuk ishte miratuar në bazë të një akti formal. Pavarësisht se situata ekonomike e pafavorshme e vitit 2020, si rezultat i mbylljes së ekonomisë për shkak të COVID-19 reduktoi të ardhurat e buxhetit me -1 % të PBB-së, si rezultat i masave të ndërmarra në vijim, sidomos në fushën e politikave tatimore, rikuperimi ishte i shpejtë. Nëpërmjet masave të marra në kuadër të draft SAAS 2022–2026, janë gjeneruar të ardhura shtesë me +0,7% të PBB-së në vitin 2023 krahasuar me vitin 2019, viti kur filloi procesi i SAA-së.

Zbatimi i masave të politikës fiskale sipas Rekomandimeve të FMN-së, masa të cilat u detajuan në draft Strategjinë Afatmesme të të Ardhurave, 2022–2026, ka nisur me “Paketën fiskale 2022”, dhe ka vazhduar me “Paketën fiskale 2023” dhe “Paketën fiskale 2024”.

Ndryshimet e ndërmarra në fushën e politikave dhe administrimit fiskal kanë synuar zgjerimin e bazës së tatimit, reduktimin e incentivave fiskale, rishikimin e tarifave tatimore të reduktuara dhe atyre preferenciale. Ndryshimet e realizuara përfshijnë legjislacionin e tatimeve indirekte (akcizat dhe TVSh-në), si dhe tatimet direkte mbi të ardhurat e entiteteve dhe personave fizike. Së fundi u miratua ligji i ri “Për tatimin mbi të ardhurat” i cili modernizon tatimet direkte dhe zgjeron më tej bazën e tatimit.

Kjo Strategji Afatmesme e të Ardhurave për periudhën 2024–2027, bazohet jo vetëm në përditësimin e draftit të mëparshëm të SAA 2022–2026, me fokus mirëadministrimin e taksave, por përfshin edhe kushtet e vëna në Planin e Rritjes së Agjendës së Reformave të KE-së, si dhe masat për zbatimin e tyre.

Gjatë viteve 2024–2027, të ardhurat tatimore si pjesë e PBB-së vlerësohen të rriten me 1.8 % në 27.7% të PBB-së në vitin 2027, mbështetur nga masat e përfshira në këtë Strategji. Duke marrë një horizont më të gjatë, nga viti 2019 deri në vitin 2027, të ardhurat nga tatimore si pjesë e PBB-së vlerësohen të rriten me 2.5 %, rritje që pasqyron efektet e masave të zbatuara deri tani nga Strategjia e mëparshme, masat aktuale të propozuara në këtë Strategji, si dhe faktorë të tjerë ekonomikë.⁹ Në terma afatgjatë, synohet që nëpërmjet zbatimit të masave shtesë që do të parashikohen në draftstrategjinë e rishikuar, të ardhurat totale të buxhetit në vitin 2030, ku përfshihen krahas të ardhurave tatimore edhe të ardhurat jotatimore dhe ato nga grantet, të arrijnë në mbi 30% të PBB-së, ku pjesa më e rëndësishme është rritja e të ardhurave nga përmirësimi i politikave të administrimit tatimor.

Reformat e parashikuara për periudhën 2024–2027, synojnë:

- të thellojnë më tej reformat në fushën e politikave dhe sidomos në drejtim të administrimit tatimor e doganor, duke bërë të mundur rritjen e neutralitetit të sistemit tatimor, eliminimin e deformimeve të krijuara në sistem, përmirësimin e nivelit të normave tatimore dhe rritjen e bazës së tatimit;

- të informojnë dhe orientojnë vendimmarrjen politike, në lidhje me politikat fiskale të vendit, si dhe në vendimmarrjet e operatorëve ekonomikë, në lidhje me strategjitë e biznesit, të cilat kërkojnë qëndrueshmëri në politikat fiskale, me qëllim programimin e veprimtarisë dhe aktiviteteve në terma afatgjatë;

- t'i ofrojnë qeverisë një pasqyrë të qartë të nivelit të të ardhurave tatimore të pritshme në secilin vit të kësaj periudhe 4-vjeçare;

- t'i ofrojnë operatorëve ekonomikë pamje të qartë dhe mbi të gjitha më shumë siguri, mbi mënyrën se si do të trajtohen dhe cilat do të jenë detyrimet tatimore, në lidhje me vendimet që do ndërmarrin për investimet e tyre.

Për të ardhurat tatimore të cilat përfshijnë: i. të ardhurat tatimore nga tatimet dhe doganat; ii. të ardhurat nga taksat vendore; dhe iii. të ardhurat nga kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, në Strategji janë programuar një sërë masash të ndara në tri shtylla kryesore:

Shtylla 1: Rishikimi i politikës tatimore

1. Rishikimi i politikës tatimore të tatimeve indirekte (taksat mbi konsumin);
2. Rishikimi i politikës tatimore të tatimeve direkte;
3. Rishikimi i politikës tatimore të taksës mbi pasuritë e paluajtshme.

Shtylla 2: Mirëadministrimi tatimor

1. Zvogëlimi i hendekut të pajtueshmërisë në lidhje me TVSh-në;
2. Ulja e pagesave me para në dorë në ekonomi;
3. Verifikimi i të ardhurave dhe kontrolli i pasurive të pajustificuara;
4. Zvogëlimi i shmangies tatimore;
5. Reduktimi i punës së padeklaruar dhe të nëndeklarimit të pagës reale;
6. Reduktimi i kostove të pajtueshmërisë dhe rritja e sigurisë tatimore dhe besimit tek administrata tatimore;

7. Përmirësimi i cilësisë së shërbimit të ofruar nga Administrata Tatimore (AT) nëpërmjet zhvillimit të kapaciteteve institucionale të administratës tatimore.

Shtylla 3: Mirëadministrimi doganor

1. Modernizimi i proceseve të biznesit, duke përfshirë centralizimin e funksionit të profilizimit të riskut;
2. Zhvillimi i aftësive të zgjeruara analitike të të dhënave;
3. Rritja e investimeve në zhvillimin e sistemeve të teknologjisë së informacionit;
4. Zhvillimi dhe zbatimi plotësisht i një kornizë integriteti për të ndihmuar në ndërtimin e besimit të komunitetit;
5. Rritja e numrit të operatorëve ekonomikë të autorizuar;
6. Implementimi i Dritares së Vetme Kombëtare (*National Single Window*);
7. Implementimi i Sistemit të Ri të Kompjuterizuar të Transitit (NCTS);
8. Rritja e bashkëpunimit në luftën kundër informalitetit, kontrabandës, korrupsionit dhe importit të mallrave të falsifikuara;
9. Zgjerimi i shkëmbimit të informacionit me partnerët vendas dhe ndërkombëtarë për të përmirësuar profilin e riskut.

I. Hyrje

Vitet e fundit kanë qenë një periudhë prove për qëndrueshmërinë dhe elasticitetin e ekonomisë shqiptare. Përballë një sërë goditjesh të jashtëzakonshme, si tërmeti shkatërrues i vitit 2019, pandemia globale e COVID-19 në vitet 2020–2021 dhe së fundmi pasojat e agresionit rus ndaj Ukrainës dhe kriza e çmimeve të energjisë, vendi ynë ka arritur të ruajë me sukses stabilitetin makroekonomik dhe të minimizojë dëmet afatgjata në ekonomi dhe mirëqenie.

Aftësia për t'u përshtatur me ndryshime kaq të mëdha në mjedisin e jashtëm, në një hark kohor kaq të shkurtër, dëshmon për maturitetin dhe kompetencën e institucioneve tona ekonomike dhe financiare, si dhe për miksin e duhur të politikave makroekonomike të ndjekura. Ndonëse goditjet ishin të forta dhe të menjëhershme, ndikimi i tyre u zbut ndjeshëm falë reagimit të shpejtë dhe të koordinuar të autoriteteve përgjegjëse, veçanërisht në fushën e politikës fiskale dhe asaj monetare.

Viti 2020 shënoi recesionin e parë për ekonominë shqiptare që prej vitit 1997. Si rezultat i saj, të ardhurat tatimore u ulën me -1% të PBB-së krahasuar me vitin 2019, ndërkohë që të ardhurat totale të buxhetit u ulën me -1.3 % të PBB-së.

Por tkurrja ekonomike rezultoi në fakt më e moderuar se parashikimet fillestare, dhe më e butë në krahasim me shumicën e vendeve të rajonit dhe Evropës. Kjo falë masave në kohë të duhur për të mbështetur bizneset, punësimin dhe shtresat në nevojë. Si rezultat, rimëkëmbja në vitin pasardhës 2021, që më e shpejtë dhe më e fuqishme, duke e rikthyer ekonominë në trajektoren e rritjes së qëndrueshme.

Ecuria pozitive ka vijuar edhe në vitet në vazhdim. Gjatë vitit 2022, ekonomia shqiptare u rrit me mbi 4%, pavarësisht sfidave të reja në sektorin e energjisë dhe rritjes së pasigurisë globale. Edhe për vitin 2023 rritja ekonomike rezultoi relativisht e kënaqshme në rreth 3.4%, duke u mbështetur nga ecuria e favorshme e kërkesës së brendshme dhe sektorit të shërbimeve, veçanërisht turizmit.

Ecuria e agregateve kryesore makroekonomike e konfirmon këtë panoramë inkurajuese. Konsumi dhe investimet private, dy motorët kryesorë të kërkesës, kanë shënuar rritje të vazhdueshme, përkundër luhatjeve në besimin e konsumatorëve dhe biznesit. Eksportet e mallrave dhe shërbimeve, gjithashtu, kanë dhënë një kontribut pozitiv, sidomos falë një sezoni turistik rekord në dy vitet e fundit 2022 dhe 2023. Si rezultat, deficitin i llogarisë korrente ka shënuar përmirësim të ndjeshëm gjatë vitit të kaluar.

Zhvillimet në tregun e punës janë një tjetër dëshmi e rimëkëmbjes së qëndrueshme të aktivitetit ekonomik. Shkalla e papunësisë ka arritur nivelet më të ulëta historike gjatë vitit 2023, me rënie të vazhdueshme në çdo tremujor. Ky përmirësim ka përfshirë pothuajse të gjitha grupmoshat dhe rajonet, duke e bërë rimëkëmbjen më gjithëpërfshirëse. Në të njëjtën kohë, rritja e qëndrueshme e punësimit është shoqëruar me tendencë pozitive në pjesëmarrjen në forcat e punës, veçanërisht e spikatur te gratë dhe rinia, e cila tregon se ka ende hapësira të pashfrytëzuara për rritjen e mëtejshme.

Një tjetër sukses i rëndësishëm ka qenë menaxhimi i sfidës së inflacionit, e cila u përshkallëzua ndjeshëm gjatë vitit 2022 në të gjithë botën si pasojë e goditjeve në ofertën globale dhe rritjes së çmimeve të energjisë. Megjithatë, Shqipëria arriti ta mbajë nën kontroll më të mirë situatën krahasuar me shumicën e vendeve të rajonit dhe Evropës. Kjo falë ndihmesës së kursit të këmbimit, i cili absorboi një pjesë domethënëse të pjesë të presioneve inflacioniste, si dhe besueshmërisë së fituar të politikës sonë monetare, e cila u ankorua qartazi në ruajtjen e stabilitetit të çmimeve, por edhe në saj të një politike fiskale qartësisht konsoliduese, e kështu tërësisht në harmoni dhe në ndihmesë të politikës monetare për të zbutur inflacionin.

Ruajtja e ekuilibrave të shëndetshëm makroekonomikë është mbështetur në fundamentale edhe në konsolidimin e vazhdueshëm të financave publike. Megjithëse pandemia i dha një goditje të fortë parametrave fiskalë, veçanërisht në vitin 2020, por duke filluar nga viti 2021 ato kanë hyrë në një trajektore të qartë përmirësimi. Falë rimëkëmbjes së shpejtë të të ardhurave tatimore dhe kujdesit në menaxhimin e shpenzimeve, deficitin buxhetor ka shënuar rënie progresive, ndërsa raporti i borxhit publik është ulur me shpejtësi drejt niveleve para pandemisë që në vitin 2022 dhe gjatë vitit të shkuar 2023 niveli i borxhit publik zbriti në nivelin prej 58.2% të PBB-së, niveli më i ulët ky i shënuar që prej vitit 2010.

Konsolidimi fiskal do të vijojë të jetë një nga prioritetet kryesore të politikës sonë ekonomike edhe në periudhën afatmesme, në përputhje të plotë me rregullat fiskale të përcaktuara në ligjin organik të buxhetit. Duke filluar nga viti 2024, synojmë të ruajmë një balancë primare pozitive, çka do të thotë që të ardhurat buxhetore do të jenë të mjaftueshme për të mbuluar të gjitha shpenzimet, duke përjashtuar pagesat e interesit për borxhin publik. Kjo do të sigurojë që borxhi në raport me PBB-në të vijojë trajektoren rënëse, me objektivin afatgjatë për ta ulur atë nën 50% të PBB-së.

Ndërkohë, politika jonë fiskale do të ruajë gjithmonë një balancë midis nevojës për konsolidim dhe asaj për të mbështetur rritjen ekonomike nëpërmjet investimeve publike cilësore. Në periudhën afatmesme 2024–2027, investimet kapitale publike synohen të qëndrojnë në nivelin mesatar prej mbi 5% të PBB-së në vit, duke u fokusuar në projekte me impakt të lartë në rritjen potenciale dhe

produktivitetin e ekonomisë. Gjithashtu, do të vijojmë të përmirësojmë efikasitetin e shpenzimeve korrente, duke synuar rritjen e vazhdueshme të financimit për sektorët prioritarë, si: arsimi, shëndetësia dhe infrastruktura.

Të gjitha këto zhvillime pozitive në sferën makroekonomike na japin besimin se ekonomia shqiptare gëzon sot një shkallë të lartë qëndrueshmërie dhe elasticiteti. Pavarësisht sfidave të jashtëzakonshme, ne kemi arritur të ruajmë e të përforcojmë fondamentet makroekonomike më jetike: qëndrueshmërinë e financave publike, stabilitetin e çmimeve dhe stabilitetin financiar. Kjo është baza e shëndoshë mbi të cilën mund të ndërtojmë hapin tonë të radhës drejt një modeli më të avancuar e gjithëpërfshirës të zhvillimit ekonomik e social.

E ardhmja kërkon që ta ngremë ekonominë dhe shoqërinë tonë në një nivel të ri, në përputhje me ambiciet tona për integrimin e plotë evropian. Kjo do të kërkojë një sistem fiskal dhe financiar më efikas, më të drejtë dhe më transparent, që u shërben sa më mirë nevojave të qytetarëve dhe bizneseve, duke siguruar në të njëjtën kohë burime të mjaftueshme dhe të qëndrueshme për ofrimin e të mirave dhe shërbimeve publike cilësore.

Strategjia Afatmesme e të Ardhurave, e detajuar në këtë dokument, përbën udhërrëfyesin tonë në këtë rrugëtim sfidues por shpresëdhënës. Ajo synon të rrisë në mënyrë të qëndrueshme të ardhurat buxhetore duke zgjeruar bazën e taksueshme, duke përmirësuar administrimin tatimor dhe duke luftuar evazionin fiskal, me synim arritjen gradualisht të një niveli të lartë të të ardhurave tatimore dhe atyre totale të buxhetit.

Përtej synimit sasior, theks i veçantë do t'i kushtohet edhe përmirësimit të vazhdueshëm cilësor të të ardhurave, duke synuar një sistem më të thjeshtë, më të qëndrueshëm dhe më miqësor me rritjen ekonomike. Politikat specifike do të detajohen në vijim të këtij dokumenti, por ndër objektivat kryesore përmendim mobilizimin e të ardhurave përmes politikave të qëndrueshme fiskale dhe reformave administrative tatimore e doganore, duke thjeshtuar procedurat, kostot e pajtimit, luftën ndaj shmangie dhe evazionit tatimor.

Njëkohësisht, rritja e të ardhurave do të shoqërohet edhe me reforma në krahun e shpenzimeve, për të siguruar që burimet publike përdoren në mënyrën më efektive dhe eficiente, duke u dhënë përparësi investimeve në kapitalin njerëzor dhe projekteve me impakt të lartë në rritjen ekonomike afatgjatë. Në këtë kontekst, prioritet do të kenë fushat me rëndësi strategjike, si: arsimi cilësor dhe gjithëpërfshirës, kujdesi shëndetësor, mbështetja për grupet vulnerabel dhe tranzicioni i gjelbër e digjital i ekonomisë.

Hartimi dhe zbatimi i kësaj strategjie do të udhëhiqet nga parimet e ruajtjes së stabilitetit makroekonomik dhe financiar, respektimit të rregullave fiskale, transparencës së plotë me publikun dhe komunikimit e koordinimit të ngushtë me të gjithë aktorët dhe grupet e interesit. Ne besojmë se vetëm nëpërmjet një procesi gjithëpërfshirës dhe të përgjegjshëm mund të ndërtojmë konsensusin e nevojshëm shoqëror për reforma të tilla të rëndësishme e afatgjata.

Siç e kanë provuar edhe zhvillimet sfiduese të viteve të fundit, ekonomia dhe shoqëria jonë gëzojnë një shkallë të lartë rezistence dhe elasticiteti, si dhe një kuadër të shëndoshë politik që garanton stabilitetin dhe besueshmërinë e institucioneve. Pikërisht mbi këtë themel të fortë që kemi ngritur së bashku, jemi të bindur se mund ta çojmë Shqipërinë në etapën e radhës të zhvillimit dhe mirëqenies së qëndrueshme, në rrugën tonë të integritetit të plotë në familjen evropiane.

II. Nevoja për hartimin e Strategjisë Afatmesme të të Ardhurave

II.1 Përputhshmëria me qëndrueshmërinë fiskale


Domosdoshmëria për përcaktimin e objektivave afatmesëm të të ardhurave buxhetore buron nga nevojat për financimin e shpenzime të buxhetit. Bazuar në Kuadrin Makroekonomik dhe Fiskal, 2025–2027 të miratuar me VKM-në nr. 399, datë 19.6.2024:

- Burimet totale të qeverisë për t'u shpenzuar gjatë viteve 2025–2027 pritet të jenë mesatarisht në rreth 825 miliardë lekë në çdo vit ose mesatarisht rreth 30.7 për qind e PBB-së.

- Të ardhurat totale të buxhetit gjatë viteve 2025–2027 parashikohet të jenë mesatarisht 778 miliardë lekë çdo vit ose mesatarisht 28.9% e PBB-së.

- Të ardhurat tatimore për këtë periudhë parashikohen të jenë mesatarisht 737.6 miliardë lekë çdo vit ose 27.4 % e PBB-së. Të ardhurat tatimore parashikohen të jenë 27.7% në vitin 2027, me +2.5% e PBB-së rritje në krahasim me vitin 2019, kur ishin 25.2% e PBB-së, dhe rreth 1.8% të PBB-së më shumë krahasuar me 2023-shin.

Grafik 1: Të ardhurat, shpenzimet dhe deficit, për periudhën 2019–2027, në % të PBB-së



Burimi: Ministria e Financave, Kuadri Makroekonomik, 2025–2027

Sikurse duket qartë dhe nga grafiku 1 më sipër, të ardhurat tatimore të planifikuara në periudhën 2025–2027, financojnë gjithnjë e më shumë vëllimin e shpenzimeve buxhetore përgjatë kësaj periudhe, duke mundësuar njëkohësisht dhe arritjen e objektivit për uljen e borxhit publik në terma realë. Për ilustrim, hendeuku i financimit të shpenzimeve buxhetore nga të ardhurat tatimore në vitin 2020 rezultoi 7.9%, ndërsa për vitin 2027 parashikohet që ky hendeq të shkojë në 2.3% e PBB-së.

Vitet 2023 dhe 2024 janë vitet me rritjen me domethënëse të të ardhurave tatimore, përkatësisht me +0.6 % e PBB-së dhe +0.8 % e PBB-së krahasuar me vitet paraardhëse të tyre. Sikurse shpjegohet në detaje në vijim, për shkak të masave të ndërmarra në fushën e politikave fiskale, në dy vitet e fundit, kombinuar kjo me efektet e mirëadministrimit, viti 2024 ka shënuar vitin më të mirë fiskal, ndërkohë që, në vitet në vijim, pritet që impakti pozitiv në të ardhura do të jetë i fokusuar kryesisht në efektet e politikave të mirëadministrimit tatimor e doganor.

Arritja e objektivave ambicioze për rritjen e të ardhurave tatimore në nivelin 27.7% e PBB-së në 2027, garantohet nga masat e projektuara dhe që do realizohen sipas kësaj Strategjie.

Objekti i rritjes së të ardhurave tatimore për 2024–2027 është 1.8% e PBB-së krahasuar me 2023 dhe 2.5% e PBB-së krahasuar me 2019, sikurse paraqitet në tabelën më poshtë.

Tabela 1: Rritja e të ardhurave tatimore në përqindje të PBB-së, 2019, 2023 dhe 2027

Të ardhura tatimore 2019	Të ardhura tatimore 2023	Të ardhurat tatimore 2027, objektivi i synuar	Rritja e të ardhurave tatimore (diferenca 2027–2023)	Rritja e të ardhurave tatimore (diferenca 2027–2019)
25.2% e PBB-së	25.9% e PBB-së	27.7% e PBB-së	1.8 %	2.5 %

Duke marrë në konsideratë se politika fiskale përdoret edhe për të stimuluar dhe zhvilluar sektorë të ndryshëm të ekonomisë, synohet që nëpërmjet kësaj strategjie të ndërmerren masa të forta që të

mund të financojnë me rreth +2.5% të PBB-së nevojat shtesë buxhetore, duke rritur kështu financimin e politikave sektoriale.

Tri janë grupet përbërëse të të ardhurave të buxhetit të shtetit:

1. Të ardhurat nga grantet;
2. Të ardhurat tatimore; dhe
3. Të ardhurat jotatimore.

Të ardhurat tatimore përbëjnë grupin më të madh të të ardhurave, me 93% të të ardhurave të buxhetit të shtetit.

Të ardhurat tatimore përbëhen nga tri grupe të ardhurash: të ardhurat nga tatimet dhe doganat, të ardhurat nga pushteti vendor dhe të ardhurat nga kontributet.


Grafik 2: Përbërja e të ardhurave të buxhetit të shtetit, viti 2023



Grafik 3: Përbërja e të ardhurave tatimore, viti 2023



Grafik 4 :Struktura e të ardhurave nga tatimet dhe doganat, 2023



Burimi: Ministria e Financave

Strategjia parashikon ndërmarrjen e reformave në fushën e politikave dhe administrimit fiskal, të cilat do të prekin të tre përbërësit kryesorë të të ardhurave tatimore, dhe konkretisht: të ardhurat nga tatimet dhe doganat; të ardhurat nga taksat lokale; dhe të ardhurat nga fondet speciale, që përfshijnë kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, për të siguruar rritjen e synuar.

Nisur nga pesha që zënë të ardhurat e buxhetit në raport me PBB-në dhe veçanërisht të ardhurat që gjenerohen nga sistemi i tatimeve, taksave dhe kontributeve të detyrueshme, e kombinuar kjo me nivelin e normave tatimore, përjashtimeve dhe incentivave sektoriale, rezulton se Shqipëria ka hapësirë për të rritur të ardhurat e buxhetit, të cilat duhet të derivojnë si nga ndryshimet e domosdoshme në politikat fiskale, por kryesisht nga përmirësimet në administrimin e të ardhurave nga tatimet dhe taksat.

II.2 Problematika e identifikuar në “pajtueshmërinë tatimore”

II.2.1 Rritja e pajtueshmërisë vullnetare të tatimpaguesve

Qeveria shqiptare ka bërë përpjekje të vazhdueshme në uljen e informalitetit dhe minimizimin e fenomeneve të shmangieve tatimore nga tatimpaguesit.

Reformat kundër informalitetit kanë vazhduar të jenë prioritet për qeverinë shqiptare. Shërbimet tatimore *online* kanë krijuar mundësi që taksapaguesit dhe individët të marrin shërbimin e kërkuar, duke rritur nivelin e pajtimit me ligjin tatimor, kursyer kohë, burime njerëzore dhe kosto administrative. Aktualisht, 100% e shërbimeve tatimore dhe deklaratave janë *online*. Ndërsa, administrata doganore funksionon “pa letër” (*paperless*) që nga viti 2018.

Gjithashtu, ndër vite, administrata tatimore ka përdorur forma të ndryshme të luftës ndaj informalitetit, si Plane Operacionale për sektorë specifikë, të tillë si: turizmi, hidrokarburet, ndërtimi, etj., fushata për tërheqjen e kuponit tatimor, forma të ndryshme komunikimi me tatimpaguesit për rritjen e përputhshmërisë si letra të personalizuar, etj.

Lufta kundër informalitetit ka vazhduar përmes zgjerimit dhe futjes së sistemeve të IT-së dhe digjitalizimit. Gjatë viteve të fundit është investuar në krijimin e sistemeve dhe digjitalizimin e proceseve të punës për të dyja administratat, me qëllim shmangien e kontakteve direkte mes punonjësve të administratave dhe bizneseve, si dhe për lehtësimin e të bërit biznes nëpërmjet uljes së kohës dhe kostove të pajtimit për bizneset. Arritja më e rëndësishme ishte zbatimi i sistemit të fiskalizimit, duke përfshirë “*e-invoice*”, si rezultat i të cilit të ardhurat nga tatimi mbi vlerën e shtuar janë rritur. Fiskalizimi si reforma më madhore e implementuar nga Administrata Tatimore gjatë viteve të fundit, ndryshoi rrënjësisht mënyrën e faturimit, duke krijuar mundësi për të monitoruar faturimet ndërmjet operatorëve ekonomikë, si dhe deklaratimet pranë administratës tatimore në kohë reale. Hapat pozitivë në administrim dhe kryesisht fiskalizimi si proces, kanë ndikuar në rritjen e të ardhurave të brendshme gjatë vitit 2023 dhe në periudhën vijuese të vitit 2024.

Megjithatë, informaliteti vazhdon të jetë prezent si një fenomen i konsoliduar në një periudhë 30-vjeçare, me gjithë reformat e ndërmarra dhe sistemet e prezantuara për të eliminuar ndërveprimin korruptiv ndërmjet bizneseve dhe strukturave të administratave tatimore e doganore.

II.2.2 Politikat tatimore – Përrjashtimet dhe normat e reduktuara

Që prej vitit 2019, Ministria e Financave harton dhe publikon Raportin e “Shpenzimeve tatimore”. Ky raport llogarit nivelin teorik të të ardhurave nga tatimet dhe taksat, me supozimin që çdo bazë tatimore të taksohet me normën standarde të tatimit, pra llogarit diferencat ndërmjet normës standarde me normat e reduktuara dhe përjashtimet, të shumëzuara këto me bazën e tatimit. Aktualisht, janë prodhuar dy raporte: Raporti i Shpenzimeve Tatimore 2019–2020² dhe Raporti i Shpenzimeve Tatimore 2021–2022.

Këto raporte pasqyrojnë nivelin e “Shpenzimeve tatimore” sipas kuadrit fiskal në fuqi dhe llogarisin të ardhurat e munguara në buxhet si rezultat i përjashtimeve tatimore dhe normave të ndryshme tatimore nga ato standarde, të cilat burojnë nga Tatimi mbi Vlerën e Shtuar (TVSH), Tatimi mbi Fitimin (TF), Tatimi i Thjeshtuar mbi Fitimin (TTHF) dhe akciza. Gjithashtu, këto raporte pasqyrojnë edhe disa analiza më të detajuara për sa lidhet me këto shpenzime tatimore.

Raportet e Shpenzimeve Tatimore janë bërë, gjithashtu, pjesë e relacioneve të projektbuxhetit të vitit pasardhës, me synimin e sensibilizimit të ligjvënësve për të ardhurat që i mungojnë buxhetit të shtetit nga përjashtimet apo tarifat e reduktuara tatimore.

Raporti i “Shpenzimeve Tatimore 2021–2022” tregon se vlera e të ardhurave të munguara si rezultat i evazionit, përjashtimeve, zbatimit të normave të reduktuara, të quajtura ndryshe “Shpenzime tatimore”, për vitin 2022 llogaritet rreth 101,68 miliardë lekë ose 4.76 % e Produktit të Brendshëm Bruto të vendit. Rreth 82,6% e “Shpenzimeve tatimore” rrjedhin nga përjashtimet, aplikimi i shkallëve

² arkiva.financa.gov.al/shpenzimet-tatimore-2.

të reduktuara dhe kufiri minimal i regjistrimit për TVSh-së. Ky rezultat është i pritshëm pasi të ardhurat nga TVSh-ja zënë peshën kryesore në portofolin e të ardhurave tatimore. Shpenzimet tatimore, që krijohen nga përjashtimet apo aplikimet e normave të reduktuara në tatimet e tjera, si: akciza, Tatimi mbi të ardhurat, Tatimi mbi fitimin korporativ, variojnë nga 0.5%–1% të PBB-së, ku pas TVSh-së, vlera më e lartë e shpenzimeve tatimore me rreth 16%, vjen nga norma 0% e tatimit mbi fitimin e bizneseve të vogla.

Në tabelën në vijim pasqyrohet në mënyrë të detajuar shpenzimet tatimore për vitet 2021–2022. Vihet re se kemi një rënie të nivelit të shpenzimit tatimor në lidhje me akcizën dhe TVSh-në, kjo dhe si shkak i rishikimit të disa normave të reduktuara dhe përjashtimeve për këto tatiime. Ndërkohë, si shkak i rritjes së numrit të bizneseve me tatim 0% dhe i rritjes së nivelit të fitimit të tatueshëm të tyre, shpenzimet tatimore të tatimit mbi fitimin janë në rritje.

Tabela 2: Shpenzimi tatimor, vitet 2021 dhe 2022, në miliardë lekë dhe në % të PBB-së

Shpenzimet tatimore	2021	% e PBB	2022	% e PBB	Diferenca 2021-2022
Shpenzimi tatimor në total	91	4.90%	101.68	4.76%	10.68
TVSH	76.59	4.13%	84	3.93%	7.41
TF + TTHF (CIT)	13.02	0.70%	16.4	0.77%	3.38
Akciza	1.39	0.07%	1.28	0.06%	-0.11

- Tatimi mbi Vlerën e Shtuar

Nëse, çdo mall ose shërbim do të ngarkohej me normën standarde të tatimit, të ardhurat teorike nga TVSh-ja do ishin 367.6 miliardë lekë. Në fakt janë arkëtuar 191,4 miliardë lekë, ose 52,1% e shumës teorike. Diferenca 176,2 miliardë lekë që nuk arkëtohet i takon “Shpenzimeve tatimore”, si dhe TVSh-së së humbur për shkak të nënraportimit/informalitetit/evazionit.

Shpenzimet tatimore nga TVSh-ja për vitin 2021 dhe 2022, pasqyrohen në mënyrë të përmbledhur në tabelën në vijim.

Tabela 3: Shpenzimi tatimor i TVSh-së në vitet 2021 dhe 2022

Shpenzimi tatimor	2021		2022	
	Mil. lek	%	Mil. lek	%
Nga normat e reduktuara, përjashtimet dhe pasuritë e paluajtshme	27,695	36.2	29,340	34.9
a) Normat e Reduktuara (furnizimi i akomodimit, reklamat nga media audiovizive, furnizimi i librave, etj.)	1,443	1.9	1,883	2.2
b) Përjashtimet (furnizimi i arsimit, shëndetësisë, barnave, lojërat e fatit, shërbimet financiare, etj.)	21,324	27.8	24,351	29.0
c) Pasuritë e paluajtshme	4,929	6.4	3,106	3.7
Shpenzimi tatimor nga bizneset e vogla nën kufirin e TVSh-së, nga prodhimet vetjake dhe të tjera	48,894	63.8	54,664	65.1
Totali i shpenzimeve tatimore	76,589	100	84,004	100

- Tatimi mbi të ardhurat e korporatës dhe biznesit (tatimi mbi fitimin)

Nëse do të aplikohej norma standarde 15% e tatimit mbi fitimin për të gjithë bizneset, të ardhurat tatimore teorike nga ky tatim për vitin 2022 do të ishin 64,3 miliardë lekë, nga 47.9 miliardë lekë (rreth 34% më shumë). Kjo diferencë prej 16.4 miliardë lekë vjen si shkak i tatimit 0% dhe normave të reduktuara tatimore të tatimit mbi fitimin, duke pasur kështu një ndikim negativ me 0.77% të PBB-së. Shpenzimet tatimore nga tatimi mbi fitimin për vitin 2021 dhe 2022, pasqyrohen në mënyrë të përmbledhur në tabelën në vijim.

Tabela 4: Shpenzimi tatimor i tatimit mbi fitimin në vitet 2021 dhe 2022

Niveli i qarkullimit	Norma tatimore	Numri i bizneseve deklaruese	Shpenzimi tatimor	% e PBB-së
Viti 2021		137,755	13,018,282,002	0.7
0 – 14,000,000	0%	125,056	12,226,625,997	0.66
Mbi 14,000,000	15%	12,699	791,656,005	0.04
Viti 2022		141,623	16,403,644,459	0.77
0 – 14,000,000	0%	128,035	15,447,672,131	0.72
Mbi 14,000,000	15%	13,588	955,972,328	0.05

Raporti i Shpenzimeve tatimore 2021–2022 tregon se vlera e “Shpenzimeve tatimore”, për vitin 2021 llogaritet rreth 91 miliardë lekë ose 4.90% e Produktit të Brendshëm Bruto (PBB). Nga totali i shpenzimeve tatimore rezulton se rreth 84.16% e tyre i përkasin TVSh-së, për shkak të përjashtimeve, aplikimit të normave të reduktuara, kufirit të lartë të regjistrimit në TVSh, si dhe nga përjashtimi i prodhimit bujqësor vetjak. Rezultatet e shpenzimit tatimor për vitin 2022, si përqindje e PBB-së, janë paraqiten në rënie krahasuar ato të vitit 2021, ku në total vlera e shpenzimeve tatimore, për vitin 2022 llogaritet rreth 101.68 miliardë lekë ose 4.76% e PBB-së. Ndërkohë, shpenzimi tatimor i secilit tatim përkatësisht, shpenzimi tatimor i TVSh-së është rreth 3.93% e PBB-së, i tatimit mbi fitimin dhe tatimit të thjeshtuar mbi fitimin është 0.77% e PBB-së, ndërsa shpenzimi tatimor nga akciza është rreth 0.06% e PBB-së.

II.3 Politikat fiskale të ndërmarrë gjatë 2013–2023-shit

Për shkak të rënies së të ardhurave të buxhetit të shtetit, dhe sidomos të të ardhurave tatimore, pas vitit 2013 janë ndërmarrë reforma dhe ndryshime të rëndësishme në fushën e politikave dhe administrimit tatimor, me qëllim rritjen e të ardhurave, reduktimin e deficitit buxhetor, pagesën e detyrimeve të prapambetura dhe uljen graduale të borxhit publik. Reforma në fushën e të ardhurave konsistoi kryesisht në:

- zëvendësimin e taksës së sheshtë mbi të ardhurat me taksën progresive, duke zbatuar parimin “kush fiton më shumë, paguan një pjesë më të madhe nga të ardhurat në formën e tatimeve dhe taksave”;

- rritjen e normës së tatimit mbi fitimin korporativ për kompanitë e mëdha;
- rritjen graduale të ngarkesës fiskale për mallrat e akcizës, kryesisht për produktin cigare.

Ndryshimet në politikat fiskale ndihmuan në rritjen e të ardhurave tatimore, të cilat në vitin 2017 arritën në 25,7% e PBB-së nga 22,2% e PBB-së në vitin 2013, para politikave të reja fiskale. Ndërkohë në vijim, qeveria ndërmori një sërë masash lehtësuese në politikat fiskale, përfshirë:

- tatimin zero për qind për bizneset e vogla me të ardhura deri në 5 milionë lekë në vit;
- normë të reduktuar tatimi 5% për sipërmarrjet me të ardhura deri në 14 milionë lekë;
- norma të reduktuara preferenciale për sektorë dhe industri prioritare në zhvillimin e vendit, si: turizmi elitare, agroturizmi, teknologjia e informacionit, industria automotivë;
- përjashtimin nga TVSh-ja të një sërë mallrash (inputeve dhe makineri bujqësore, etj.), apo importeve të tjera në funksion të zhvillimit të turizmit.

Në vitet në vijim, për shkak të një sërë ngjarjesh të paparashikuara si: i. efektet negative në ekonomi të situatës energjetike për shkak të thatësirës; ii. pasojave të fatkeqësisë natyrore për shkak të tërmetit dhe pandemisë; iii. efekteve negative për shkak të mbylljes së ekonomisë si pasojë e pandemisë së

COVID-19, kanë rezultuar në ulje të të ardhurave të buxhetit të shtetit dhe veçanërisht të të ardhurave tatimore që gjenerohen nga sistemi tatimor, të cilat në fund të vitit 2020 rezultuan në 24,2 % të PBB-së, ose -1% të PBB-së më pak se në vitin 2019. Gjatë vitit 2020 një sërë aktesh ligjore janë ndërmarrë, me qëllim zbutjen e efekteve financiare të shkaktuara nga pandemia e COVID-19 mbi veprimtarinë e bizneseve dhe të ardhurave individuale. Nga janari i vitit 2022, Shqipëria ka filluar zbatimin e masave të parashikuara për t'u zbatuar në kuadrin e Strategjisë. Si rezultat i tejkalimit të problematikës së krijuar nga faktorët e paparashikuar dhe masave fiskale të ndërmarra, të ardhurat tatimore në vitin 2023 janë rritur me +0.7 % të PBB-së krahasuar me vitin 2019, dhe në vitin 2024 do arrijnë në 26.7 % e PBB-së, nga 25.2 % në vitin 2019. Fillimi i zbatimit të masave të politikës fiskale sipas Rekomandimeve të FMN-së dhe detajimi i tyre në vite, ka filluar me “Paketën Fiskale 2022”, dhe ka vazhduar me “Paketën Fiskale 2023” dhe “Paketën Fiskale 2024”. Ndryshimet e ndërmarra në fushën e politikave fiskale kanë synuar zgjerimin e bazës së tatimit, reduktimin e incentivave fiskale të panevojshme apo që e kanë përmbushur qëllimin për të cilin ishin dizenuar, si dhe shfuqizimin e tarifave tatimore të reduktuara dhe preferenciale pa thelb ekonomik. Ndryshimet e realizuara përfshijnë legjislacionin e tatimeve/taksave indirekte (TVSH-në dhe akcizat), si dhe tatimet direkte mbi të ardhurat e entiteteve dhe personave fizike. Së fundi u miratua ligji i ri “Për tatimin mbi të ardhurat”, i cili zgjeron bazën e tatimit, shfuqizon tarifën e reduktuar tatimore për industrinë e IT-së dhe parashikon heqjen e lehtësive tatimore në vitin 2029. Bazuar në këto reforma, viti 2023 shënoi vitin me rritjen më të lartë të të ardhurave totale të buxhetit të shtetit në përqindje të PBB-së, me 27.8% si dhe të të ardhurave tatimore, me 25.9% të PBB-së. Efektet në të ardhurat e buxhetit të shtetit, të politikave fiskale të ndërmarra 2022, 2023 dhe 2024, jepen sipas tabelës 7 më poshtë.

Ministria e Financave përballet me rritje të kërkesave për më shumë shpenzime buxhetore, për shkak të nevojave dhe kërkesave në rritje investimesh, rritje pagash, pensionesh dhe mbështetje sociale, kërkesa të cilat bëjnë të domosdoshme ndërmarrjen e reformave të thella, me qëllim rritjen dhe konsolidimin e të ardhurave të buxhetit, nëpërmjet të cilave do të bëhet i mundur financimi i shpenzimeve, mbajtja nën kontroll e defisitit buxhetor dhe reduktimi gradual i borxhit publik.

Tabela 5: Efektet buxhetore të politikave tatimore për periudhën 2022–2024

Nr.	Emërtimi	2022	2023	2024
a	Të ardhurat tatimore DPT + DPD	418,780	422,405	455,856
b	Kontributet e Sigurimeve	121,906	143,646	160,059
c	Totali DPT + DPD + Kontribute	540,686	566,051	615,915
	Të ardhurat nga rivlerësimi (on off)	5,612		
	Taksa e energjisë (on off)		9,742	
1	Norma e reduktuar 10% për furnizimin e inputeve bujqësore	813		
2	Përjashtimi i Tvsh për importin e makinerive të kontratave mbi 500 milion			
3	Eliminimi i skemës së kompensimit të prodhuesve bujqësor	899		
4	Përjashtimi i TVSH në import për kafshët e gjalla			-150
5	Përjashtim në import për bletët			-5
6	Heqja e rimbursimit të akcizës së lëndëve djegëse për industrinë (hyn në fuqi 2024)			210
7	Kalendari i akcizës	802	782	800
8	Unifikimi i gazit të lëngshëm për konsumatorin privat dhe automjetet	595		
9	Indeksi i akcizës me normën e inflacionit	1,037	1,175	200
10	Unifikimi i tarifës për Birrën		543	
11	Unifikimi i tarifës për Pijet alkoolike		9	
12	Akumulatorët pa akcizë		-85	
13	Drutë e zjarrit pa akcizë		-2	
14	Vendosja e taksës kombëtare për karburantin e furnizuar në zona të lira (për riekspor) 40 lekë/litër	622		
15	Heqja e rimbursimit të akcizës së lëndëve djegëse për industrinë			
16	Taksa kombëtare për qumështin pluhur në masën 100 lekë për kg	107		
17	Taksa kombëtare për pijen barista të homogjenizuar në masën 16 lekë për litër.	4		
18	Taksa kombëtare për himrën e qumështit në masën 150 lekë për kg.	32		
19	Taksa kombëtare për kremën e qumështit në masën 150 lekë për litër.	18		
20	Lehtësim i barrës tatimore për të punësuarit me të ardhurat nga punësimi per pagat 40 - 50 mijë dhe 50-60 mijë lekë			(1,100)
21	Tatim mbi pagën nga indeksi i pagave të administratës me 7%	140		
22	Tatim mbi pagën për rritjen e kufirit të patatueshëm për pagat deri 40 000 lekë (Prill-Dhjetor)	-486		
23	Kontribute shoqërore dhe shëndetësore si efekt i rritjes së pagës minimale (30,000-32,000 dhe 32,000-3	453		
23/1	Kontribut si efekt i indeksimi i pagave të administratës me 7%	301		
23/2	Rritja e kufirit të TAP nga 150 000 - 200 000 leke	103		
23/3	Kontribute shoqërore dhe shëndetësore si efekt i rritjes së pagës minimale (34,000-40,000)		1,040	
23/4	Kontribute shoqërore dhe shëndetësore nga rritja e pagës së administratës publike		3,100	3,100
23/5	TAP nga rritja e pagës së administratës publike		1,400	1,400
	Totali i efekteve të ndryshimeve ligjore	11,052	16,304	4,455

II.4 Bashkëpunimi me FMN-në lidhur me Strategjinë Afatmesme të të Ardhurave, 2019–2023

Me qëllim adresimin e problematikës me të ardhurat e buxhetit dhe sigurimin në terma afatmesme të burimeve për financimin e shpenzimeve buxhetore, Ministria e Financave ka iniciuar hartimin e një strategjie afatmesme të të ardhurave të buxhetit. Për këtë qëllim, në vitin 2019, u ftua Departamenti i Çështjeve Fiskale në FMN-në për të dhënë ekspertizën e kualifikuar në drejtim të rishikimit të politikës fiskale dhe përmirësimeve në administrimin tatimor dhe doganor. Stafi i Ministrisë së Financave, administratës tatimore dhe asaj doganore, së bashku me ekspertët e FMN-së analizuan politikat fiskale aktuale, problematikat e shfaqura në administrimin tatimor dhe atë doganor, mbi bazën e të cilave u dhanë rekomandimet përkatëse. Raportet dhe rekomandimet e asistencës teknike të FMN-së, kanë shërbyer si guidë për hartimin e draftit fillestar të Strategjisë Afatmesme të të Ardhurave.

Duke marrë në konsideratë efektet dhe pasojat e shkaktuara në ekonomi dhe në financat publike të vendit nga tërmeti i 26 nëntorit 2019, nga pandemia globale e COVID-19, dhe së fundi nga konflikti Rusi–Ukrainë, Ministria e Financave rianalizoi dhe rishikoi objektivat dhe afatet e dizenuara për ndryshimin e politikave dhe administrimit tatimor, me qëllim tejkalimin së pari të problematikës së efekteve negative që krijuan për ekonominë e vendit, për operatorët ekonomikë dhe financat publike këta faktorë të paparashikuar dhe këto ngjarje të jashtëzakonshme. Ridizenjimi i objektivave synoi kryesisht:

- dhënien fillimisht të stimujve fiskalë, me qëllim tejkalimin e situatës së vështirë ekonomike dhe financiare që pritej të kalonin bizneset, kryesisht ato të vogla dhe të mesme sidomos në vitin 2020;
- shtyrjen në kohë të zbatimit të masave të parashikuara në politikat fiskale, duke i dhënë mundësi ekonomisë së vendit dhe sipërmarrjes në vitet 2020 dhe 2021, që fillimisht të rikuperonin pasojat e tërmetit dhe pandemisë së COVID-19. Ridizenjimi i Strategjisë dhe shtyrja në kohë e aplikimit të masave fiskale u diskutua edhe me ekipin e Departamentit të Çështjeve Fiskale të FMN-së.

Zbatimi i rekomandimeve të asistencës së FMN-së, në lidhje me rritjen e të ardhurave, ka filluar në janar 2022, pas miratimit në dhjetor 2021, të “Paketës Fiskale 2022”, kryesisht me masat e rekomanduara nga FMN-ja në fushën e akcizës dhe tatimit mbi vlerën e shtuar. Kjo paketë përfshinte eliminimin e një sërë përjashtimesh nga TVSh-ja dhe akciza, rimbursimet dhe tarifat e reduktuara, si dhe rritjen e akcizës për një sërë produktesh si duhani, etj.

Në dhjetor 2022 u miratua “Paketa Fiskale 2023”, e cila përmban masa të mëtejshme të parashikuara në rekomandimet për hartimin e Strategjisë, ndërsa në 3-mujorin e parë të 2023-shit u diskutua dhe u miratua në Parlament ligji i ri “Për tatimin mbi të ardhurat”, i cili përmban një seri të masave të kësaj strategjie në fushën e taksave direkte, duke përfshirë normën minimale tatimore për 15%, trajtimin tatimor të personave fizikë me norma progresive 15% dhe 23 % pas vitit 2029, si dhe përfundimi i një sërë stimulujsh, si ato të kompanive që operojnë në fushën e teknologjisë së informacionit.

Si rezultat i masave ligjore dhe administrative të ndërmarra gjatë viteve 2022 dhe 2023 (si në politikën tatimore ashtu edhe në administrimin tatimor dhe doganor), të ardhurat tatimore në vitin 2023 janë rritur me +0,7 % të PBB-së krahasuar me vitin bazë 2019 (nga 25,2 % në 2019 në 25,9 % në fund të vitit 2023), ndërsa duke përfshirë masat e reformës të vitit 2024, deri në fund të 2024-s si rezultat i masave të strategjisë të ardhurat tatimore rriten me +1.5 % të PBB-së (60 % e objektivit final).

Sipas vlerësimeve të FMN-së, Shqipëria ka miratuar dhe zbatuar më shumë se 90% të masave të politikës tatimore të propozuara nga asistenca teknike e FMN-së, lidhur me tatimet indirekte dhe ato direkte. Zbatimi i masave të parashikuara në fushën e politikave tatimore do të vazhdojë edhe gjatë viteve të ardhshme, duke rishikuar çështjet e TVSh-së për të qenë në përputhje me Direktivën e BE-së, taksat mbi pasuritë e paluajtshme, taksën e karbonit, si dhe burimet e tjera potenciale të të hyrave të buxhetit.

Zbatimi i masave të rekomanduara nga Fondi Monetar Ndërkombëtar dhe të përfshira në draftstrategji, në lidhje me administrimin tatimor dhe doganor, ka filluar menjëherë, ku arritja më e rëndësishme ishte zbatimi i sistemit të fiskalizimit, duke përfshirë faturën elektronike, përmirësimin e profileve të riskut, shkëmbimin automatik të informacionit, si dhe zhvillime të tjera në fushën e administrimit.

Për dizenjimin dhe zbatimin e masave që duhet të ndërmerren në kuadrin e kësaj strategjie, administratat tatimore dhe doganore kanë pasur suport permanent nga asistenca teknike e FMN-së. Departamenti i Administratës së të Ardhurave të FAD-it rekomandoi në vitin 2019 opsionet e masave që duhet të ndërmerrete administrata fiskale, në kuadër të zhvillimit dhe implementimit të Strategjisë. Në vitin 2023, asistenca teknike analizoi masat e marra dhe arritjet, duke dhënë rekomandimet

përkatëse për ridizenjimin e strategjisë. Asistenca teknike e FMN-së ka ndihmuar DPT-në, në lidhje me dizajnimin e një strukture organike efektive dhe bashkëkohore, menaxhimin e riskut të përputhshmërisë, analitikën e të dhënave, menaxhimin e borxhit, fiskalizimin, individët me pasuri të lartë, auditin etj.

Administrata doganore është asistuar, në lidhje me masat që duhet të ndërmerren për forcimin e kontrollit të akcizës.

Fiskalizimi është zbatuar plotësisht dhe janë bërë hapa të rëndësishëm për të reduktuar punën e paregjistruar. Masa të tjera, të tilla si: shkëmbimi automatik i informacionit, ngritja e bazës së të dhënave dhe forcimi i kapacitetit analitik të të dhënave, janë në fazë të hershme implementimi.

Në prill 2024, me urdhër të ministrit të Financave, u ngrit Grupi Teknik i Punës, i cili në bashkëpunim me Fondin Monetar Ndërkombëtar ka punuar për ridizenjimin e Strategjisë për periudhën 2024–2027, duke u bazuar te përditësimi dhe pasurimi me masa të reja, por me fokus mirëadministrimit tatimor dhe doganor. FMN-ja do të asistojë edhe për monitorimin e zbatimit të kësaj strategjie dhe vlerësimin e të gjitha përjashtimeve tatimore.

III. Vizioni, qëllimet dhe objektivat e Strategjisë Afatmesme të të Ardhurave

Për forcimin dhe rritjen e të ardhurave në raport me PBB-në, nevojitet hartimi i një Strategjie Afatmesme të të Ardhurave, e cila do të shërbejë si pika kyçe e orientimit të vendimarrjes, në lidhje me të ardhurat publike. Kjo strategji përmbledh në mënyrë vizionare objektivin kryesor mbi rritjen e qëndrueshme të të ardhurave tatimore në raport me PBB-në, si dhe rrugën sesi do të arrihet drejt këtij objektivi.

III.1 Vizioni dhe qëllimet e SAA-së

SAA-ja mbështetet në vizionin se politikat fiskale të mirëdizenuara luajnë rol të rëndësishëm në zhvillimin e qëndrueshëm të vendit. Kjo Strategji mbështetet, gjithashtu, në vizionin që ka Ministria e Financave për zhvillimin e një sistemi të të ardhurave buxhetore, eficient, të thjeshtë, transparent, të qëndrueshëm, të aftë për të mbështetur ofrimin e shërbimeve të përmirësuara ndaj publikut dhe rritjen ekonomike, si dhe forcimin e stabilitetit të financave publike të vendit. Ky vizion synon të gjenerojë të ardhura të qëndrueshme për buxhetin, përmes një sistemi tatimor efektiv, të drejtë dhe neutral.

Qëllimi i SAA-së është mobilizimi i të ardhurave përmes politikave të qëndrueshme fiskale, dhe reformave administrative tatimore e doganore, duke thjeshtuar procedurat, kostot e pagimit të taksave, luftën ndaj shmangieve tatimore, me qëllim krijimin e hapësirave fiskale për investime dhe zhvillim të qëndrueshëm, përfshirë shëndetësinë, arsimin, mbrojtjen sociale dhe infrastrukturën.

SAA-ja është një udhërrëfyes i nivelit të lartë të vendimarrjes për reformimin e sistemit fiskal për një periudhë afatmesme, të nevojshme për të ndihmuar në financimin e objektivave strategjike të qeverisë.

III.2 Objektivat e SAA-së

Objektivi i Strategjisë është rritja e të ardhurave tatimore me 64.85 miliardë lekë ose rreth 2.5% e PBB-së, për periudhën 2024–2027. Ky objektivi do të arrihet kryesisht në adresimin e problemeve të mirëadministrimit tatimor dhe doganor, përmirësimi i të cilave pritet të sjellë të ardhura shtesë.

Synohet që të rriten të ardhurat tatimore në përqindje të PBB-së me 1,8% në 2027-n në krahasim me 2023-shin. Për më tepër, në terma afatgjatë synojmë që totali i të ardhurave të buxhetit të arrijë në 30–31% të PBB-së në vitin 2030, ku pjesa më e rëndësishme është rritja e të ardhurave nga tatimet dhe taksat, si dhe përmirësimet e mirëadministrimit tatimorë.

Prioritetet mbi të cilat bazohet kjo Strategji, me synim realizimin e vizionit, qëllimit dhe objektivave janë:

1. Përcaktim i qartë i objektivave sasiore dhe synimeve që duhet të arrihen nëpërmjet SAA-së;

2. Përcaktimi i linjës së politikave tatimore për një periudhë katërvjeçare, me synim analizën e efekteve dhe rishikim tërësor i politikave tatimore, duke synuar neutralitetin e tatimit dhe zgjerimin e bazës së tatimpaguesve;

3. Krijimi i sistemeve dhe rritja e kapaciteteve të administratave fiskale për minimizimin e shmangieve tatimore dhe rritja e ndërgjegjësimit të pagimit të tatimeve.

4. Zbatimi i plotë i kushteve të përcaktuara në Planin e Rritjes së Agjendës së Reformave të KE-së, brenda afateve dhe treguesve të përcaktuar aty.

SAA-ja bashkon këto katër prioritetë për të trajtuar boshllëqet e identifikuar përmes procesit të analizës së hendekut tatimor. Pikërisht qasja kryesore në këtë strategji, bazohet në ndërthurjen e këtyre katër prioritetëve së bashku me tre shtyllat dhe komponentëve përbërës të tyre, të lartpërmendur.

III.3 Përmbledhja e Strategjisë së të Ardhurave

SAA-ja trajton shtyllat e politikave fiskale, ato administrative dhe ligjore të sistemit tatimor dhe doganor në një mënyrë tërësore dhe interaktive. Ajo ofron bashkërendim thelbësor midis këtyre tre elementeve të sistemit fiskal, politikat tatimore, legjislacioni fiskal dhe mirëadministrimi.

Kjo qasje është thelbësore për menaxhimin e sfidave të mbledhjes së të ardhurave, nëpërmjet krijimit të një sistemi tatimor të qëndrueshëm, që përputhet me mjedisin e ndryshueshëm ekonomik dhe praktikat në zhvillim të biznesit.

Ndërvarësia dhe lidhjet midis elementeve të ndryshëm të sistemit tatimor, krijojnë një mjedis biznesi, investimesh dhe pagese taksash, i cili përmban politika të qarta për të mbështetur arritjen e objektivave të qëndrueshme të zhvillimit, dhe që inkurajojnë investimet. Tre drejtimet kryesore ku do të bazohet Strategjia Afatmesme e të Ardhurave (SAA 2024–2027) janë:

a) Rishikimi dhe ridizenjimi i politikave tatimore nëpërmjet analizës së efekteve të politikave aktuale dhe korrigjimeve të nevojshme për periudhën afatmesme, bazuar në kushtet e përcaktuara në Agjendën e Reformës së Planit të Rritjes;

b) Përmirësimi i procedurave të administrimit tatimor dhe doganor, me qëllim rritjen e efikasitetit të administratës fiskale nëpërmjet investimeve në teknologji, burime njerëzore dhe modernizim të procedurave operacionale;

c) Zbatimi i kushteve sipas Planit të Rritjes së Agjendës të Reformës së KE-së.

Sa më sipër, SAA-ja synon të sjellë të ardhura shtesë në vlerën 64.8 miliardë lekë ose rreth 2.5% e PBB-së, dhe llogaritjet e detajuara janë në tabelën e mëposhtme.

Tabela 6 : Rritja e të ardhurave vjetore nga zbatimi i Strategjisë

Viti	2023	2024	2025	2026	2027	Total 2024–2027
Të ardhurat nga taksat (në milionë lekë)	598,662	650,925	694,748	735,957	782,162	
Të ardhurat nga taksat (% e PBB-së)	25.9	26.7	27.2	27.4	27.7	
PBB-ja nominale ³	2,312,588	2,434,311	2,557,740	2,690,518	2,828,616	
Kontributi i SAA-së (në milionë lekë)		18,852	15,963	12,240	17,802	64,858
Kontributi i SAA-së (në % ndaj PBB-së)		0.77%	0.62%	0.45%	0.63%	2.48%

Kjo Strategji është e strukturuar në tri shtylla, me disa komponentë në secilën shtyllë, sipas figurës më poshtë.

Të ardhurat që do të gjenerohen nga secila shtyllë janë paraqitur në tabelën e mëposhtme, në vlerë nominale në lekë dhe në përqindje të PBB-së së vitit referues.

³ Vlerat e PBB-së bazohen në Kuadrin Makroekonomik dhe Fiskal, 2025–2027, të datës 19.6.2024 dhe nuk marrin parasysh rishikimin e të dhënave para shtatorit 2024.

*Tabela 7: Rritja e të ardhurave vjetore nga zbatimi i Strategjisë, sipas shtyllave
në % të PPB*

Shtyllat e strategjisë	2024	2025	2026	2027	Totali 2024–2027
Shtylla 1: Rishikimi i politikës tatimore	0.04%	0.03%	0.04%	0.23%	0.34%
Shtylla 2: Mirëadministrimi tatimor	0.68%	0.54%	0.37%	0.38%	1.97%
Shtylla 3: Mirëadministrimi doganor	0.05%	0.06%	0.04%	0.02%	0.17%
Totali	0.77%	0.62%	0.45%	0.63%	2.48%

në milionë lekë

Shtyllat e strategjisë	2024	2025	2026	2027	Totali 2024–2027
Shtylla 1: Rishikimi i politikës tatimore	1,010	800	1,000	6,473	9,283
Shtylla 2: Mirëadministrimi tatimor	16,577	13,755	10,069	10,665	51,067
Shtylla 3: Mirëadministrimi doganor	1,265	1,408	1,171	664	4,508
Totali	18,852	15,963	12,240	17,802	64,858

Për të mbajtur siç duhet në kontroll dhe në fokus prioritetet, si dhe për të reflektuar mjedisin dinamik, ndryshimet në këtë Strategji, deri në fund të periudhës së zbatimit të saj, do të jenë të kufizuara. Plani i Veprimet dhe Pasaporta e Treguesve do të jenë më fleksibël dhe do të rishikohen sipas nevojës, dhe rrjedhimisht me zbatimin e saj mund të ndryshojnë dhe masat e aktivitetet.

Figura 1: Përmbledhja e Strategjisë Afatmesme të të Ardhurave

Shtylla 1: Rishikimi i politikës tatimore	Shtylla 2: Mirëadministrimi tatimor	Shtylla 3 : Mirëadministrimi doganor
Rishikimi i politikës tatimore të tatimeve indirekte (taksave mbi konsumin)	Zvogëlimi i hendekut të pajtueshmërisë në lidhje me TVSh-në	Modernizimi i proceseve të biznesit, duke përfshirë centralizimin e funksionit të profilizimit të riskut
Rishikimi i politikës tatimore të tatimeve direkte	Ulja e pagesave me para në dorë në ekonomi	Zhvillimi i aftësive të zgjeruara analitike të të dhënave
Rishikimi i politikës tatimore të taksës mbi pasuritë e paluajtshme	Verifikimi i të ardhurave dhe kontrolli i pasurive të pajustificuara	Rritja e investimeve në zhvillimin e sistemeve të teknologjisë së informacionit
	Zvogëlimi i shmangies tatimore	Zhvillimi dhe zbatimi plotësisht i një kornizë integriteti për të ndihmuar në ndërtimin e besimit të komunitetit
	Reduktimi i punës së padëkluarar dhe të nëndëklarimit të pagës reale	Rritja e numrit të operatorëve ekonomikë të autorizuar
	Reduktimi i kostove të pajtueshmërisë dhe rritja e sigurisë tatimore dhe besimit tek administrata tatimore.	Implementimi i Dritares së Vetme Kombëtare (<i>National National Single Window</i>)
	Përmirësimi i cilësisë së shërbimit të ofruar nga Administrata Tatimore (AT) nëpërmjet zhvillimit të kapaciteteve institucionale të administratës tatimore	Implementimi i Sistemit të Ri të Kompjuterizuar të Transitit (NCTS)
		Rritja e bashkëpunimit në luftën kundër informalitetit, kontrabandës, korrupsionit dhe importit të mallrave të falsifikuara
		Zgjerimi i shkëmbimit të

		informacionit me partnerët vendas dhe ndërkombëtarë për të përmirësuar profilin e riskut
--	--	--

III.1 Përputhshmëria e Strategjisë me Dokumentet Strategjike

Kjo Strategji është në përputhje me dokumentet strategjike të miratuara së fundmi dhe më konkretisht.

a) Raporti i Komisionit Evropian për Shqipërinë, nëntor 2023 dhe Agjendës së Reformës të Planit të Rritjes

Raporti Vjetor i BE-së për Shqipërinë, në nëntor 2023, i ka dhënë theks të veçantë rëndësisë së miratimit të SAA-së. Miratimi i SAA-së për periudhën 2024–2027 është një nga parakushtet që Shqipëria duhet të përmbushë në kuadër të dokumentit të politikave “Agjenda e Reformës Kombëtare 2024–2027”, në kuadër të instrumentit të Bashkimit Evropian “Reforma dhe Lehtësia e Rritjes për Ballkanin Perëndimor”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Ndër kushtet e vendosura në këtë Agjendë të Reformave është rritja e mobilizimit të të hyrave të brendshme dhe gjithëpërfshirja e sistemit tatimor, veçanërisht përmes miratimit dhe zbatimit të Strategjisë Afatmesme të të Ardhurave (SAA). Gjithashtu, reforma të tjera prioritare dhe të rëndësishme, në lidhje me mirëadministrimin tatimor që përfshijnë:

- një vlerësim të të gjitha përjashtimeve tatimore me synimin për të vendosur nëse ndonjë prej tyre mund të hiqet gradualisht dhe me synimin për të vendosur nëse përdorimi i grupeve të të dhënave nga palët e treta që mundëson hetime të pajustificuara të pasurisë mund të jetë i mundur (qershor 2025);
- përfshirja në SAA dhe zbatimi i masave, në lidhje me përmirësimin e administratës tatimore, si përdorimi i të dhënave nga palët e treta (energja, uji, regjistrimi i automjeteve);
- të mundësojë programin e administratës tatimore të hetimeve të pasurisë së pajustificuar mbi pasuritë e tatimpaguesve (dhjetor 2026);
- plotësimi i regjistrimit të pasurisë së tatimpaguesve për 10% të tatimpaguesve (dhjetor 2026);
- parambushja e deklaratave të TVSh-së dhe tatimit mbi të ardhurat personale (duke përdorur informacionin nga Fiskalizimi) (dhjetor 2026);
- të forcojë performancën e hetimeve kundër mashtrimit tatimor (qershor 2027);
- kryerja e analizës së të dhënave nga deklaratat e DIVA (dhjetor 2024);
- përdorimi i të dhënave nga regjistri i shoqërive (energja elektrike, uji), regjistrimi i automjeteve, bashkitë për të mundësuar programin e administratës tatimore të hetimeve të pasurisë së pajustificuar mbi pasuritë e tatimpaguesve (dhjetor 2026);
- administrata tatimore plotëson regjistrin e pasurisë së tatimpaguesve për 10% të tatimpaguesve (dhjetor 2026);
- kryerja e procedurave të kontrollit për 200 tatimpaguesit e përzgjedhur, bazuar në vlerësimin e rrezikut (dhjetor 2026);
- paraparaqitja e deklaratave të TVSh-së dhe deklaratave të tatimit mbi të ardhurat personale (duke përdorur informacionin nga fiskalizimi) në 100% (dhjetor 2026);
- hartimi dhe zbatimi i deklaratave të reja për deklaratat e tatimit mbi të ardhurat personale (dhjetor 2026);
- hartimi dhe miratimi i Planit të Integritetit (qershor 2025);
- kryhen të paktën 500 hetime tatimore, bazuar në planet vjetore (qershor 2027).

Kjo strategji ka përfshirë në Shtyllën 1 dhe Shtyllën 2 të gjitha këto kushte të Planin të Rritjes së Agjendës së Reformave të KE-së, me masa dhe aktivitete konkrete për zbatimin e plotë të tyre sipas afateve kohore dhe treguesve.

b) Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim

Në janar 2023 u miratua me vendim të Këshillit të Ministrave Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI) për periudhën 2023–2030. Sipas këtij dokumenti strategjik:

- Reformat kryesore tatimore dhe administrative të parashikuara për periudhën 2022–2030 kanë në fokus përmirësimin e politikave tatimore, me synim rritjen e neutralitetit të sistemit tatimor dhe tatimor, eliminimin e deformimeve të krijuara në sistem, si dhe përmirësimin e nivelit të normave tatimore, me qëllim stimulimin e sektorëve prioritarë të ekonomisë.

- Reformat tatimore 2022–2030 pritet të rrisin të ardhurat tatimore, duke e çuar raportin “Të ardhurat tatimore”/PBB në 30% nga 25.2% që rezultoi në vitin 2019.

- Dy drejtimet kryesore mbi të cilat do të mbështetet reforma e sistemit tatimor shqiptar dhe mbi të cilat do të bazohet Strategjia e të Ardhurave janë:

- Rishikimi dhe ridizenjimi i politikave tatimore nëpërmjet analizës së efekteve të politikave aktuale dhe korrigjimeve të nevojshme për periudhën afatmesme;

- Përmirësimi i procedurave të administratës tatimore dhe doganore, me qëllim rritjen e efikasitetit të administratës fiskale nëpërmjet investimeve në teknologji, burimet njerëzore dhe modernizimin e procedurave operacionale;

- Konsensusi politik sa më i gjerë për objektivat afatmesme, në lidhje me të ardhurat e nevojshme për financimin e shpenzimeve publike të dakordësuara;

c) Kuadri Makroekonomik dhe Fiskal 2025–2027

Kuadri Makroekonomik dhe Fiskal 2025–2027, miratuar me VKM-në nr. 399, datë 19.6.2024, ka përcaktuar se në vitin 2027 të ardhurat totale të buxhetit të shtetit do të jenë 29.1% e PBB-së, ndërsa të ardhurat tatimore në masën 27.7% e PBB-së.

ç) Strategjia e Menaxhimit të Financave Publike (MFP) 2023–2030

Strategjia e Menaxhimit të Financave Publike (MFP) dhe Plani i Veprimit për periudhën 2023–2026 paraqet reformat e planifikuara për përmirësimin e sistemeve të MFP-së. Qëllimi i përgjithshëm i strategjisë është të krijojë një sistem të menaxhimit të financave publike që garanton transparencë, llogaridhënie, disiplinë fiskale dhe efikasitet në përdorimin e burimeve publike për ofrimin e shërbimeve publike të përmirësuara dhe zhvillimit ekonomik që të sigurojë një integrim të lehtë dhe të shpejtë të Shqipërisë në Bashkimin Evropian (BE).

Masat e reformës së MFP-së janë formuluar në gjashtë shtylla, një ndër të cilat është shtylla 3 “Menaxhimi dhe mobilizimi i të ardhurave”. Objektivi specifik i kësaj shtylle është përmirësimi i sistemeve të menaxhimit doganor dhe të të ardhurave, me synim rritjen e të ardhurave dhe përmirësimin e ofrimit të shërbimeve dhe mbulon komponentët: Menaxhimi i Taksave, Menaxhimi i Taksës së Pasurisë (Kadastra Fiskale) dhe Menaxhimi Doganor. Miratimi i Strategjisë Afatmesme të të Ardhurave, 2024–2027 është një ndër masat e parashikuara nën këtë shtyllë.

d) Dokumenti i Programit të Reformave Ekonomike (ERP)

Në janar 2024 është miratuar Dokumenti i ERP-së, me VKM-në nr. 12, datë 11.1.2024, “Për miratimin e programit të reformave ekonomike (ERP) 2024–2026”, sipas të cilit administrata tatimore ka përcaktuar 6 masa (në linjë me SAA-në 2022–2026) nën reformën “Forcimi i luftës kundër informalitetit”.

IV. Shtylla 1: Rishikimi i politikave tatimore

IV.1 Hyrje

Në 10 vitet e fundit, Shqipëria ka rritur gradualisht përqindjen e të ardhurave të mbledhura në raport me PBB-në. Ecuria e mbledhjes së të ardhurave është parashikuar të vazhdojë me trend rritës të raportit të ardhura/PBB edhe sipas parashikimeve të bëra në Kuadrin Makrofiskal 2025–2027 të Ministrisë së Financave, ndërkohë që, kërkesat për më tepër shpenzime buxhetore të tilla si investime, mbrojtjen sociale, rritje pensionesh apo paga, do të vijojnë në rritje.

Nëse do të ndërmerren ndryshime që lidhen me legjislacionin tatimor dhe kryesisht mirëadministrimin tatimor, këto përqindje të të ardhurave ndaj PBB-së duhet dhe mund të rriten edhe më tej, duke suportuar në këtë mënyrë rritjen e presionit për shpenzime dhe duke garantuar realizimin e objektivave për deficitin buxhetor dhe borxhin publik.

Nën seksionin II.2. 2. Politikat tatimore – Përfshirjet dhe normat e reduktuara përshkruhen të ardhurat tatimore të munguara nga përfshirjet tatimore dhe incentivat tatimore që janë në fuqi. Një kusht i rëndësishëm i vendosur për Shqipërinë në Planin e Rritjes së Agjendës së Reformës së BE-së është i lidhur me vlerësimin e të gjithë përfshirjeve tatimore brenda qershorit 2025, me qëllim që të vendoset nëse ndonjë mund të hiqet gradualisht. Për këtë arsye, nën këtë shtyllë, janë të detajuara aktivitetet që do të ndërmerren për kryerjen e këtyre vlerësimeve. Për këto aktivitete, asnjë vlerësim i të ardhurave shtesë nuk përfshihet në këtë Strategji sepse do të varet nga masat tatimore që do të vendosen të hiqen gradualisht bazuar në këto vlerësime.

Shtesa në të ardhurat e buxhetit të shtetit lidhet më së shumti me faktorët e mëposhtëm:

i. Të ardhura shtesë nga strategjia dhe reformat tatimore që do të ndërmerren dhe që lidhen me mirëadministrimin fiskal në administratën tatimore dhe atë doganore. Ky do të jetë edhe burimi kryesor i rritjes së të ardhurave në 4 vitet në vijim.

ii. Të ardhura shtesë nga zbatimi i akteve ligjore dhe nënligjore që mbulojnë sektorë të veçantë të ekonomisë:

- Zbatimi i dispozitave të reja të legjislacionit në fushën e turizmit nëpërmjet: i. verifikimit të kapaciteteve dhe llogaritjen e detyrimeve tatimore mbi bazën e koeficientit minimal të shfrytëzimit të kapaciteteve, sipas përcaktimeve në aktet nënligjore në zbatim të tij; ii. marrjen e informacionit nga *site*-t ndërkombëtare të prenotimeve të shërbimit të akomodimit. Dispozitat e reja në legjislacionin e turizmit do të impaktojnë njëkohësisht: i. tatimin mbi vlerën e shtuar; ii. tatimin mbi fitimin e njësjës akomoduese; dhe iii. tatimin mbi të ardhurat personale nga qiradhënia afatshkurtër e individëve.

- Zbatimi i dispozitave të VKM-së nr. 132, datë 7.3.2024, “Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme “ndërtesa”, e bazës së taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit, dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kriterëve dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit”. Ndryshimet e këtij vendimi do të impaktojnë bazën e llogaritjes së: i. tatimit mbi fitimin e ndërmarrjeve të ndërtimit; ii. tatimit mbi të ardhurat personale nga transferimi i së drejtës së pronësisë; dhe iii. taksës lokale mbi pasurinë (ndërtesa).

iii. Të ardhura shtesë nga tatimet/taksat indirekte – tatimet/taksat mbi konsumin. Këto të ardhura do të sigurohen kryesisht nga zbatimi i akteve ligjore që do të miratohen bazuar në rezultatet dhe vendimet e marra pas analizës së ndikimit të politikave fiskale në të ardhurat e deritanishme, nga rishikimi i përfshirjeve, kryesisht nga TVSh-ja, të disa furnizimeve të mallrave dhe shërbimeve, të cilat kanë përfunduar misionin për të cilin janë projektuar ose që kanë rezultuar jo me ndikimet e pritura pozitive, si dhe nga zbatimi i skedulit të rritjes të nivelit të akcizave për mallra, të tillë si cigaret dhe duhani.

iv. Të ardhura shtesë nga tatimet direkte. Këto të ardhura do të sigurohen nga ndryshime të mundshme në sistemin ligjor që prekin tatimet direkte, të tilla si:

- analiza dhe rishikimi i tarifave preferenciale sektoriale;
- analiza për politika fiskale më të drejta, në funksion të mbrojtjes së ambientit.

v. Të ardhura shtesë nga taksat e pasurisë së paluajtshme. Këto të ardhura do të sigurohen nëpërmjet rishikimit të sistemit tatimor mbi këto pasuri, rritjes së eficiencës së Kadastrës Tatimore, si dhe rishikimit të përfshirjeve të shumta nga këto taksa, përfshirë edhe rishikimin e tarifës së taksës për kategori të caktuara rezidenciale apo disponim të pasurive rezidenciale të dyta dhe të treta.

Nevojitet që krahas dizenjimit të një sistemi tatimor të qëndrueshëm vëmendja të përqendrohet edhe tek nevojat për rritjen e kapaciteteve institucionale, me qëllim hartimin dhe zbatimin e reformave që ndërmerren.

- Rritja e besimit, stabilitetit dhe qëndrueshmërisë në sistemit tatimor shqiptar, të cilat çojnë drejt zbatimit vullnetar të ligjit tatimor nga publiku tatimpagues, mund të realizohen nëpërmjet krijimit të një sistemi të qëndrueshëm, të parashikueshëm dhe frenues ndaj ndryshimeve të shpeshta.

- Forcimi i kapaciteteve, me qëllim kryerjen e analizave të detajuara dhe të thelluara të politikave tatimore të ndjekura, efekteve të tyre në ekonomi dhe në sjelljen e tatimpaguesve janë të domosdoshme për dizenjimin e perspektivës dhe të ndryshimeve që mund të bëhen, në funksion të përmirësimeve të sistemit tatimor dhe rritjes së transparencës së tij.

- Forcimi dhe rritja e kapaciteteve në strukturat e administratës tatimore (tatimore dhe doganore) si dhe në Ministrinë e Financave (Drejtoria e Përgjithshme e Politikave Tatimore), me qëllim menaxhimin e zbatimit të Strategjisë Afatmesme të të Ardhurave, përbëjnë elemente të rëndësishme për mbarrëvajtjen e procesit dhe suksesin e kësaj Strategjie.

Objektivi

Objektivi kryesor për periudhën afatmesme, 2024–2027, është vlerësimi i të gjitha përjashtimeve tatimore dhe stimuljeve brenda qershorit 2025, në bazë të të cilit do të bëhet rishikimi i politikës tatimore për të minimizuar përjashtimet tatimore dhe taksat me norma të reduktuara, në përputhje me kuadrin ligjor evropian dhe Planin e Rritjes së Agjendës së Reformës së KE-së.

Komponenti 1.1: Rishikimi i politikës tatimore të tatimeve indirekte (taksave mbi konsumin)

Synohet që brenda vitit 2027 të kemi një rishikim të politikës tatimore bazuar në një analizë e detajuar të të gjitha përjashtimeve/shkallëve të reduktuara për tatimin mbi vlerën e shtuar, përfshirë pragun e regjistrimit dhe akcizën, për të përcaktuar nëse ndonjë prej tyre mund të hiqet gradualisht, si dhe të niveleve të akcizës krahasuar me ato minimale të BE-së.

Masat për vitet 2024–2027:

- Masa 1.1.1 Analiza e përjashtimeve/normave të reduktuara në TVSh;
- Masa 1.1.2 Analiza e kufirit minimal (pragu i regjistrimit) për TVSh-në;
- Masa 1.1.3 Hartimi i akteve konkrete ligjore për TVSh-në bazuar në rezultatet dhe vendimet e marra pas analizës;
- Masa 1.1.4 Analiza e niveleve të akcizës duke synuar harmonizimin me BE-në;
- Masa 1.1.5 Hartimi i akteve ligjore konkrete për akcizën bazuar në rezultatet dhe vendimet e marra pas analizës;
- Masa 1.1.6 Hartimi i kalendarit të ri të nivelit të akcizës së duhanit;
- Masa 1.1.7 Analiza e skemave fiskale incentivuese (direkte dhe indirekte) si pjesë e politikave për nxitjen e përdorimit të energjisë së rinovueshme, eficiencës së energjisë dhe performancës energetike në ndërtesa.

Komponenti 1.2: Rishikimi i politikës tatimore të tatimeve direkte

Synohet që brenda vitit 2027 të kemi një analizë të detajuar të të gjitha përjashtimeve dhe normave të reduktuara për tatimin mbi të ardhurat dhe përafrim me legjislacionin e BE-së për tatimet direkte.

Masat për vitet 2024–2027:

- Masa 1.2.1 Analiza e skemës tatimore të personave fizikë;
- Masa 1.2.2 Vlerësimi i të gjitha përjashtimeve dhe normave të reduktuara në ligjin për tatimin mbi të ardhurat;
- Masa 1.2.3 Harton aktin ligjor bazuar, nëse është e nevojshme, në analizën e përjashtimeve dhe normave të reduktuara dhe skemën tatimore të personave fizikë;
- Masa 1.2.4 Marrëveshjet për shmangien e taksimit të dyfishtë;
- Masa 1.2.5 Plotësimi i angazhimeve për tatimin ndërkombëtar, kryesisht ato në kuadër të projektit ndërkombëtar BEPS;
- Masa 1.2.6 Harmonizimet e plota të legjislacionit vendas me *acquis* të BE-së në fushën e taksimit të drejtpërdrejtë;
- Masa 1.2.7 Analizon përjashtimet nga taksat dhe tarifat kombëtare, duke përfshirë taksat mjedisore;
- Masa 1.2.8 Hartimi i aktit ligjor bazuar në analizën e taksave kombëtare, përfshirë taksat mjedisore.

Komponenti 1.3: Rishikimi i politikës tatimore të taksimit të pasurisë së paluajtshme

Synohet miratimi i ligjit të ri për pasuritë e paluajtshme, taksën e pasurisë dhe fillimi i zbatimit të tij.
Masat për vitet 2024–2027:

- Masa 1.3.1 Miratimi i ligjit dhe konsolidimi i Kadastrës Tatimore;
- Masa 1.3.2 Popullimi me të dhëna të Kadastrës Tatimore;
- Masa 1.3.3 Fillimi i taksimit të pasurive të paluajtshme mbështetur në ligjin e ri.

IV.2 Komponenti 1.1 Rishikimi i politikës tatimore të tatimeve indirekte (taksave mbi konsumin)

Objektivi:

Synimi është që brenda vitit 2027 të bëhet një rishikim i politikës tatimore bazuar në një analizë të detajuar (brenda qershor 2025) të të gjitha përjashtimeve të furnizimeve, normave të reduktuara, si dhe të niveleve të akcizës të lidhura me nivelet minimale të BE-së për këtë taksë, me synimin për të përcaktuar nëse ndonjë prej tyre mund të hiqet gradualisht.

Konteksti

Një nga kushtet e vendosura në Planin e Rritjes së Agjendës së Reformave të KE-së lidhet me vlerësimin e të gjitha përjashtimeve apo stimuljeve tatimore brenda qershorit 2025. Për këtë arsye, ky komponent për taksat indirekte është hartuar bazuar në këtë kusht. Për këtë arsye, sipas këtij komponenti, vlerësimi i të ardhurave shtesë lidhet vetëm me efektet në të ardhurat nga akciza, nga zbatimi i kalendarit të rritjes së akcizës së duhanit.

Tatimet mbi konsumin ose tatimet indirekte, siç janë TVSh-ja dhe akciza, zënë një peshë të konsiderueshme në të ardhurat e buxhetit. Në 10 vitet e fundit ato janë rreth 11.4% të PBB-së dhe në strukturën e të ardhurave tatimore, përbëjnë rreth 46.4% të tyre. Për shkak të rëndësisë dhe peshës së madhe që kanë në të ardhurat tatimore, është e nevojshme t'i kushtohet vëmendje e veçantë politikave tatimore që duhet të ndiqen për tatimet indirekte (tatimet mbi konsumin).

Theksojmë se rritjet e parashikuara në programet buxhetore afatmesme nga të ardhurat nga taksat e konsumit, bazuar edhe në këtë Strategji, do të parashikohen kryesisht si rezultat i analizës dhe rishikimit të përjashtimeve të shumta, reduktimit të rimbursimeve joekonomike apo eliminimi i disa furnizimeve me tarifa të reduktuara që janë aplikuar, por që nuk kanë qenë efektive. Rritja e të ardhurave në buxhet do të vijë për shkak të rishikimit të politikave ekzistuese përjashtuese, apo eliminimit të disa furnizimeve të TVSh-së me normë të reduktuar, si dhe nga rritja e nivelit të akcizës së duhanit sipas kalendarit të ri.

Peshën më të madhe të efekteve pritet ta sjellë reduktimi i përjashtimeve joefektive të përcaktuara në ligjin nr. 92/2014, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, apo përjashtimeve të cilat do të zëvendësohen nëpërmjet politikave subvencionuese për produkte, sektorë apo operatorë specifikë.

Gjithashtu, do të mbahet në vëmendje dhe analizimi i politikave fiskale incentivuese në fushën e energjisë së rinovueshme, eficiencës së energjisë dhe performancës energjetike në ndërtesa, politika të cilat do të fillojnë materializimin e tyre, në kuadër të përafrimit të legjislacionit kombëtar për këto fusha me atë të BE-së.

Prioriteti:

Prioriteti për periudhën 2024–2027 është:

- Zbatimi i kushteve të vendosura në Planin e Rritjes së Agjendës së Reformës për kryerjen e një vlerësimi të të gjitha përjashtimeve dhe furnizimeve me normë të reduktuar nga tatimet indirekte, brenda qershorit 2025.

- Analizë e detajuar lidhur me efektivitetin e incentivave të dhëna për TVSh-në dhe akcizën.

Masat dhe aktivitetet

Masa	Aktiviteti	Fillimi	Mbarimi	Institucioni përgjegjës
Masa 1.1.1 Analizë e përjashtimeve/normave të reduktuara në TVSh	Aktiviteti 1.1.1: Kryerja e një analize, lidhur me efektivitetin e përjashtimeve/normave të reduktuara në TVSh, me synimin për të përcaktuar nëse ndonjë mund të hiqet	2024	Qershor 2025	MF, DPT, DPD dhe me asistencën e FMN-së

	gradualisht.			
Masa 1.1.2 Analiza e (pragut të regjistrimit për TVSh-në	Aktiviteti 1.1.2.1: Kryerja e një analize, në lidhje me prapen e regjistrimit të TVSh-së	2024	Qershor 2025	MF, DPT, DPD dhe me asistencën e FMN-së
Masa 1.1.3 Hartimi i akteve konkrete ligjore për TVSh-në bazuar në rezultatet dhe vendimet e marra pas analizave	Aktiviteti 1.1.3.1: Përgatitja e projekt ndryshimeve ligjore bazuar në vendimin e marrë pas analizës dhe në përputhje me <i>acquis</i> të BE-së	2024	Në varësi të raportit	MF, me asistencë nga TAIFEX
Masa 1.1.4 Analiza e niveleve të akcizës me synim harmonizimin me BE-në	Aktiviteti 1.1.4.1: Kryerja e një analize, në lidhje me nivelet e akcizës dhe nivelet minimale të BE-së	2024	Qershor 2025	MF, DPD
Masa 1.1.5 Hartimi i akteve konkrete ligjore për akcizën, bazuar në rezultatet dhe vendimet e marra pas analizave	Aktiviteti 1.1.5.1: Përgatitja e projekt ndryshimeve ligjore bazuar në vendimin e marrë pas analizës dhe në përputhje me <i>acquis</i> të BE-së	2024	Në varësi të raportit	MF
Masa 1.1.6 Hartimi i kalendarit të ri të nivelit të akcizës së duhanit	Aktiviteti 1.1.6.1: Hartimi dhe miratimi i amendamentit në ligjin e akcizës, lidhur me kalendarin e ri të tarifave të duhanit	2026	2026	MF, DPD, dhe me asistencën e FMN dhe DG TAXUD
Masa 1.1.7 Analiza e skemave fiskale incentiveve (direkte dhe indirekte) si pjesë e politikave për nxitjen e përdorimit të energjisë së rinovueshme, eficientës së energjisë dhe performancës energetike në ndërtesa	Aktiviteti 1.1.7.1: Kryerja e një analize për incentive fiskale (direkte dhe indirekte) si pjesë e politikave për nxitjen e përdorimit të energjisë së rinovueshme, eficientës së energjisë dhe performancës energetike, të	2025	2026	MF dhe MIE
	Aktiviteti 1.1.7.2: Përgatitja e projekt ndryshimeve ligjore bazuar në vendimin e marrë pas analizës dhe në përputhje me <i>acquis</i> të BE-së, në bashkëpunim të dy institucioneve.	2027	2027	MF dhe MIE


Treguesit e performancës dhe vlerat e synuara

Treguesi	Vlera bazë (viti)	Vlera e synuar			
		2024	2025	2026	2027
Raporti mbi analizën e përjashtimeve/normave të reduktuara të TVSh-së			Analiza e kryer		
Raporti mbi analizën e pragut të regjistrimit të TVSh-së			Analiza e kryer		
Ndryshimi i ligjit për për TVSh-në bazuar në rezultatet dhe vendimet e marra pas analizës			Në varësi të Raportit	Në varësi të Raportit	Në varësi të Raportit
Raport mbi analizën e niveleve të akcizës, lidhur me nivelet minimale të BE-së			Analizë e kryer		
Hartimi dhe miratimi i ndryshimeve në ligjin për akcizat, për rinovimin e kalendarit të cigareve dhe duhanit				Hartimi dhe miratimi i ligjit	
Rritja e të ardhurave doganore nga rritja e normave të akcizës së cigareve dhe duhanëve		0.03% e PBB-së	0.03% e PBB-së	0.03% e PBB-së	0.03% e PBB-së

Masa 1.1.1 Analiza e përjashtimeve/normave të reduktuara në TVSh

Tatimi mbi Vlerën e Shtuar është burim kryesor dhe më i rëndësishëm në strukturën e të ardhurave tatimore, duke siguruar rreth 8.7% të PBB-së në 10 vitet e fundit. Shqipëria aplikon TVSh-në me bazë të gjerë, me shkallë standarde 20% dhe dy shkallë të reduktuara 6% dhe 10%. Legjislacioni në fushën e këtij tatimi është në përputhje të pjesshme me direktivën 2006/112/CE të Këshillit “Mbi sistemin e përbashkët të Tatimit mbi Vlerën e Shtuar”, të ndryshuar.

Grafik 5 : Të ardhurat nga TVSh-ja në % ndaj PBB-së në Shqipëri



Burimi: Ministria e Financave

Nëse do supozonim se çdo mall dhe shërbim i furnizuar në Republikën e Shqipërisë do të ngarkohej me TVSh sipas shkallës standarde 20%, rezulton se humbja e të ardhurave tatimore për shkak të përjashtimeve/shkallëve të reduktuara të TVSh-së të parashikuara në legjislacion, llogaritet në rreth

4,7–4,8 për qind e PBB-së. Reduktimi gradual dhe eliminimi i përjashtimeve të papërshtatshme dhe pa efekt ekonomik thelbësor nga TVSh-ja, ka impakt shumë të rëndësishëm, pasi e bën TVSh-në më transparente dhe më të thjeshtë për t'u mbledhur dhe administruar. Është e nevojshme që të eliminohen disa përjashtime nga ky tatim, ato që nuk kanë efekt dhe nuk realizojnë qëllimet për të cilat janë dizenuar, si dhe e komplikojnë në mënyrë të panevojshme sistemin dhe e bëjnë të vështirë administrimin efikas të tij. Në vende me sistem fiskal relativisht të ri sikurse është vendi ynë, reduktimet e normave të tatimeve të konsumit, apo edhe përjashtimet nga tatimi, nuk shkojnë plotësisht në favor të konsumatorit, qytetarit, për të cilin janë dizenuar por “përfitojnë” nga sipërmarrjet në zinxhirin e transaksioneve ku kalon malli/shërbimi.

Për këtë arsye, lista e përjashtimeve/normave të reduktuara të tatimit duhet të jetë objekt analizimi dhe matje performance të vazhdueshme, sikurse çdo përjashtim/normë e reduktuar apo incentivë tjetër duhet të ketë karakter të përkohshëm dhe jo të përhershëm. Rishikimi i politikave tatimore në fushën e Tatimit mbi Vlerën e Shtuar do të synojë harmonizimin e mëtejshëm me legjislacionin kuadër të BE-së. Gjithashtu, do të synojë heqjen apo vendosjen e afateve kufizuese për përjashtime/shkallë të reduktuara të implementuara në vitet e mëparshme.

Së pari do analizohen të gjitha incentivat/përjashtimet/normat e reduktuara të cilat kanë qenë politike të brendshme e vendit tonë, dhe më pas të gjitha inventivat/përjashtimet/normat e reduktuara që janë të përfshira si të tilla në direktivën 2006/112/CE e Këshillit dhe Direktivat amenduese të saj.

Në këtë kuadër, rishikimi i politikave tatimore për TVSh-në do përfshijë: analizën e listës së përjashtimeve nga TVSh-ja në import dhe brenda vendit, analizën e furnizimeve me norma të reduktuara TVSh-je, si dhe analizën e pragut të regjistrimit për TVSh-në.

Aktiviteti 1.1.1.1: Kryerja e një analize, në lidhje me efektivitetin e listës së përjashtimeve/normave të reduktuara të TVSh-së, për të përcaktuar nëse ndonjë prej tyre mund të hiqet gradualisht.

Ministria e Financave do të mbështetet nga Fondi Monetar Ndërkombëtar për kryerjen e këtij vlerësimi. Pjesë e kësaj asistence teknike nga FMN-ja do të jetë kryerja e një analize kostoje përfitimi për dy ose tre lloje përjashtimesh/norma të reduktuara, të cilat do të përcaktohen ndërmjet FMN-së dhe MF-së. Në muajin nëntor 2024 është zhvilluar takimi i parë me FMN-në për këtë çështje dhe në vijim do të përgatitet kalendari i misionëve të FMN-së për janar–qershor 2025.

Aktualisht është bërë një punë parapërgatitore në vlerësimin e të ardhurave të munguara nga përjashtimi nga TVSh-ja dhe norma e reduktuar e TVSh-së.

Gjithashtu, MF-ja me asistencën e BB-së dhe FMN-së po përdor Modelin e TVSh-së që është në përditësim me të dhënat e fundit të INSTAT-it në Tabelën Input Output 2022. Gjithashtu, FMN-ja do të asistojë MF-në në përditësimin e këtij modeli. Modeli i TVSh-së lejon të vlerësohet se sa do të ishte mbledhja e TVSh-së me pajtueshmëri të plotë, në kushtet e strukturës aktuale të politikës dhe çdo strukture hipotetike të politikës.

Sipas këtij aktiviteti, lista e përjashtimeve/normave të reduktuara të TVSh-së ekzistuese do t'i nënshtrohet analizës dhe matjes së performancës. Vlerësimet do të synojnë harmonizimin e mëtejshëm me legjislacionin kuadër të BE-së dhe do të synojnë heqjen ose vendosjen e periudhave të kufizimit për përjashtimet/normat e reduktuara të zbatuara në vitet e mëparshme.

Fillimisht do të analizohen përjashtimet/normat e reduktuara që kanë qenë politika e brendshme e vendit tonë dhe më pas përjashtimet/normat e reduktuara që përfshihen si të tilla në Direktivën e Këshillit 2006/112/CE dhe ndryshimin e saj.

Ky vlerësim do të përfshijë:

1. Analizën e listës së përjashtimeve nga TVSh-ja në import dhe brenda vendit;
2. Analizën e furnizimeve me norma të reduktuara dhe analizën e pragut të regjistrimit për TVSh-në.

Nenet 51, 53, 54 dhe 56, të ligjit nr. 92/2014, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, përcaktojnë listën e furnizimeve që janë të përjashtuara nga TVSh-ja brenda vendit dhe në import. Lista e furnizimeve të përjashtuara do të rishikohet sipas parimeve të mëposhtme:

- do trajtohen si furnizime të përjashtuara, ato furnizime të parashikuara si të tilla nga Direktiva 2006/112/CE e Këshillit, e ndryshuar;

- efektiviteti i përjashtimeve brenda vendit dhe veçanërisht në import.

Do rishikohet lista e përjashtimeve nga TVSh-ja në import, me synimin e heqjes së përjashtimeve të panevojshme. Në kushtet kur skema e rimbursimit të TVSh-së nga viti 2020 e në vijim funksionon brenda kornizave dhe afateve të përcaktuara në legjislacionin për rimbursimet, disa përjashtime në import, të cilat janë akorduar 10 apo 15 vite më parë, për shkak të problematikës dhe vonesave në rimbursimin e TVSh-së për investitorët e mëdhenj, nuk ka arsye objektive të vazhdojnë më tej. Këto ndryshime kanë filluar të miratohen nga viti 2022 e në vijim.

Neni 49 i ligjit të TVSh-së parashikon një listë të furnizimeve që trajtohen me normë të reduktuar të TVSh-së prej 6%, si: turizmi, shërbimi i reklamave në media audiovizive, librat etj. dhe një normë e reduktuar prej 10% për inputet bujqësore. Kjo listë do të rishikohet sipas të njëjtave parime siç u tha më sipër për përjashtimet.

Masa 1.1.2 Analiza e pragut të regjistrimit për TVSh-në

Në 2019, asistenca teknike e FMN-së sugjeroi rritje të pragut të regjistrimit për TVSh-në, pragu në 8 milionë lekë në vit, e shoqëruar kjo me lejimin e regjistrimit vullnetar në TVSh të tatimpaguesve me qarkullim 5–8 milionë lekë, por jo më poshtë se 5 milionë lekë. Po ashtu, u sugjerua që pragu duhet të jetë unik për të gjitha kategoritë e tatimpaguesve. Pas analizave ky sugjerim u implementua në legjislacionin për TVSh-në, me përjashtim të nivelit të pragut, i cili nga 8 milionë lekë u rrit në 10 milionë lekë në vit, në fuqi nga janar 2021. Para këtij ndryshimi, pragu i regjistrimit në TVSh ishte dhe qarkullimi mbi 2 milionë lekë në vit, ndërkohë që për tatimpaguesit që ofrojnë shërbime specifike, pragu i regjistrimit ishte zero lekë.

Tatimpagues të regjistruar në skemën e TVSh-së në vitin 2023 të ndarë sipas nivelit të qarkullimit janë si në tabelën 8 më poshtë. Me rritjen e pragut të regjistrimit në TVSh deri në 10 milionë lekë në vit, rezulton se krahasuar me skemën e vjetër, *rreth 48 mijë tatimpagues me xhiro të deklaruar 70.4 miliardë lekë, me TVSh të llogaritur për shitje 14 miliardë lekë dhe TVSh potenciale për t’u paguar 3–4 miliardë lekë, kanë dalë nga skema e TVSh-së*. Aktualisht janë të regjistruar vullnetarisht dhe paguajnë TVSh-në rreth 19 mijë subjekte me qarkullim nën pragun detyrues për regjistrim TVSh-je.

Tabela 8: Tatimpaguesit e regjistruar në skemën e TVSh-së në vitin 2023

Subjektet sipas xhiros	Numri i subjekteve me përgjegjësi TVSh-je (deklarues TVSh-je)
0–2 milionë	5,920
2–5 milionë	4,039
5–8 milionë	3,439
8–9 milionë	800
9–10 milionë	841
10–11 milionë	821
11–12 milionë	873
12–15 milionë	2,370
15–20 milionë	1,700
20–30 milionë	2,419
30–50 milionë	2,777
mbi 50 milionë	7,284
Totali	33,283
*Kanë deklaruar TVSh por jo TF/TFTH	219
Totali	33,502

Duhet pasur parasysh që hegja nga skema e TVSh-së së këtij grupi tatimpaguesish reduktoi TVSh-në e llogaritur prej tyre, TVSh-ja e cila u faturohet tatimpaguesve të tjerë që janë në skemën e TVSh-së dhe për të cilët ajo është e zbritshme. Pra efekti në uljen e të ardhurave nga rritja e pragut të TVSh-së duhet të marrë në konsideratë vetëm furnizimet që tatimpaguesit me qarkullim 0–10 milionë lekë bëjnë për konsumatorët finalë. Gjithashtu, duhet të merret në konsideratë edhe teprica kreditore e trashëguar nga tatimpaguesit e TVSh-së, e cila redukton TVSh-në e pagueshme çdo muaj.

Aktiviteti 1.1.2.1: Kryerja e një analize, në lidhje me pragun e regjistrimit të TVSh-së

Në kuadrin e kësaj Strategjie dhe të ndryshimeve të ndodhura në strukturën e ekonomisë shqiptare pas ndryshimit të fundit të pragut të regjistrimit për TVSh-në, është e nevojshme të kryhet analiza e mëtejshme e efekteve dhe nevojës/domosdoshmërisë për të ndryshuar/mosndryshuar pragun e regjistrimit, gjithmonë në funksion të miradministrit të zinxhirit të TVSh-së, duke rritur bazën tatimore dhe duke ulur kostot e pajtueshmërisë dhe kostot e administrimit.

Si më sipër, FMN-ja do të ndihmojë MF-në për kryerjen e kësaj analize.

Masa 1.1.3 Hartimi i akteve konkrete ligjore për TVSh-në bazuar në rezultatet dhe vendimet e marra pas analizave

Bazuar në raportin e analizës së përjashtimeve/normave të reduktuara të TVSh-së dhe pragut të TVSh-së, i cili do të analizoj furnizimet e mallrave/shërbimeve të parashikuara në ligjin nr. 92/2014, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, për t’u trajtuar si të përjashtuar nga TVSh-ja ose me normë të reduktuar të TVSh-së, do të nisë procesi i përgatitjes së projektakteve ligjore/nënligjore. Ky draft do të pasqyrojë vendimin e marrë bazuar në rezultatet e këtyre analizave.

Masa 1.1.4 Analiza e niveleve të akcizës me synim harmonizimin me BE-në

Shqipëria aplikon një grup gjithëpërfshirës të akcizave, të cilat janë të harmonizuara pjesërisht me direktivën e BE-së. Ligji nr. 61, datë 24.5.2012, “Për qkizatat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, është i përafëruar pjesërisht me Direktivën e Këshillit 2008/118/KE, datë 16 dhjetor 2008, “Lidhur me masat e përgjithshme mbi taksën e akcizës”, e cila është zëvendësuar nga Direktiva e Këshillit (BE) 2020/262, e datës 19 dhjetor 2019, “Mbi përcaktimin e masave të përgjithshme për akcizën”. Akciza është taksë specifike, e pagueshme për disa kategori mallrash që importohen apo prodhohen brenda vendit dhe përfshin alkoolin dhe pijet alkoolike, duhanin dhe nënproduktet e tij, produktet energjetike, kafënë, fishekzjarrët, gomat, etj. Akciza zë rreth 11% të të ardhurave tatimore. Rreth 55% e të ardhurave nga akciza vijnë nga nënproduktet e naftës, 35% nga nënproduktet e duhanit dhe pjesa e mbetur prej 10% nga kategoritë e tjera të mallrave të akcizës. Për vitin 2023, të ardhurat nga produktet alkoolike janë 6.8% e totalit të të ardhurave nga akciza. Akciza indeksohet çdo dy vjet me normën zyrtare të inflacionit të shpallur nga INSTAT-i (jo më shumë se 1.5%), me përjashtim të duhanit dhe nënprodukteve për të cilat ka një kalendar rritje të paracaktuar deri në vitin 2026.

Problematika me akcizat

Shqipëria aplikon akcizat me tarifë specifike për njësi. Niveli i akcizave të mallrave kryesore që ngarkohen me akcizë si karburantet dhe duhanet, është përgjithësisht më i ulët se nivelet e akcizave që zbatohen nga vendet e BE-së apo ato të parashikuara në Direktivën e Këshillit 2008/118/KE, datë 16 dhjetor 2008, shfuqizuar nga Direktiva e Këshillit (BE) 2020/262, e datës 19 dhjetor 2019, që përcakton rregullimet e përgjithshme për akcizën. Problematikat kryesore në lidhje me akcizat janë:

- Në vendin tonë, për disa mallra të akcizueshme sikurse janë duhanet, nuk aplikohet skema e kombinuar e taksimit që përfshin edhe një tarifë specifike akcize për njësi produkti, por edhe një tarifë me përqindje akcize mbi çmimin e shitjes së produktit. Kjo skemë e kombinuar aplikohet në disa vende. Në vitet në vijim, pas përfundimit të kalendarit të rritjes së akcizës 2022–2026, do të dizajnohet kalendar i ri, i cili do marrë në konsideratë skemën e taksimit që kombinon sistemin me kuotë fikse me atë *ad valorem*.

- Niveli i parashikuar i akcizave në ligjin shqiptar është përgjithësisht më i ulët se niveli i akcizës që zbatohet nga vendet e BE-së, por edhe nga nivelet minimale të akcizës të përcaktuara në Direktivën e Këshillit 2008/118/KE, datë 16 dhjetor 2008, shfuqizuar nga Direktiva e Këshillit (BE) 2020/262, e datës 19 dhjetor 2019, që përcakton rregullimet e përgjithshme për akcizën. Ndryshimet e synuara për akcizat:

Aktiviteti 1.1.4.1: Kryerja e një analize, në lidhje me nivelet e akcizës dhe nivelet minimale të BE-së

Do të bëhet një analizë, në lidhje me nivelet minimale të akcizës për çdo kategori produkti, me synim përafrimin e mëtejshëm me nivelet minimale të parashikuara në Direktivat e Bashkimit Evropian. Përgjatë viteve, synimi ka qenë përafrimi gradualisht i nivelit të akcizës me minimumet e direktivave të BE-së. Analiza do të fokusohet në:

a) Reduktimin e sasisë të patatueshme me akcizë të pijeve alkoolike të përdorura për konsum personal.

Do të rishikohet sasia e pijeve alkoolike që i nënshtrohen akcizës që trajtohen si vetëkonsumim nga prodhuesit dhe nuk ngarkohen me akcizë, kjo kryesisht për “rakinë” dhe verën e prodhuar në vend;

b) Unifikimi i nivelit të akcizës për kategoritë e mallrave që ende kanë akciza të diferencuara.

Akciza e verës për prodhuesit e vegjël është rreth një e treta e normës së rregullt të akcizës që vlen për prodhuesit e mëdhenj. Niveli i akcizës për prodhuesit e mëdhenj nuk konsiderohet i lartë dhe nuk ka gjasa që unifikimi i akcizës në nivel të lartë të krijojë probleme tek operatorët dhe çmimet e shitjes së produkteve;

c) Eliminimi në disa industri të përjashtimeve dhe rimbursimeve nga akciza dhe zëvendësimi i tyre me subvencione direkte.

Që nga viti 2022, ka filluar zbatimi i rekomandimeve të asistencës së FMN-së, në lidhje me masat në fushën e akcizës, duke eliminuar disa përjashtime/rimbursime për industri të caktuara. Megjithatë, është ende e nevojshme të analizohen përjashtimet dhe rimbursimet aktuale nga akciza.

Masa 1.1.5 Hartimi i akteve konkrete ligjore për akcizën, bazuar në rezultatet dhe vendimet e marra pas analizave

Bazuar në raportin pas analizimit të niveleve të akcizës që parashikohen në ligjin nr. 61/2012, “Për akcizën në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në funksion të përafrimit me nivelet minimale të direktivave të BE-së, do të nisë procesi i përgatitjes së projektakteve ligjore/nënligjore. Ky draft do të pasqyrojë vendimin e marrë bazuar në rezultatet e këtyre analizave.

Masa 1.1.6 Hartimi i kalendarit të ri të nivelit të akcizës së duhanit

Duke filluar nga viti 2022 deri në vitin 2026, ka një plan 5-vjeçar për rritjen e nivelit të akcizës për cigaret dhe duhanin. Me synim përafrimin e mëtejshëm me nivelin e akcizës që aplikohet në BE dhe unifikimin e nivelit të akcizës mes duhanit dhe nënprodukteve të tij, do të përgatitet një kalendar i ri për rritjen e nivelit të akcizës për këto produkte.

Administrata doganore ka punuar me ekspertë të FMN-së për përgatitjen e draftit të kalendarit të ri të rritjes së akcizës për duhanin, për periudhën 2027–2033. Kalendar i ri është në përputhje me Direktivën 2011/64 që kërkon që taksimi i cigareve të kombinojë një komponent specifik dhe *ad valorem*. Taksimi i ri do përmbajë kombinimin e të dy komponentëve specifike/*ad valorem*. Kalendar i ri do finalizohet pas konsultimeve me Drejtorinë e Përgjithshme të Taksave dhe Doganave të KE-së, në mënyrë që të jetë në përputhje të plotë me Direktivën e BE-së.

Masa 1.1.7 Analiza e skemave fiskale incentivuese (direkte dhe indirekte) si pjesë e politikave për nxitjen e përdorimit të energjisë së rinovueshme, eficiencës së energjisë dhe performancës energetike në ndërtesa

Nën këtë masë do të analizohen edhe skemat fiskale incentivuese (direkte dhe indirekte) si pjesë e politikave për nxitjen e përdorimit të energjisë së rinovueshme, eficiencës së energjisë dhe performancës energjetike në ndërtesa, në kushtet e përafrimit të legjislacionit kombëtar për këto fusha me atë të Bashkimit Evropian, në kuadër edhe të arritjes së targeteve për zhvillim të qëndrueshëm dhe ndryshimeve klimaterike.

Për realizimin e kësaj mase do të ndërmerren dy aktivitete, si më poshtë:

1. Aktiviteti 1.1.7.1: ku të përcaktohet kryerja e një analize për incentiva fiskale (direkte dhe indirekte) si pjesë e politikave për nxitjen e përdorimit të energjisë së rinovueshme, eficiencës së energjisë dhe performancës energjetike. Këto analiza do të kryhen nga Ministria e Financave dhe Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, brenda vitit 2026.

2. Aktiviteti 1.1.7.2: ku të përcaktohet përgatitja e projekt ndryshimeve ligjore bazuar në vendimin e marrë pas analizës dhe në përputhje me *acquis* të BE-së, në bashkëpunim të të dyja institucioneve, brenda vitit 2027.

IV.3. Komponenti 1.2 Rishikimi i politikës tatimore lidhur me tatimet dhe taksat direkte Konteksti

Tatimet mbi të ardhurat e entiteteve dhe personave fizikë (tatimi mbi fitimin korporativ dhe tatimi mbi të ardhurat personale) janë burim i rëndësishëm në të hyrat e buxhetit të shtetit. Në 3 vitet e fundit ato përbëjnë 4,5 % të PBB-së dhe kapin rreth 18% në strukturën e të ardhurave tatimore gjithsej.

Politika tatimore në vitet e ardhshme do të synojë analizën e efektivitetit dhe pajtueshmërisë së qëllimeve për të cilat janë dizenuar disa incentiva tatimore për tatimet mbi të ardhurat, duke rishikuar incentivat pa efekte substanciale në rritjen ekonomike të vendit, si dhe mbajtjen në fokus të një sistemi të thjeshtë, gjithpërfshirës dhe me synim zgjerimin e bazës së tatimit në lidhje me tatimin mbi të ardhurat personale.

Prioriteti:

Prioriteti për periudhën 2024–2027 është:

- Zbatimi i kushtit të vendosur në Planin e Rritjes së Agjendës së Reformës së KE-së për kryerjen e një vlerësimi të të gjitha përjashtimeve dhe normave të reduktuara, në lidhje me tatimet direkte, brenda qershorit 2025.

- Analiza e efektivitetit dhe pajtueshmërisë së qëllimeve për të cilat janë dizenuar incentivat tatimore për tatimet mbi të ardhurat.

- Harmonizimi i plotë i legjislacionit vendas me *acquis* të BE-së në fushën e tatimeve direkte.

Masat dhe aktivitetet

Masa	Aktivitetet	Fillimi	Mbarimi	Institucioni përgjegjës
Masa 1.2.1 Analizimi i skemës së tatimit të personave fizikë	Aktiviteti 1.2.1: Kryerja e një analize lidhur me skemën e taksimit të personave fizikë	2024	Dhjetor 2025	MF
Masa 1.2.2 Vlerësimi i të gjitha përjashtimeve/normave tatimore të reduktuara në ligjin për të ardhurat	Aktiviteti 1.2.2: Kryerja e një vlerësimi në lidhje me përjashtimet, normat e reduktuara në ligjin për tatimin mbi të ardhurat	2024	Qershor 2025	MF me asistencën e FMN
Masa 1.2.3 Hartimi i aktit ligjor bazuar në analizën e përjashtimeve dhe normave të reduktuara dhe skemës tatimore të personave fizikë	Aktiviteti 1.2.3.1: Përgatitja e ndryshimeve, nëse e nevojshme, të ligjit për tatimin mbi të ardhurat bazuar në raportin e vlerësimit	Korrik 2025	2027	MF
Masa 1.2.4 Marrëveshje për shmangien e taksimit të dyfishtë	Aktiviteti 1.2.4.1: Negociatat me Lituaninë, Danimarkën, Portugalinë dhe Qipron Aktiviteti 1.2.4.2: Finalizimi i procedurave ligjore të brendshme për miratimin nga parlamenti të marrëveshjeve të nënshkruara për shmangien e taksimit të dyfishtë	2024	2027	MF
Masa 1.2.5 Përmbushja e angazhimeve për tatimet ndërkombëtare, kryesisht ato në kuadër të projektit ndërkombëtar BEPS	Aktiviteti 1.2.5.1: Vazhdimi i zbatimeve bazuar në raportet e rishikuara për BEPS dhe standardet minimale Aktiviteti 1.2.5.2: Analizimi i efektit të zbatimit të Rregullës Globale, shtylla 2 e BEPS	2024-	2025	MF, DPT
Masa 1.2.6 Harmonizim i plotë i legjislacionit vendas me <i>acquis</i> të BE-së në fushën e tatimeve direkte	Aktiviteti 1.2.6.1: Puna përgatitore për transpozim të plotë të <i>acquis</i> të BE-së në tatimet direkte Aktiviteti 1.2.6.2: Hartimi dhe miratimi i aktit ligjor për transpozimin e plotë të legjislacionit të brendshëm me <i>acquis</i> të BE-së sipas kapitullit 16	2024 Korrik, 2025	Qershor 2025 Dhjetor 2026	MF me asistencën e TAIEX
Masa 1.2.7 Rishikimi i përjashtimeve	Aktiviteti 1.2.7.1: Rishikimi i përjashtimeve		Qershor 2025	MF, DPT dhe DPD

nga taksat dhe tarifat kombëtare, duke përfshirë taksat mjedisore	nga taksat dhe tarifat kombëtare Aktiviteti 1.2.7.2: Analiza e taksave mjedisore	2024		
Masa 1.2.8 Hartimi i aktit ligjor bazuar në analizën e taksave kombëtare, duke përfshirë taksat mjedisore	Aktiviteti 1.2.8.1: Përgatitja e ndryshimeve në ligjin për taksat kombëtare bazuar në raportin e vlerësimit	Qershor, 2025	Dhjetor 2025	MF

Treguesit e performancës dhe vlerat e synuara

Treguesi	Vlera bazë (viti)	Vlera e synuar			
		2024	2025	2026	2027
Raport mbi analizimin e skemës së tatimit të personave fizikë			Hartimi i raportit		
Raport mbi analizën dhe rishikimin e tarifave të reduktuara dhe përjashtimeve			Hartimi i raportit		0.036% e PBB-së
Raporti lidhur me taksat ambientale			Hartim i raportit		
Ndryshimet në ligjin për tatimin mbi të ardhurat nëse është e nevojshme, për heqjen dorë nga përjashtimet dhe stimulit tatimorë			Në varësi të raportit	Në varësi të raportit	Në varësi të raportit
Ndryshimet në ligjin për taksat kombëtare për taksat mjedisore			Ligi i miratuar brenda dhjetorit 2025		
Të ardhura shtesë nga rishikimi në rritje i taksave ambientale				0.008% e PBB-së	0.008% e PBB-së

Masa 1.2.1 Analiza e skemës tatimore të personave fizikë

Me vendimin nr. 52, datë 27.6.2024, Gjykata Kushtetuese ka shfuqizuar skemën tatimore, sipas së cilës të vetëpunësuarit dhe subjektet që ofrojnë shërbime profesionale me xhiro deri në 14 milionë lekë, i nënshtroheshin tatimit me norma tatimore progresive 15% dhe 23%. Në bazë të këtij vendimi, kjo kategori tatimpaguesish tashmë ka një normë tatimore 0% mbi fitimin.

Ndërkohë, është në fuqi neni 12 i ligjit për tatimin mbi të ardhurat, ku renditen kategoritë e të ardhurave nga punësimi. Paragrafi 1, i shkronjës “ç”, ka parashikuar që trajtohen si të ardhura nga punësimi:

c) të ardhurat e fituara nga një individ i vetëpunësuar nëse:

i. 80% ose më shumë e të ardhurave të fituara merren drejtpërdrejt ose tërthorazi nga një klient i vetëm; ose

ii. 90 për qind ose më shumë e të ardhurave totale të fituara merret nga më pak se 3 klientë...

Kjo dispozitë ligjore është një rregull kundër shmangies (*anti avoidance*) dhe do të zbusë efektin e normës zero për pragun nën 14 milionë lekë për personat fizikë. Kjo lidhet edhe me tatimet mbi të ardhurat që parashikojnë masa kundër shmangies (*anti avoidance*) për të penguar bizneset që të hartojnë skema tatimore për përdorimin e padrejtë të normës zero tatimore apo normave të reduktuara të saj.

Pas analizimit të efektit të zbatimit, do të bëhet hartimi, nëse është e nevojshme, i ndryshimeve ligjore për parandalimin e krijimit të hapësirave për abuzime me deklaratën:

- Aktiviteti 1.2.1.1: Analizimi i efektit të zbatimit të rregullave kundër shmangies për personat fizikë;
- Aktiviteti 1.2.2.2: Hartimi i akteve ligjore për zbatimin e rregullit antishmangie, në bazë të analizës.

Masa 1.2.2. Analiza e përjashtimeve dhe normave të reduktuara në ligjin për tatimin mbi të ardhurat

Në përputhje me Planin e Rritjes të Agjendës së Reformës, nën këtë mase, do të analizohen efektet e përjashtimeve dhe normave të reduktuara tatimore lidhur me tatimet direkte. Bazuar në ligjin e ri për tatimin mbi të ardhurat, tabela e mëposhtme përmbledh përjashtimet ekzistuese tatimore dhe normat e reduktuara tatimore.

Tabela 9: Përjashtimet tatimore dhe normat e reduktuara në ligjin për tatimin mbi të ardhurat

Parashikimet ligjore kryesore (të përmbledhura)	Trajtimtatimor	Fusha endikimit
Tatimi mbi Ardhurat		
Për personat juridike, të regjistruar përpara 17 maj 2023 (para hyrjes në fuqi të ligjit 29/2023), të cilët ushtrojnë veprimtari ekonomike për prodhimin apo zhvillimin e <i>software</i> -ve, tatimi mbi fitimin me normën 5% do të zbatohet deri më 31 dhjetor 2025.	5%	Prodhimi i <i>software</i> -ve
Për entitetet të cilat zhvillojnë veprimtari ekonomike sipas ligjit nr. 38/2012, “Për shoqëritë e bashkëpunimit bujqësor”, shkalla e tatimit mbi të ardhurat në normën 5% do të zbatohet deri më 31 dhjetor 2029.	5%	Sektori Bujqësor
Për personat të cilët zhvillojnë veprimtari pritëse të certifikuar si “agroturizëm”, sipas legjislacionit në fuqi në fushën e turizmit, shkalla e tatimit mbi të ardhurat 5% do të zbatohet deri më 31 dhjetor 2029.	5%	Sektori turizmit
Për entitetet të cilat ushtrojnë veprimtari ekonomike në industrinë automotive, shkalla e tatimit mbi të ardhurat 5% do të zbatohet deri më 31 dhjetor 2029.	5%	Industria Automotive

Personat juridikë që ushtrojnë vetëm veprimtari të karakterit fetar, humanitar, bamirës, shkencor apo edukativ, pasuria apo fitimi i të cilëve nuk përdoret për përfitimin e organizuesve.	Përfshihen	Organizatat Jofitimprurëse
Shtëpitë filmike të prodhimit kinematografik, të licencuara dhe të subvencionuara.	Përfshihen	Kinematografi
Kontributi i bërë nga çdo anëtar i një fondi pensioni privat zbritet nga të ardhurat personale të tij për efekt tatimi (deri në nivelin e pagës minimale). Kthimi i investimit, përfshirë fitimet nga kapitali prej investimeve të kryera me aktivet e fondit të pensionit nuk i nënshtrohen tatimit gjatë administrimit nga shoqëria administruuese.	Përfshihen	Fondet epensionit
Strukturat akomoduese "Hotel/resort me katër dhe pesë yje, status special", dhe që janë mbajtur të një marke tregtare të regjistruar dhe njohur ndërkombëtarisht "brand name" (kufizohen sipas ligjit deri në 10 vite vetëm për strukturat të cilat kanë fituar statusin special deri në dhjetor 2024).	Përfshihen	Sektori iturizmit
Për individët e vetpunësuar, individët tregtar dhe entitetet me qarkullim deri në 14 milionë lekë, norma e tatimit mbi të ardhurat është 0% dhe do të aplikohet deri më 31 dhjetor 2029.	0%	Subjektet evogla

Aktiviteti 1.2.2: Kryerja e një vlerësimi, në lidhje me normat e reduktuara dhe përjashtimet në ligjin e tatimit mbi të ardhurat

Analiza do të bëhet për çdo përjashtim tatimor dhe normë të reduktuar, si në tabelën e mësipërme, dhe do të marrë parasysh:

- kufizimin i trajtimit të diferencuar brenda regjimit të përgjithshëm të taksave direkte;
- sigurimi i neutralitetit nga pikëpamja e barrës tatimore për të gjitha format e biznesit;
- synimi drejt stimulimit të sektorëve prioritarë bazuar në kosto dhe jo në taksë të reduktuara;
- respektimi i Kodit të Sjelljes së BE-së dhe çdo kërkesë tjetër sipas legjislacionit të BE-së.

Bazuar në analizën e mësipërme, do të synohet të kalohet nga stimujt e bazuar në norma të reduktuara tatimore në stimujt të bazuar në shpenzime, siç mund të konsiderohen stimujt tatimorë në fushën e kërkimit dhe zhvillimit (R&D), nëpërmjet njohjes së tyre të shumëfishtë si biznes shpenzimesh, si një formë stimulimi për kompanitë, me synimin e përfitimeve që i vijnë shoqërisë nga inovacioni.

Ndërkohë që stimujt tatimorë të Kërkim & Zhvillimit mund të jenë efektive në stimulimin e investimeve të biznesit në kërkim dhe zhvillim, dizenji, administrimi dhe mënyra e përfitimit nga stimujt janë thelbësore për efektivitetin e këtyre masave.

Masa 1.2.3 Hartimi i aktit ligjor, nëse e nevojshme, bazuar në analizën e përjashtimeve dhe normave të reduktuara dhe skemës tatimore të personave fizikë

Bazuar në analizën e mësipërme, nëse do të jetë e nevojshme, do të hartohen ndryshimet e nevojshme në ligjin për tatimin mbi të ardhurat, që mund të jenë në fuqi pas vitit 2029.

Bazuar në ligjin e ri ekzistues për tatimin mbi të ardhurat, parashikohet që për personat juridikë të regjistruar para datës 17 maj 2023 (para hyrjes në fuqi të ligjit 29/2023), të cilët ushtrojnë veprimtari ekonomike për prodhimin ose zhvillimin e softuerit, tatimi mbi fitimin, në masën 5% do të zbatohet deri më 31 dhjetor 2025. Pra, nga viti 2026 dhe në vazhdimësi kjo kategori do të jetë subjekt i tatimit mbi fitimin nga 15%. Për këtë arsye, sipas këtij komponenti, për vitet 2026 dhe 2027 parashikohen të ardhura shtesë që do të vijnë nga taksimi me 15% i kësaj kategorie, të vlerësuara në 0.036% të PBB-së, çdo vit.

Masa 1.2.4 Marrëveshjet për shmangien e tatimit të dyfishtë

Në fokus do të jenë negociatat e marrëveshjeve të reja kryesisht me vendet e BE-së, referuar rekomandimeve për Kapitullin 16 "Taksat" në Raportin e Progresit të BE-së. Negocimi dhe ratifikimi i Marrëveshjeve të reja do të bazohet në Marrëveshjen Model të përditësuar të OECD-së dhe OKB-së.

Për këtë arsye, brenda afatit kohor të kësaj strategjie, Shqipëria do të negociojë dhe plotësojë procedurat ligjore për marrëveshjet e shmangies së tatimit (DTA) me 4 vende anëtare të BE-së. Aktivitetet e parashikuara janë si më poshtë:

- Aktiviteti 1.2.4.1: Negociatat me Lituaninë, Danimarkën, Portugalinë dhe Qipron;
- Aktiviteti 1.2.4.2: Finalizimi i procedurave ligjore të brendshme për miratimin nga parlamenti të marrëveshjeve të nënshkruara për shmangien e taksimit të dyfishtë.

Ndërkohë, Shqipëria do të jetë e hapur për të ndryshuar marrëveshjet ekzistuese, kur është e nevojshme, për të përmbushur kërkesat sipas standardit të Marrëveshjes Shumëpalëshe (MLI) për zbatimin e masave në lidhje me Marrëveshjet Tatimore për parandalimin e erozionit të bazës tatimore

dhe transferimi i fitimeve. Për këtë arsye, nuk parashikohet asnjë aktivitet specifik pasi kjo varet nga kërkesat e vendeve të tjera.

Masa 1.2.5 Përmbushja e angazhimeve për tatimet ndërkombëtare, kryesisht ato në kuadër të projektit ndërkombëtar BEPS

Kjo masë konsiston në:

- Plotësimin e standardeve minimale, në lidhje me masat 5, 6, 13 dhe 14. Angazhimi për monitorimin dhe vlerësimin vjetor të këtyre standardeve, por jo vetëm;
- Analizën e rregullave të shtyllës 2 të BEPS-së (*Base Erosion Profit Shifting*);
- Angazhimi në lidhje me masat e marra në kuadër të zbatimit të pjesshëm të shtyllës 2, dhe konkretisht nënshkrimit të STTR–MLI;
- Zbatimi i legjislacionit në përputhje me direktivën e BE-së dhe në përputhje me masën 13 të BEPS për Raportimin nga Shteti sipas Vendit.

Për plotësimin e plotë të kësaj mase janë parashikuar dy aktivitete si më poshtë:

- Aktiviteti 1.2.5.1: Vazhdimi i zbatimeve bazuar në raportet e rishikimit kolegjal për BEPS-në, standardet minimale.
- Aktiviteti 1.2.5.2: Analizimi i efektit të zbatimit të Rregullit Global, shtylla 2 e BEPS-së dhe më pas zbatimi i legjislacionit të tij.

Masa 1.2.6 Harmonizimet e plota të legjislacionit vendas me *acquis* të BE-së në fushën e tatimeve direkte

Shqipëria është pjesërisht e përafruar me *acquis* të BE-së në fushën e tatimeve direkte. Ligji i ri për të ardhurat transpozoi shumicën e direktivave të BE-së që mund të zbatohen gjatë kohës që Shqipëria nuk është anëtare e BE-së.

Gjatë kohëzgjatjes së kësaj strategjie, synohet të transpozohet plotësisht pjesa tjetër e *acquis* të BE-së që nuk është transpozuar. Për këtë, MF-ja ka kërkuar asistencë teknike nga TAIEX.

Aktivitetet e parashikuara janë si më poshtë:

Aktiviteti 1.2.6.1: Punë përgatitore për transpozim të plotë me *acquis* të BE-së në tatimet direkte;

Aktiviteti 1.2.6.2: Hartimi dhe miratimi i aktit ligjor për transpozimin e plotë të legjislacionit të brendshëm me *acquis* të BE-së sipas kapitullit 16.

Masa 1.2.7 Rishikimi i përjashtimeve nga taksat dhe tarifatat kombëtare, përfshirë ato mjedisore.

Ligji nr. 9975, datë 28.7.2008, “Për taksat dhe tarifatat kombëtare”, i ndryshuar, ka përcaktuar llojet e taksave dhe tarifave kombëtare që zbatohen në Republikën e Shqipërisë, ku përfshihen shumë lloje taksash. Janë tre kategori taksash kombëtare: i. taksa e qarkullimit; ii. taksa e karbonit; iii. taksa e ambalazheve plastike, të cilat kanë natyrë ambientaliste dhe pavarësisht se mund të trajtohen si tatime indirekte janë pjesë e ligjit “Për taksat kombëtare”.

Gjithashtu, përmirësimet në sistemin e taksave kombëtare synojnë të sjellin kontribut pozitiv në të ardhurat e buxhetit. Për këtë qëllim masat e mëposhtme konsiderohen si të rëndësishme për t’u ndërmarrë:

- Aktiviteti 1.2.7.1: Analiza e përjashtimeve nga taksat dhe tarifatat kombëtare

Të gjitha përjashtimet nga taksat dhe tarifatat kombëtare do jenë objekt rishikimi periodik, duke vlerësuar efektivitetin dhe efikasitetin e tyre. Ka disa përjashtime të parashikuara në ligj, të cilat pjesërisht janë prezantuar me qëllim favorizimin e disa sektorëve prioritarë dhe pjesërisht me qëllim adresimin e problematikave me të cilat është përballur administrata tatimore. Sektorët prioritarë do të duhet të mbështeten qartësisht përmes transfertave direkte nga buxheti, në mënyrë që të jenë më të lehta për t’u monitoruar, ndërkohë që eliminimi i përjashtimeve nga pagimi i taksave, nuk cenon integritetin e sistemit tatimor.

- Aktiviteti 1.2.7.2: Analiza e taksave mjedisore

Ministria e Financave, në bashkëpunim me Bankën Botërore, ndërmori në vitin 2022 studimin për të analizuar, krahasuar, ndryshuar dhe adresuar taksat mjedisore, bazuar në përvojat më të mira ndërkombëtare, si dhe në strategjitë e miratuara nga qeveria për ruajtjen e mjedisin. Ndryshimet ligjore në ligjin kombëtar të taksave u miratuan me faqen fiskale 2024 dhe kalendar i ri i taksës së karbonit për qymyrin do të zbatohet në vitin 2026. Parimet e mëposhtme do të merren parasysh:

- Analiza e nivelit të taksës së plastikës dhe nxitja nëpërmjet mekanizmave tatimore për riciklimin e tyre. Ndryshimi i taksës së plastikës (kryesisht për ambalazhet plastike) do të vlerësohet, pasi kjo taksë ka hasur në disa probleme në zbatimin e saj.

- Mbështetje për regjimin e taksave mjedisore nëpërmjet udhëzimeve shpjeguese.

- Duke pasur parasysh aspiratën e vendit tonë për t'u bërë një destinacion popullor turistik, do të ishte veçanërisht e rëndësishme që të jepeshin stimujt e duhur për të mbajtur mjedisin të pastër.

- Analiza e shtrirjes së aplikimit të taksës së karbonit kalendar për qymyrin në produkte të tjera që ndotin mjedisin.

Masa 1.2.8 Hartimi i aktit ligjor bazuar në analizën e taksave kombëtare, duke përfshirë taksat mjedisore

Bazuar në analizën e mësipërme, do të hartohen ndryshimet e nevojshme në ligjin për taksat kombëtare. MF-ja synon të përfundojë analizën brenda qershorit 2025 dhe të përgatisë ndryshimet e nevojshme ligjore brenda dhjetorit 2025, me qëllim që të fillojë zbatimin deri në vitin 2026. Në përgjithësi, vlerësohet se të ardhurat shtesë nga rishikimi i taksave mjedisore do të sjellin rreth 0.008% të PBB-së çdo vit, 2026 dhe 2027.

IV.3 Komponenti 1.3 Rishikimi i politikës tatimore të taksës mbi pasuritë e paluajtshme

Në vitin 2018 u miratuan ndryshimet në skemën e taksimit të pasurive të paluajtshme, ndërtesa, duke kaluar nga taksa me kuotë fikse për m², në taksën *ad valorem* pra me përqindje mbi vlerën e pasurisë së paluajtshme-ndërtesë. Kjo reformë u shoqërua me krijimin e Kadastrës Tatimore dhe të Regjistrit të pasurive të paluajtshme ku evidentohen pasuritë e paluajtshme, pronarët, vendndodhja, vlera e pronës dhe të dhëna të tjera. Miratimi i ligjit u shoqërua me vendosjen e disa përjashtimeve nga pagesa e taksës. Nga vlerësimet paraprake vërehet se disa përjashtime duhet të eliminohen, si dhe ka hapësirë që të mund të rritet edhe norma e taksës së pronës. Në këtë të strategjisë, po ndërmerren hapat e mëposhtëm:

- Hartimi i një ligji të ri “Për taksën e pasurisë së paluajtshme”. Ky ligj hartohet me asistencën e Agjencisë Ndërkombëtare Suedeze për Zhvillim (SIDA) dhe do jetë në proces konsultimi publik.

- Rishikimi i përjashtimeve nga taksa mbi pasuritë e paluajtshme. Duke qenë se të ardhurat nga taksa mbi pasuritë e paluajtshme përbëjnë burimin kryesor të të ardhurave të pushtetit vendor, është e nevojshme që përjashtimet të mbahen në nivele minimale dhe ndërkohë, lehtësirat tatimore për grupet vulnerabël duhet të ofrohen nëpërmjet mekanizmave dhe formave të tjera.

- Rishikimi në rritje i tarifës së taksës. Aktualisht, taksa mbi pasuritë e paluajtshme në Shqipëri kontribuon në masën 0.3% të PBB-së, ndërkohë që të ardhurat mesatare që gjenerohen nga taksa e pronës në vendet e tjera të rajonit janë rreth 0.8% e PBB-së.

Ministria e Financave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatimit në Pronë, të mbështetur nga ekspertë të projektit “*Pro Tax Albania*”, kanë përgatitur projektligjin “Për tatimin mbi pasurinë e paluajtshme”. Ky projektligj është publikuar në Regjistrin Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike, ku pas mbylljes së konsultimit publik të projektligjit nuk ka avancim të mëtejshëm. Projektligji ka qëllimet e tij parësore:

- a) ndërtimi i një sistemi modern, funksional, transparent dhe të qëndrueshëm për taksimin e pasurive të paluajtshme;

b) kalimi nga një sistem tatimor i bazuar në vlerë për ndërtesat dhe një sistem i thjeshtë tatimor mbi sipërfaqen për tokën në një sistem modern që takson si ndërtesat ashtu edhe tokën, bazuar në vlerën e tregut të pronës; si dhe

c) rritjen e bazës tatimore duke shtuar kategoritë e pasurive të paluajtshme të tatuara dhe duke rritur numrin e tyre në regjistrin e kadastrës fiskale.

Për zbatimin e taksës së pasurisë, bazuar në vlerën e tregut, kadastra fiskale është pjesa më e rëndësishme e reformës. Sistemi informativ i Kadastrës Fiskale është krijuar me vendimet e Këshillit të Ministrave nr. 273, datë 16.5.2018, “Për krijimin e Regjistrit Qendror të Bazës së të Dhënave për Llogaritjen e Tatimit Vendor të Pasurive të Paluajtshme ‘ndërtesa’ (Kadastra Fiskale)”.

Prioriteti

Prioriteti kryesor për periudhën 2023–2030 është:

- Përgatitja e kadastrës fiskale dhe zbatimi i taksimit bazuar në vlerën e tregut për ndërtesat duke filluar nga viti 2026, si dhe zbatimi i taksimit bazuar në vlerën e tregut për parcelat duke filluar nga viti 2028, duke përfshirë plotësimin e kuadrit ligjor dhe rregullator, finalizimin e Sistemit Informativ të Kadastrës Fiskale me ndërveprueshmërinë dhe integrimin me sistemet e tjera, duke adresuar kërkesat e personelit dhe ngritjen e kapaciteteve të burimeve njerëzore.

Masat dhe aktivitetet

Masa	Aktiviteti	Fillimi	Mbarimi	Njësitë përgjegjëse
Masa 1.3.1 Përmirësimi i kadastrës fiskale dhe sistemit të mbledhjes së taksës së pasurisë	Aktiviteti 1.3.1.1: Hartimi dhe miratimi i kuadrit ligjor (aktet ligjore dhe aktet nënligjore) për kadastrën fiskale, taksën mbi tokën dhe pasurinë e paluajtshme, dhe aktin nënligjor për vlerësimin e tokës dhe pasurisë	T1 2024		MF/ Drejtoria e Përgjithshme e Taksës së Pasurisë DPIT Partnerët Agjencia Suedeze për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ndërkombëtar (SIDA), ProTax Albania Project, ⁴ dhe Agjencia Suedeze e Taksave
	Aktiviteti 1.3.1.2: Hartimi i kuadrit institucional për menaxhimin dhe administrimin e taksës mbi ndërtesën	T4 2024		
	Aktiviteti 1.3.1.3: Finalizimi i Sistemit Informativ të Kadastrës Fiskale (SIKF), ndërveprimet të tij me sistemet e tjera dhe shtrirja në bashki	T1 2025		
	Aktiviteti 1.3.1.4: Pilotimi, ndërtimi i kapaciteteve dhe institucionalizimi i procedurave për vlerësimin e pasurisë së paluajtshme, popullimin dhe mirëmbajtjen e të dhënave të pasurisë së paluajtshme në SIKF	T1 2025	> 2026	
	Aktiviteti 1.3.1.5: Përmirësimi i proceseve për mbledhjen e taksës së pasurisë së paluajtshme dhe rritja e ndërgjegjësimit të taksapaguesve	T1 2025	> 2026	

Treguesit e performancës dhe vlerat e synuara

Treguesi	Vlera bazë (viti)	Vlera e synuar			
		2024	2025	2026	2027
Hartimi dhe miratimi i ligjit për taksën mbi pasurinë e paluajtshme	-	Hartimi i ligjit për taksën mbi pasurinë e paluajtshme	Miratimi i ligjit për taksën mbi pasurinë e paluajtshme		-
Miratimi i akteve nënligjore për zbatimin e ligjit për taksën mbi pasurinë e paluajtshme	-	-	Hartimi dhe miratimi i akteve nënligjore		-
Rritja e të ardhurave nga tatimi mbi ndërtesat nga zbatimi i ligjit	0.3% e PPB-së				0.2% e PPB

V. Shtylla 2: Mirëadministrimi Tatimor

V.1 Hyrje

Objekti i specifik i Shtyllës 2 është rritja e nivelit të pajtueshmërisë vullnetare të tatimpaguesve me legjislacionin tatimor dhe efikasitetit të administratës tatimore.

Në Shtyllën e Mirëadministrimit Tatimor janë identifikuar pesë komponentë të cilësuar fusha me përparësi për përmirësimin e pajtueshmërisë, fusha të cilat përmbajnë veprime prioritare, të cilat potencialisht ndikojnë në rritjen e të ardhurave tatimore në periudhën afatmesme.

Realizimi i rritjes së parashikuar të të ardhurave me 64.85 miliardë lek për një periudhë 4-vjeçare të kërkojë zbatimin e masave të forta e të rëndësishme të administratës tatimore. Plotësimi i të gjithë

⁴ MF-ja, SIDA dhe Agjencia Suedeze e Taksave kanë nënshkruar përkatesisht një marrëveshje kontributi dhe një projekt marrëveshje për vazhdimin e mbështetjes së reformës së taksës së pasurisë.

kushteve të vëna në planin e Rritjes së Agjendës së reformave të KE-së kombinuar me një infrastrukturë të përforcuar e TI- së, përmirësimi i përdorimit të të dhënave dhe përmirësimi i stafit dhe kapacitetit do të ndihmonte në mbylljen e boshllëqeve të përputhjes, duke përfshirë turizmin, ndërtimin dhe individëve të pasur.

Për të arritur nivelin e dëshiruar të pajtueshmërisë së tatimpaguesve me ligjin tatimor, kjo shtyllë shoqërohet edhe me dy komponentë shtesë, të cilët lidhen me reformat institucionale që duhen ndërmarrë me qëllim krijimin e një administrate fiskale eficiente, e cila gëzon besimin e publikut në përgjithësi dhe të tatimpaguesve në veçanti.

Masat e parashikuara janë të balancuara dhe përmbajnë një sërë aktivitete, të cilat synojnë të reduktojnë kostot e pajtueshmërisë, rritjen e sigurisë për taksapaguesit lidhur me si interpretohet legjislacioni tatimor, si dhe rritjen e besimit të tatimpaguesve dhe qytetarëve lidhur me integritetin e administratës tatimore.

Komponenti 2.1: Zvogëlimi i hendekut të pajtueshmërisë në lidhje me TVSh-në

Synohet që brenda vitit 2027 të rritet pajtueshmëria në TVSh, me rritje të deklarimit të qarkullimit, të rritjes me 14% të tatimpaguesve deklarues të TVSh-së dhe rritjes së të ardhurave nga TVSh-ja e brendshme me rreth 0.92% e PBB-së.

Masat për vitet 2024–2027:

- Masa 2.1.1. Trajtimi i sektorit të ndërtimit dhe parandalimi i humbjeve tatimore në zinxhirin e furnizimit të nënkontraktorëve.
- Masa 2.2. Vlerësimi i performancës së sektorit të turizmit dhe hartimi i planit të dedikuar sektorial.
- Masa 2.3. Identifikimi i aktivitetëve digital/elektronike në të gjithë sektorët e ekonomisë.
- Masa 2.4. Trajtimi i sektorëve të tjerë të identifikuar me risk nëpërmjet metodave moderne të menaxhimit të riskut për të rritur pajtueshmërinë vullnetare.
- Masa 2.5: Zgjerimi i bazës së tatueshme me rritjen e numrit të tatimpaguesve të përfshirë në përgjegjësinë e TVSh-së.

Komponenti 2.2. Ulja e pagesave me para në dorë në ekonomi

Synohet që çdo vit, deri në vitin në 2027 të ulet përdorimi i pagesave me para në dorë nëpërmjet masave fiskale me qëllim që një pjesë e mirë e tatimpaguesve të pranojnë pagesa me kartë.

Masat për vitet 2024–2027:

- Masa 2.2.1: Zbatimi i një plani masash nga administrata tatimore për të ulur pagesat me para në dorë në ekonomi.
- Masa 2.2.2 : Diskutimi me sektorin bankar për reduktimin e komisioneve bankare për tatimpaguesit që përdorin POS.

Komponenti 2.3 Verifikimi i të ardhurave dhe kontrolli i pasurive të pajustifikuara.

Synimi deri në vitin 2027 është krijimi i sistemeve, regjistrave dhe kapaciteteve për verifikimin e të ardhurave dhe pasurisë së pashpjeguar, sipas kushteve të vëna në Planin e Rritjes dhe auditimi i 200 individëve.

Masat për vitet 2024–2027:

- Masa 2.3.1: Përdorimi i metodave të tërthorta për vlerësimet tatimore.
- Masa 2.3.2: Identifikimi i mosdeklarimit në lidhje me juridiksionet *offshore* bazuar në të dhënat e mbledhura nga shkëmbimi automatik i informacionit me juridiksionet homologe sipas kuadrit të Standardit të Raportimit të Përbashkët.
- Masa 2.433: Ngritja e Regjistrat të Aseteve të tatimpaguesve me synimin e vlerësimit real të pasurive të tatimpaguesve.
- Masa 2.3.4: Integrimi dhe përdorimi i të dhënave nga palët e treta, në mënyrë që të mundësojë programin e administratës hetime tatimore të pasurisë së pajustifikuar për taksapaguesit.

Komponenti 2.4 Zvogëlimi i shmangies tatimore

Synimi deri në vitin 2027 është krijimi i instrumentave për investigimin e rasteve të shmangieve tatimore dhe plotësimi i kushteve të vëna në Planin e Rritjes dhe kryerja e 500 hetimeve ndaj tatimpaguesve

Masat për vitet 2024–2027 janë:

- Masa 2.4.1: Të sigurohet që rregulli i përgjithshëm antiabuzim të zbatohet në mënyrë efektive dhe të veprojë si frenues për organizimet artificiale tatimore.
- Masa 2.4.2: Hartimi i masave antevazion për të luftuar organizimet artificiale më të përhapura si të vetëpunësuarit “fiktiv” dhe ndarja artificiale e subjekteve.
- Masa 2.4.3 Forcimi i hetimeve kundër mashtrimit fiskal

Komponenti 2.5. Reduktimi i punës së padeklaruar dhe të nëndeklarimit të pagës reale

Synohet që brenda vitit 2027 të jetë përfshirë në listë pagesë 5.5 % të punësuar të rinj krahasuar me vitin bazë 2023, si dhe të rritet deklarimi i pagës reale për 16% të totalit të të punësuarve.

Masat për vitet 2024–2027:

- Masa 2.5.1: Hartimi i një plani të integruar në drejtim të mosdeklarimit të punonjësve.
- Masa 2.5.2: Përmirësimi i bashkëpunimit ndërinstitucional për koordinimin e veprimeve në kuadër të identifikimit të punës së padeklaruar ose nëndeklaruar, mbështetur në një strategji të qartë.
- Masa 2.5.3: Analizimi i kategorive të personave të cilët kanë detyrimin të plotësojnë deklaratën individuale vjetore të të ardhurave.
- Masa 2.5.4: Përmirësimi i analizave dhe shkëmbimit të të dhënave me palë të treta për të evidentuar punonjësit e paregjistruar dhe nëndeklarimin e pagës reale.
- Masa 2.5.5: Fushata të ndërgjegjësimit publik lidhur me përfitimet e pagesës së kontributeve.
- Masa 2.5.6: Zhvillimi i partneriteteve me përfaqësuesit e biznesit dhe të komunitetit për identifikimin e informalitetit në punësim.

Komponenti 2.6 Reduktimi i kostove të pajtueshmërisë, rritja e sigurisë tatimore dhe e besimit tek administrata tatimore

Synimi deri në vitin 2027 është rritja graduale e pajtueshmërisë vullnetare të tatimpaguesve dhe besimit tek administrata tatimore dhe plotësimi i kushteve të vëna në Planin e Rritjes.

Masat për vitet 2024–2027 janë:

- Masa 2.6.1 Hartimi i një strategjie për shërbimin e tatimpaguesve.
- Masa 2.6.2. Ulja e kohës mesatare të rimbursimit të TVSh-së.
- Masa 2.6.3. Digitalizimi i proceseve të punës.
- Masa 2.6.4 Ngritja e një kuadri më të strukturuar për sigurimin e pacenueshmërisë së vlerave (integritetit).
- Masa 2.6.5 Proceste dhe shërbime tatimore të konsultuara me përdoruesit e shërbimeve të DPT.

Komponenti 2.7 Përmirësimi i cilësisë së shërbimit të ofruar nga Administrata Tatimore (AT) nëpërmjet zhvillimit të kapaciteteve institucionale

Synimi deri në vitin 2027 është rritja e efektivitetit të administratës tatimore, si dhe rritja e cilësisë së shërbimeve të ofruara.

Masat për vitet 2024–2027 janë:

- Masa 2.7.1 Fuqizimi i Qendrës së Thirrjeve, si pjesë përbërëse e Strategjisë së Shërbimit për Tatimpaguesit.
- Masa 2.7.2 Ngritja e kapaciteteve analitike në përpunimin dhe analizimin e të dhënave që sigurohen nga Fiskalizimi.
- Masa 2.7.3. Shtrirja e analizave të riskut në çdo funksion të administratës tatimore.
- Masa 2.7.4. Trajnim i stafit të Njësisë së Tatimpaguesve të Mëdhenj me qëllim rritjen e kapaciteteve për analizën dhe kontrollin e sektorëve specifikë të ekonomisë.
- Masa 2.7.5. Bashkëpunimi me universitetet me qëllim rritjen e kapaciteteve në kuptueshmërinë e sjelljes së tatimpaguesve dhe aftësi të stafit të administratës tatimore me risitë e reja në fushën ekonomike.

Nëpërmjet masave që do ndërmerren për zbatimin e komponentëve të mësipërm pritet që të ardhurat tatimore të rriten me rreth 1.97% e PBB-së ose 51 miliardë lekë brenda periudhës katërvjeçare 2024–2027, dhe e ndarë sipas zërave të tatimeve, sikurse tregohet në tabelën më poshtë

Tabela 10: Të ardhura në buxhetin e shtetit nga Shtylla 2 “Mirëadministrimi Tatimor”, sipas zërave të taksave

Të ardhurat nga Shtylla 2 “Mirëadministrimi Tatimor” nga taksat si më poshtë	2024	2025	2026	2027	Totali 2024–2027
TVSH	0.42%	0.21%	0.15%	0.14%	0.92%
Tatim fitimi	0.22%	0.24%	0.12%	0.12%	0.71%
Tatimi mbi qiranë	0.02%	0.04%	0.05%	0.05%	0.16%
Tatimi mbi pagën	0.003%	0.01%	0.01%	0.02%	0.05%
Kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore	0.02%	0.04%	0.04%	0.05%	0.14%
Totali	0.68%	0.54%	0.37%	0.38%	1.97%
<i>në milionë lekë</i>					
TVSH	10,153	5,478	4,002	3,833	23,466
Tatim fitimi	5,466	6,030	3,316	3,482	18,294
Tatimi mbi qiranë	487	1,067	1,280	1,536	4,369
Tatimi mbi pagën	82	273	382	491	1,229
Kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore	390	907	1,088	1,322	3,708
Totali	16,577	13,755	10,069	10,665	51,067

V.2. Komponenti 2.1 Zvogëlimi i hendekut të pajtueshmërisë në lidhje me TVSh-në Objektivi

Synohet që në periudhën 4-vjeçare, hendeku i TVSh-së të zvogëlohet me 0.92% e PBB-së, e vlerësuar në rreth 23.5 miliardë Lek. Ky objektivi synohet të arrihet nëpërmjet impaktit pozitiv në sistemin fiskal të projektit të fiskalizimit, i kombinuar ky me masa të tjera që do të ndërmerren në sektorët më me risk për TVSh-në, zgjerimin e bazës së tatueshme të tatimpaguesve të përfshirë në këtë përgjegjësi si dhe vëmendjen maksimale për identifikimin dhe goditjen e skemave të mashtrimit me TVSh-në. Sektorët me fokus prioritar do të jenë: ndërtimi, turizmi dhe tregtia elektronike.

Konteksti

Të ardhurat në total nga TVSh, në import dhe TVSh e brendshme, përbëjnë 30% të totalit të të ardhurave të buxhetit të shtetit ose 8.32% e PBB-së në vitin 2023. Të ndara sipas administratave fiskale, TVSh e brendshme neto është në masën 1.99% e PBB-së ndërsa në import është 6.33% e PBB-së.

Vitet e fundit është shënuar rritje pozitive në TVSh-në e brendshme, rezultat ky i përmirësimit në deklaram pas implementimit të sistemit të ri të fiskalizimit dhe kryesisht faturës elektronike. Kështu, nga 1.63% e PBB-së në vitin 2021, TVSh e brendshme arriti në 1.99% e PBB-së në vitin 2023, me një rritje prej 0.36% e PBB-së ose 15,7 miliardë lek më shumë, brenda tre viteve.

Në Shqipëri, 27% e bizneseve aktive subjekt i tatimit të thjeshtuar mbi fitimin ose tatimit mbi fitimin janë pagues të TVSh. Në vitin 2023 janë 33,283 tatimpagues deklarues TVSh, ku pjesa më e madhe e tyre operojnë në sektorin e tregtisë me shumicë, tregtisë me pakicë, në sektorin e ndërtimi, akomodimit, bar-kafe dhe transportit. Ndërsa sipas kontributit në pagesat e TVSh, grafiku më poshtë jep të ardhurat nga TVSh totale paguar sipas sektorëve kryesorë të ekonomisë, ku rezulton se tregtia

me shumicë, ndërtimi, telekomunikacioni dhe bar kafet janë sektorët që kontribuojnë me më shumë të ardhura në TVSh.


Tabela 11 : Realizimi i TVSh sipas Administratave fiskale, në vlerë dhe % ndaj PBB-së.

në milionë lekë

Viti	Administratat fiskale		Totali	Në % ndaj totalit		PPB	Administratat fiskale		Totali
	Tatime	Dogana		Tatime	Dogana		Tatime	Dogana	
2021	30,235	131,301	161,536	19%	81%	1,856,172	1.63%	7.07%	8.70%
2022	34,514	156,898	191,412	18%	82%	2,138,339	1.61%	7.34%	8.95%
2023	45,936	146,386	192,322	24%	76%	2,311,672	1.99%	6.33%	8.32%

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve

Grafik 6: Sektorët kontribues në TVSh-në e brendshme



Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve

Në Tatimin mbi Vlerën e Shtuar aplikohen jo pak përjashtime, si dhe dy norma të reduktuara, 6 % dhe 10 %, sikurse është shpjeguar në seksionet më sipër të kësaj Strategjie. Shqipëria aplikon normë relativisht të lartë të pragut për regjistrim TVSh, duke synuar lehtësimin e barrës administrative dhe asaj fiskale të tatimpaguesve të vegjël. Aplikimi i një pragu të lartë të TVSh-së nxit nëndeklarimin e qarkullimit nga tatimpaguesit, me qëllim qëndrimin nën këtë prag. Nga tërësia e kontrolleve të administratës tatimore, kontrollet për TVSh përbëjnë edhe numrin më të lartë të kontrolleve.

Për vet specifikën e saj, TVSh-ja është tatim mbi të cilin eksperiencia të ndryshme tregojnë përdorimin nga tatimpaguesit të skemave të ndryshme të mashtrimit me TVSh-në. Skemat Carusel janë të njohura në nivel global. Edhe në vendin tonë janë evidentuar jo pak raste të “tregtimit” të TVSh-së me qëllim shmangien e pagesës së saj. Tipologjia e mashtrimit tatimor dallon mes evazionit dhe mashtrimit të organizuar – por të dyja synojnë të përfitojnë një avantazh tatimor të paligjshëm. Evazoni shpesh buron nga informaliteti dhe është lëshimi, fshehja ose keqinterpretimi i qëllimshëm i informacionit për të minimizuar detyrimin e tatimpaguesit për TVSh-në. Në të kundërt, mashtrimi i organizuar përfshin veprime të kordinuara dhe sistematike, shpesh mjaft të sofistikuar, drejt realizimit të një përfitimi shtesë të paligjshëm të TVSh-së.

Për sa më sipër, pjesë e kësaj Strategjie do të jetë zhvillimi i planeve operacionale dhe aktiviteteve kundër mashtrimit me TVSh-në, e shtrirë kjo në të gjithë gamën e evazionit. Praktikat do të vlerësohen, me synimin për të hartuar kundërmasa efektive.

Prioritetet:

Prioritetet për periudhën 2024–2027 janë:

1. Rritja me 0.92% e PBB-së të të ardhurave nga TVSh, për periudhën 2024–2027.
2. Përdorimi i teknologjisë së informacionit, përpunimi i të dhënave dhe menaxhimi i riskut.
3. Rritja e përputhshmërisë së tatimpaguesve dhe zgjerimi i bazës së tatueshme.
4. Rritja e kapaciteteve inteligjente për gjurmimin e evazionit dhe shmangies tatimore.
5. Rritje e TVSh-së së paguar në sektorin e turizmit në përputhje me rritjen e fluksit turistik.
6. Plotësimi i kushtit të vënë në Planin e Rritjes së KE-së për parambushjen 100% të deklaratës së TVSh-së, brenda vitit 2026.

7. Rritja e tatimpaguesve deklarues në TVSh me 14% në 2027 krahasuar me 2023, për të gjithë sektorët e ekonomisë.

Masat dhe aktivitetet

Masa	Aktivitetet	Fillimi	Mbarimi	Institucioni përgjegjës
Masa 2.1.1 Trajtimi i sektorit të ndërtimit dhe parandalimi i humbjeve tatimore në zinxhirin e furnizimit të nënkontraktorëve	Aktiviteti 2.1.1.1: Kryerja e një analize të detajuar në sektorin e ndërtimit, përfshirë zinxhirin e transaksioneve me nënkontraktorët. Aktiviteti 2.1.2: Hartimi dhe zbatimi i Planit sektorial të sektorit të ndërtimit	2025	2027	DPT/Shoqata e Ndërtuesve/Agjencia e planifikimit të territorit
Masa 2.1.2 Vlerësimi i performancës së sektorit të turizmit dhe hartimi i planit të dedikuar sektorial	Aktiviteti 2.1.2.1: Analizë e risqeve të mospajtueshmërisë në sektorin e turizmit Aktiviteti 2.1.2.2: Hartimi dhe zbatimi i planeve vjetore sektoriale të Turizmit.	2024	2027	DPT në bashkëpunim me Ministrinë e Turizmit, Shoqata e turizmit
Masa 2.1.3. Identifikimi i aktivitetëve digitalë/elektronike në të gjithë sektorët e ekonomisë	Aktiviteti 2.1.3.1: Analizë e risqeve të mospajtueshmërisë në sektorin e shërbimeve/tregtisë digitale. Aktiviteti 2.1.3.2: Hartimi dhe zbatimi i planit Sektorial të Tregtisë elektronike	2026	2027	DPT/AKEP/MF
Masa 2.1.4. Trajtimi i sektorëve të tjerë të identifikuar me risk nëpërmjet metodave moderne të menaxhimit të riskut për të rritur pajtueshmërinë vullnetare	Aktiviteti 2.1.4.1: Analizë e risqeve të mospajtueshmërisë në sektorët e tjerë. Aktiviteti 2.1.4.2: Hartimi i Planeve sektoriale të pajtueshmërisë në sektorët e evidentuar me risk.	2024	2027	DPT/Shoqatat e Biznesit
Masa 2.1.5: Zgjerimi i bazës së tatueshme me rritjen e numrit të tatimpaguesve të përfshirë në përgjegjësinë e TVSh-së	Aktiviteti 2.1.5.1: Krijimi i kriterëve të reja të riskut me qëllim evidentimin e tatimpaguesve me riskun e shmangies së TVSh-së.	2024	2027	DPT
	Aktiviteti 2.1.5.2: Finalizim i parambushjes së deklaratës së TVSh	2025	2026	DPT

Treguesit e performancës dhe vlerat e synuara

Treguesi	Vlera bazë (viti 2023)	Vlera e synuar			
		2024	2025	2026	2027
Rritje e të ardhurave nga TVSh me 0.92% e PBB-së, brenda 2027	Të ardhura nga TVSh e brendshme, 1,98% e PBB-së	0.42% e PBB-së	0.21% e PBB-së	0.15% e PBB-së	0.14% e PBB-së
Rritja e numrit të tatimpaguesve deklarues TVSh-je në sektorin e ndërtimit	13.3% e tatimpaguesve deklarues TVSh	10% rritje nr. i tatimpaguesve	5% rritje nr. i tatimpaguesve	5% rritje nr. i tatimpaguesve	5% rritje nr. i tatimpaguesve
Rritja e TVSh së paguar në sektorin e ndërtimit		19% rritje e të ardhurave	20% rritje e të ardhurave	12% rritje e të ardhurave	8% rritje e të ardhurave
Rritje në numrin e tatimpaguesve deklarues TVSh në sektorin e akomodimit me normë tatimore 6%	1,9% e tatimpaguesve deklarues TVSh	20% rritje nr. i tatimpaguesve	20% rritje nr. i tatimpaguesve	20% rritje nr. i tatimpaguesve	20% rritje nr. i tatimpaguesve
Rritje e TVSh-së e paguar në sektorin e turizmit *	5.8% e totalit të TVSh-së së brendshme	20% rritje e të ardhurave nga sektori i turizmit	20% rritje e të ardhurave nga sektori i turizmit	20% rritje e të ardhurave nga sektori i turizmit	20% rritje e të ardhurave nga sektori i turizmit
Rritje në numrin e tatimpaguesve deklarues TVSh në sektorin e turizmit (Akomodim, Bar-restorante) që kanë normë standarde TVSh-je	8% e tatimpaguesve deklarues TVSh	10% rritje nr. i tatimpaguesve	20% rritje nr. i tatimpaguesve	20% rritje nr. i tatimpaguesve	20% rritje nr. i tatimpaguesve
Rritje e numrit tatimpaguesve me përgjegjësi tatimore me TVSh për të gjithë sektorët, 14% më shumë, në fund të 2027	26% tatimpagues deklarues TVSh	4% rritje nr. i tatimpaguesve	4% rritje nr. i tatimpaguesve	3% rritje nr. i tatimpaguesve	3% rritje nr. i tatimpaguesve
Parambushja e deklaratës së TVSh				100%	

**Shënim. Sektori i turizmit përfshin: Hotele dhe struktura të ngjashme, Akomodime për pushime dhe të tjera akomodime kolektive, Hapësirat për kampinge dhe për parqe, për çadra ose rulota argëtimi, Akomodime të tjera, Restorante dhe shërbim ushqimor i lëvizshëm, Aktivitete të shërbimit të pijeve, Dhënia me qira dhe hua e mjeteve të transportit dhe Dhënia me qira dhe hua e pajisjeve të transportit të ujit.*

Masa 2.1.1 Trajtimi i sektorit të ndërtimit dhe parandalimi i humbjeve tatimore në zinxhirin e furnizimit të nënkontraktorëve.

Sektori i ndërtimit përfshin tatimpaguesit që operojnë në tre nënsektore dhe konkretisht:

1. Ndërtimi i ndërtesave;
2. Inxhinieria civile; dhe
3. Veprimtari të specializuara të ndërtimit.

Sektori i ndërtimit përbën një ndër sektorët kryesorë në kontributin e të ardhurave nga administrata tatimore, me 11.2% të totalit të të ardhurave. Të ardhurat e arkëtuara nga sektori i ndërtimit përbëjnë 0.39% të PBB-së.


Çdo masë e marrë në mirëadministrimin e TVSh së këtij sektori sjell të ardhura shtesë edhe në llojet e tatimeve të tjera si tatimi mbi fitimin korporativ, tatimi mbi të ardhurat e personave fizikë, etj. Pesha e TVSh-së së paguar në sektorin e “Ndërtimit” në raport me deklarimin dhe pagesën e TVSh-së së të gjithë sektorëve ekonomikë në vitet 2021-2023, rezulton të jetë 14% - 15 % e totalit të TVSh-së së brendshme.

Në saj të masave të marra ndër vite, për subjektet deklarues me deklarata TVSh-je që përfshihen në sektorin “Ndërtimi”, rezulton rritje në numrin e tatimpaguesve deklarues të TVSh-së ndër vite, rritje kjo me +10% në vitin 2022 në krahasim me vitin 2021, dhe po me 10% në 2023 krahasuar me vitin 2022. Në fund të vitit 2023 rezultojnë 4.431 tatimpagues deklarues TVSh-je në këtë sektor, nga 7649 tatimpagues po në këtë sektor, të cilët janë deklarues në tatimin mbi fitimin ose tatimin e thjeshtuar mbi fitimin.

Pra 58 % e tatimpaguesve të këtij grupi, janë subjekt i TVSh-së. Lidhur me TVSh-në e paguar ndër vite, rezulton rritje me 25% në 2023 krahasuar me vitin 2022 ose rreth 2.07 miliardë lek më shumë.

Pavarësisht nga kjo rritje, vlerësohet se sektori i ndërtimeve dallon si një sektor veçanërisht problematik lidhur me TVSh-në e nëndeklaruar. Pjesa më e madhe e pagesave të TVSh-së bëhen nga tatimpaguesit me xhiro mbi 50 milionë lekë, të cilët përbëjnë edhe 85% të totalit.

Grafikë 7: Pagesat e TVSh-së sipas qarkullimit të bizneseve në sektorin e ndërtimit



Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve

Në formulimin e strategjisë afatmesme dhe planeve të veprimit, Administrata Tatimore do t'i japë përparësi zhvillimit të një programi të përmirësimit të pajtueshmërisë, posaçërisht për sektorin e ndërtimit dhe krejt zinxhirit furnizues të tij, për të zvogëluar humbjet tatimore në këtë sektor.

Ndër të tjera, synimi i kësaj mase është eliminimi i skemave të mashtrimit të TVSh-së në ndërtim, duke synuar rritje të TVSh-së së pagueshme. Edhe përvoja ndërkombëtare tregon se ndërtimi është një sektor shumë i ndjeshëm ndaj mashtrimit të TVSh-së përgjatë zinxhirit të furnizimit të nënkontraktuesve.

Aktiviteti 2.1.1.1: Kryerja e një analize të detajuar të fenomeneve të sektorit të ndërtimit, analizë e zinxhirit të TVSh-së së nënkontraktorëve

Në trajtimin e performancës së sektorit të ndërtimit, është shumë e rëndësishme trajtimi dhe monitorimi i të gjithë zinxhirit furnizues së këtij sektori për të evidentuar të gjitha hallkat ku konstatohet rrjedhje e TVSh-së. Analiza do të përfshijë të gjithë tatimpaguesit që operojnë në sektorin

e ndërtimit dhe nënkontraktorët e tyre duke filluar nga importi/prodhimi i lëndëve të para për sektorin e ndërtimit deri në analizën e kostove, sasisë dhe çmimeve të kantieret e ndërtimit.

Në kuadër të analizës së të dhënave dhe risqeve të sektorit të ndërtimit, administrata tatimore do të bashkëpunojë dhe bashkërendojë me institucione të tjera të tilla: si Agjencinë e Zhvillimit të Territorit, Agjencinë Kombëtare të Planifikimit të Territorit, AKBN në rastet e ndërtimit të HEC-eve apo me të dhënat e regjistrit të Lejeve të Ndërtimit nga Bashkitë.

Aktiviteti 2.1.1.2: Hartimi dhe zbatimi i planit sektorial të ndërtimit

Bazuar në analizat e mësipërme, administrata tatimore do të hartojë një Plan sektorial të dedikuar vetëm për sektorin e ndërtimit dhe zinxhirin furnizues të tij. Fokusi kryesor i tij do të jetë TVSh-ja por pa anashkalluar tatim mbi fitimin dhe problematikat që kanë të bëjnë me deklarimin e punonjësve.

Masa 2.1.2 Vlerësimi i performancës së sektorit të turizmit dhe hartimi i planit të dedikuar sektorial

Sektori i turizmit përbën një ndër sektorët me rritje të ndjeshme vitet e fundit si dhe një sektor për të cilin janë dhënë dhe zbatohen incentiva tatimore, si përjashtime ose norma të reduktuara taksash. Me këtë sektor, përveç hotelërisë, janë të lidhur shumë tatimpagues që operojnë në sektorë të ndryshëm si sektori i transportit, agjencitë turistike, sektori i tregtisë, me shumicë e pakicë, etj.

Në bazë të të dhënave rezulton se për subjektet deklarues deklarata TVSh që janë në sektorët “Akomodim” dhe “Aktivitetet e shërbimit të ushqimit dhe pijeve”, të cilët kanë më shumë se 100.000 lekë shitje të tatueshme me 6 %, rezulton të ketë rritje në numrin e tatimpaguesve deklarues TVSh-je në këto fasha ndër vite, rritje me 8% në vitin 2022 në krahasim me vitin 2021, dhe me 17% në 2023 krahasuar me vitin 2022. Gjithashtu, rezulton me rritje edhe TVSh-ja e paguar ndër vite, 40% rritje në 2022 krahasuar me 2021, dhe 40% rritje në 2023 krahasuar me vitin 2022. Në bazë të analizave, ka potencial për të rritur përputhshmërinë në këtë sektor.

Tabela 12: Të ardhurat nga TVSh në % të PBB-së dhe numri i subjekteve në sektorin “Akomodim” dhe “Aktivitetet e shërbimit të ushqimit dhe pijeve”, me më shumë se 100.000 lekë shitje të tatueshme me 6 %

Sektori	TVSH paguar			Numri i tatimpaguesve		
	2021	2022	2023	2021	2022	2023
Akomodimi	0.010%	0.013%	0.014%	497	537	632
Aktivitetet e shërbimit të ushqimit dhe pijeve	0.005%	0.006%	0.010%	132	145	168
Total Turizëm	0.015%	0.018%	0.024%	629	682	800

Aktiviteti 2.1.2.1: Analizë e performancës së Sektorit të Turizmit dhe vlerësimi i risqeve

Kjo analizë do të synojë në identifikimin dhe vlerësimin e risqeve, priorizimi i tyre, përcaktimi i shkaqeve të mospajtushmërisë në sektorin e turizmit. Në analizë, përpos tatimpaguesve që operojnë në “Akomodim/Shërbimi ushqimor” do të përfshihen edhe tatimpaguesit që operojnë në sektorin, shërbime plazhi, transporti qytetas e ndër qytetas, dhënia me qira e makinave/mjeteve ujore, shërbime turistike, etj.

Gjithashtu, në fokus do të jetë monitorimi i zbatimit të ligjit të ri “Për Turizmin” kryesisht për çështje që kanë të bëjnë me regjistrimin pranë institucionit përgjegjës për sektorin e turizmit dhe ato që kanë të bëjnë me mënyrën e deklarimit të të ardhurave të këtij sektori.

Bashkërendimi i nismave me institucione të tjera të angazhuara në mbarëvajtjen e sektorit turistik, si Agjencia Kombëtare e Bregdetit (AKB), Bashkitë në zonat turistike, etj., do të jetë një tjetër fokus i administratës tatimore.

Aktiviteti 2.1.2.2: Finalizimi dhe zbatimi i Planit Sektorial të Turizmit

Bazuar në analizat e mësipërme, administrata tatimore do të hartojë plane sektoriale vjetore të dedikuar vetëm për sektorin e turizmit (struktura akomoduese, bar-restorante, agroturizëm, shërbime plazhi, transporti qytetas e ndër qytetas, dhënia me qira e makinave/ambienteve etj.). Fokusi kryesor i

tij do të jetë TVSh-ja, ndjekur nga tatimin mbi fitimin dhe tatimin mbi të ardhurat biznesore, si dhe problematikat që kanë të bëjnë me deklarimin e punonjësve.

Burimet e të dhënave që gjenerohen tashmë në kohë reale nga sistemi i fiskalizimit, do përdoren për të evidentuar tatimpaguesit mospërbushës si dhe përdorimi i çdo të dhëne nga palë të treta ose burime të jashtme publike (*web*, media vizive e sociale etj.) të cilat ndihmojnë administratën tatimore në realizimin e misionit të saj.

Masa 2.1.3 Identifikimi i aktiviteteve digjitale/elektronike në të gjithë sektorët e ekonomisë

Tregjet *online* në Shqipëri karakterizohen nga shitjet e brendshme nëpërmjet rrjeteve sociale dhe dyqaneve lokale, përmes pagesave *cash* dhe blerjeve elektronike në platformat ndërkombëtare të tregtisë elektronike përmes pagesave me karta elektronike. Sipas një studimi të Bankës Botërore⁵, nga të anketuarit shqiptarë që bëjnë blerje *online*, 67% theksojnë se përdorin rrjetet sociale për të blerë nga dyqanet vendase, ndërsa 61% deklarojnë se blejnë nga tregjet ndërkombëtare.

Shërbimet, që kërkojnë më tepër nga kompanitë e shitjeve *online* në Shqipëri, të përqendruara më së shumti në Tiranë janë: tërheqja me korrier, dorëzimi në adresë dhe pagesa në momentin e dorëzimit. Sipas vëzhgimeve të kryera për këtë lloj tregtie në Shqipëri, problematikat kryesore të hasura janë si me poshtë:

Informaliteti, i cili pengon pasqyrimin e realitetit të shitjeve *online* në vend.

- Sektori i shërbimeve postare. E njëjta situatë shfaqet edhe në këto sektorë ku pjesa më e madhe e bizneseve për dërgesat punësojnë individë të palicencuar për këto shërbime.

- Operatorët e shitjeve *online*, të cilët shprehen se për shkak të mundësive që krijon operimi *online*, shumë individë u shmangen detyrimeve fiskale ku një ndër to është dhe moslëshimi i faturës.

- Thuajse mbi 90% e shitjeve *online* bëhen me para në dorë (*cash-on-delivery*). Arsyeja kryesore, është mosbesimi i konsumatorëve ndaj cilësisë së mallit që do marrin në dorëzim.

- Problematika lidhur me kthimin e mallrave/porosive.

Aktiviteti 2.1.3.1: Analizë e arsyeve dhe risqeve të mospajtueshmërisë në sektorin e shërbimeve/tregtisë digjitale

Administrata Tatimore do të kryejë një analizë të detajuar të identifikimit dhe vlerësimit të risqeve, priorizimi i tyre, përcaktimi i shkaqeve të mospajtueshmërisë në sektorin shërbimeve/tregtisë digjitale.

Fokus të veçantë do të kenë tatimpaguesit që operojnë në sektorin e “Aktiviteteve postare dhe ndërlidhëse” në bashkëpunim me AKEP. Numri i tatimpaguesve që ushtrojnë aktivitet në këtë sektor është rritur ndjeshëm me rritjen e tregtisë elektronike në vend. Aktualisht, janë 82 operatorë që operojnë në këtë treg.

Aktiviteti 2.1.3.2: Hartimi dhe zbatimi i Planit Sektorial të tregtisë elektronike

Bazuar në analizat e mësipërme, administrata tatimore do të hartojë plane sektorial të dedikuara vetëm për sektorin e tregtisë elektronike. Vëmendja kryesore e këtij plani do të jetë, qarkullimi real i deklaruar nga tatimpaguesit që kryejnë këtë aktivitet me fokus te TVSh-ja, por pa anashkaluar tatimin mbi fitimin dhe tatimin mbi të ardhurat e personave fizike, si dhe problematikat që kanë të bëjnë me deklarimin e punonjësve. Marrëdhënia ndërmjet shoqërive të transportit (ndërmjetësve) dhe klientëve e furnitorëve të produkteve do trajtohet gjithashtu. Analiza do përfshijë të gjithë tatimpaguesit që operojnë në këtë sektor. Përveç kompanive vendore që ofrojnë tregti/shërbime elektronike, në fokus do të jenë edhe kompanitë ndërkombëtare.

Masa 2.1.4 Trajtimi i sektorëve të tjerë të identifikuar me risk nëpërmjet metodave moderne të menaxhimit të riskut për të rritur pajtueshmërinë vullnetare

Synimi i kësaj mase është rritja e përputhshmërisë së sektorëve me risk. Zhvillimi i planeve me fokus përmirësimin e pajtueshmërisë do të ketë nevojë për ndihmë të mtejshme për zhvillimin e

⁵ Studimi i Bankës Botërore : “Albania E-Commerce Diagnostic: Leveraging the Digital Trade Opportunity”.

kapaciteteve, si për teknikat e analizës së të dhënave (për të identifikuar më mirë grupimet e riskut brenda vlerësimit të hendekut të TVSh-së), ashtu edhe për hartimin e planit sektorial.

Për të pasur ndikim të qëndrueshëm, administrata tatimore do të hartojë një plan të përmirësimit të përputhshmërisë sektoriale në mënyrë gjithëpërfshirëse. Për periudhën katërvjeçare, fokusi i punës së administratës tatimore përpos sektorit të ndërtimit /turizmit /tregtisë elektronike do të jenë edhe sektorët e tjerë të evidentuar si sektorë me risk të tillë si: sektori i tregtisë, shërbimeve të ndryshme, prodhimit etj. Për secilin nga këta sektorë, administrata tatimore do të hartojë Planet Operacionale Sektoriale specifike vjetore.

Aktiviteti 2.1.4.1: Përcaktimi i metodologjisë së teknikave të analizës së të dhënave

Monitorim më i mirë i deklarimeve tatimore, duke ndërthurur dhe kryqëzuar informacion mes strukturave të ndryshme të administratës tatimore dhe institucioneve të tjera. Përmirësimi i cilësisë së kontroleve tatimore nëpërmjet standardizimit të procedurave të kontrollit si dhe automatizimit dhe zbatimit në sistemin C@TS të raport-kontrollit.

Përmirësimi i kapaciteteve dhe i procedurave të kontrollit nga zyra, metodologjisë dhe analizimit të risqeve. Fokusimi i administratës tatimore në këtë lloj kontrolli, i cili ul kostot administrative është më efektiv, më i shpejtë dhe më transparent.

Aktiviteti 2.1.4.2: Hartimi i Planeve sektoriale të pajtueshmërisë në sektorët e evidentuar me risk

Bazuar në planet vjetore të pajtueshmërisë së administratës tatimore do të realizohen plane specifike sektoriale në ata sektorë ekonomik, të cilët identifikohen dhe vlerësohen me riskun e shmangies së TVSh-së. Do trajtohen me vëmendje fenomenet me risk për kategori të ndryshme tatimpaguesish, tatimesh dhe shtrirje gjeografike.

Masa 2.1.5 Zgjerimi i bazës së tatueshme me rritjen e numrit të tatimpaguesve të përfshirë në përgjegjësinë e TVSh-së

Zgjerimi i bazës tatimore për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar (TVSH) në Shqipëri është i rëndësishëm pasi synon:

1. Rritje të të ardhurave buxhetore: Një bazë më e gjerë tatimore për TVSh-në do të thotë më shumë subjekte tatimore që paguajnë këtë tatim. Kjo do të rezultonte në më shumë të ardhura për buxhetin e shtetit,

2. Barazi dhe drejtësi tatimore: Zgjerimi i bazës tatimore për TVSh-në nënkupton përfshirjen e më shumë subjekteve që kryejnë aktivitete ekonomike. Kjo do të ndihmonte në uljen e informalitetit dhe do të siguronte një konkurrencë të drejtë në të bërit biznes për subjektet tatimore.

3. Efikasitet më i lartë administrativ: Një bazë më e gjerë tatimore do të thotë se më pak subjekte do të ikin nga detyrimi për të paguar TVSh-në. Kjo do të ulë kostot administrative për Administratën Tatimore për të identifikuar dhe ndjekur subjektet joformale.

4. Luftë kundër evazionit fiskal: Një bazë më e gjerë tatimore ul hapësirat për evazion fiskal dhe shmangien e TVSh-së, duke rritur kështu disiplinën fiskale në vend.

Situata ndër vite e numrit të tatimpaguesve të regjistruar në TVSh, paraqitet si më poshtë:

Tabela 13: Numri i subjekteve aktive me përgjegjësi TVSh-je

Vitet	2021	2022	2023
Numri i subjekteve	27,883	31,215	33,283

Aktiviteti 2.1.5.1. Krijimi i kritereve të riskut që evidentojnë tatimpagues me riskun e shmangies së TVSH-së.

Kritere të reja risku të natyrës si: numër i lartë punonjësish, blerje mbi kufirin e TVSH-së, qarkullim të deklaruar në mënyrë të vijueshme në kufi të pragut pa e kaluar atë etj, do aplikohen nga administrata tatimore në sektorë të caktuar.

Aktiviteti 2.1.5.2 Parambushja e deklaratës së TVSH brenda vitit 2026

Fiskalizimi si reforma më madhore e implementuar nga administrata tatimore gjatë viteve të fundit ndryshoi rrënjësisht mënyrën e faturimit, duke sjellë faturimin dhe deklarimin pranë AT në kohë reale. Aktualisht, po punohet për konsolidimin e procesit të fiskalizimit, bërjen funksional të një moduli risku vetëm për këtë proces dhe zhvillimin e raporteve *Business Intelligent* që do ndihmojnë në një gjurmim më të lehtë dhe më efikas të subjekteve mospërbushës. Administrata tatimore ka hedhur hapa përpara dhe ka mundur parambushjen dhe deklarimin automatik të librave të shitjes dhe blerjes si dhe në të ardhmen e shpejtë synon parambushjen dhe deklarimin automatik të deklaratës së tvsh-së.

Parambushja e deklaratës së TVSH do bëhet brenda vitit 2026 dhe me këtë proces mbyllet cikli i deklarimit automatik që nga faturimi deri në deklarimin final të TVSH-së kështu administrata tatimore disponon në kohë reale ecurinë e deklarimit të TVSH-së për çdo tatimpagues.

V.3 Komponenti 2.2 Ulja e pagesave me para në dorë në ekonomi

Objektivi

Synimi i këtij komponenti është ulja e qarkullimit të pagesave me para në dorë në ekonomi nëpërmjet masave të administrimit fiskal.

Konteksti

Përdorimi i pagesave me para në dorë në Shqipëri ka qenë dhe mbetet ende i lartë në krahasim me vendet e tjera evropiane. Sipas të dhënave të fundit nga Banka e Shqipërisë, rreth 90% e transaksioneve të konsumit përfundimtar kryheshin me para në dorë në vitin 2022. Raporti i vlerës së kartëmonedhave dhe monedhave në qarkullim ndaj M3 (Agregatit të Gjerë Monetar). Në fund të vitit 2022, ky raport ishte 27.9% në Shqipëri sipas Bankës së Shqipërisë. Kjo është shumë më e lartë se mesatarja e vendeve të Bashkimit Evropian prej 10.7%. Bazuar në të dhënat e “Raportit Vjetor 2022 të Bankës së Shqipërisë”⁶ në fund të vitit 2022, infrastruktura e ofruar nga këto banka ka shënuar një rritje të konsiderueshme në numrin e terminaleve POS me 18.1% krahasuar me vitin 2021. Megjithatë, përqendrimi i këtyre terminaleve vijon të jetë i lartë në qarkun e Tiranës me 83.3% të tyre, për shkak të përqendrimit të madh të sipërmarrësve dhe popullsisë në këtë zonë. Gjithashtu, është vërejtur një shpërndarje më e gjerë e rjetit të POS-eve në rajonet e tjera të vendit gjatë vitit 2022, me përjashtim të qarkut të Elbasanit. Përdorimi i kartave në pikat POS është rritur me 35.5% krahasuar me vitin 2021.

Rritja e numrit të ATM-ve dhe funksionet e reja

Numri i ATM-ve është rritur me 4.0% krahasuar me vitin 2021. Megjithatë ATM-të përdoren kryesisht për tërheqje *cash*-i, gjatë vitit 2022 ka pasur një zgjerim të funksionit të ATM-ve që lejojnë depozitimet, me përdorim të rritur krahasuar me vitin 2021. Për 100,000 të rritur në Shqipëri, numri i ATM-ve dhe POS-eve ka pësuar një rritje të vazhdueshme gjatë 5 viteve të fundit, duke treguar një rritje të përdorimit të kartave dhe përfshirjes financiare.

Reduktimi i transaksioneve me para fizike


Transaksionet me para fizike në sportelet e bankave kanë shënuar një rënie në numër me 9.2% dhe një rritje të lehtë në vlerë me 1.3% në vitin 2022 krahasuar me një vit më parë. Përdorimi i parasë fizike mbetet ende mbizotërues në ekonominë shqiptare, duke mbartur kosto të larta për aktorët ekonomikë. Për këtë arsye, është thelbësore nxitja e përdorimit të instrumenteve më efikase dhe me kosto të ulëta, që përbën një nga prioritetet e Bankës së Shqipërisë.

Grafikët në vijim tregojnë trendin e rritjes ndër vite të terminaleve POS dhe ATM-eve 2015–2022 (të dhëna të plota) dhe projekcion me të dhëna të pjesshme për 2023.


⁶ Ky është një kusht sipas Planit të Rritjes.

⁷ https://www.bankofalbania.org/Botime/Botime_Periodike/Raporti_Vjetor/

Grafik 8: Terminale POS (Point of Sale) gjatë viteve



Grafik 9: Indikator Terminale POS për 100.000 banorë



Burimi: Banka e Shqipërisë

Këto shifra tregojnë se ekonomia shqiptare vazhdon të jetë e dominuar nga përdorimi i parave fizike, megjithëse, vitet e fundit ka pasur një rritje të lehtë të përdorimit të kartave dhe pagesave elektronike. Raporti i përdorimit të *cash*-it ndaj kartave dhe formave të tjera të pagesave *online* është akoma shumë i lartë. Disa nga arsyet kryesore që ndikojnë në këtë fenomen janë:

1. Kultura jonë e kryerjes së pagesave me para në dorë;
2. Normë e ulët interesi për depozitat;
3. Mosinstalimi i terminaleve POS në të gjitha pikat e shitjes me pakicë;
4. Burimi i parave *cash*, nëse një individ ka një të ardhur 80 mijë lekë në muaj dhe shpenzon 200 mijë lekë në muaj, pra jashtë burimit të ligjshëm, logjikisht që këtë diferencë e ka të krijuar nga burime të paligjshme;
5. Niveli i ekonomisë informale/jozyrtare;
6. Niveli i ulët i edukimit financiar dhe rezistenca ndaj ndryshimit.

Megjithatë, qeveria dhe banka qendrore kanë ndërmarrë disa masa për të nxitur përdorimin e pagesave elektronike, si ulja e komisioneve bankare, promovimi i edukimit financiar, etj. Kjo pritet të ulë gradualisht varësinë nga paraja fizike në vitet e ardhshme.

Prioritetet:

Prioritetet për periudhën 2024–2027 janë:

- Ulje e përdorimit të pagesave me para në dorë në ekonomi;
- Rritje e pagesave nëpërmjet *e-banking*;
- Rritja e transaksioneve nëpërmjet faturave *e-invoice* pa para në dorë;

- Rritja e numrit të tatimpaguesve që përdorin POS-et në ambientet e aktivitetit të tyre.

Masat dhe aktivitetet

Masa	Aktivitetet	Fillimi	Mbarimi	Institucioni përgjegjës
Masa 2.2.1 Zbatimi i një plani masash nga administrata tatimore për të ulur pagesat me para në dorë në ekonomi	Aktiviteti 2.2.1.1 Vendosja një limiti për pagesat <i>cash</i> mes individëve; Aktiviteti 2.2.1.2: Reduktimi i mëtejshëm për pagesat me para në dorë mes bizneseve nga 150.000 lekë që është aktualisht. Aktiviteti 2.2.1.3: Krijimi i rregullave të riskut të cilat evidentojnë tatimpaguesit të cilët fragmentizojnë faturat për të mos kaluar limitin që përcakton ligji, tatimpaguesit që kanë nivel anormal të faturimit me para në dorë krahasuar me të ngjashmit e tyre.	2025	2026	MF/ DPT
Masa 2.2.2 Diskutimi me sektorin bankar për reduktimin e komisioneve bankare për tatimpaguesit që përdorin POS-in.	Aktiviteti 2.2.2.1: Krijimi i një grupi pune mes MF-së, Bankës së Shqipërisë dhe Shoqatës së Bankave për të ulur komisionet e përdorimit të terminaleve POS mes bankave të nivelit të dytë dhe tatimpaguesve	2025	2025	MF/DPT/BSH/ Shoqata Shqiptare e Bankave

Treguesit e performancës dhe vlerat e synuara

Treguesi	Vlera bazë (viti 2023)	Vlera e synuar			
		2024	2025	2026	2027
Ulja e qarkullimit të parasë në dorë në ekonomi	90% e transaksioneve të konsumit përfundimtar kryeshin me para në dorë në vitin 2022	Trend rënës	Trend rënës	Trend rënës	Trend rënës

Më poshtë është një përshkrim i masave dhe aktiviteteve për realizimin e këtij komponenti.

Masa 2.2.1 Zbatimi i një plani masash nga administrata tatimore për të ulur pagesat *cash* në ekonomi

Aktualisht, pjesë e strategjisë 4-vjeçare do të jetë ulja e parasë *cash* nëpërmjet përdorimit të terminaleve POS në Shqipëri. Vende të ndryshme të botës i kanë zbatuar me sukses këto eksperiencë. Greqia, nga 1 janari 2020, aplikon penalitetet tek individët nëse 1/3 e të ardhurave nuk e kanalizojnë nëpërmjet terminaleve POS. Aktualisht, Shqipëria ka një nivel shumë të ulët të përdorimit të POS-eve. Në vitin 2022, janë rreth 18,570 POS-e të instaluar nga tatimpaguesit, shifër kjo e papërfillshme duke marrë në konsideratë që në vend ushtrojnë aktivitet ekonomik mbi 125 mijë biznese.

Pavarësisht masave që ka marrë Banka e Shqipërisë për reduktimin e parasë *cash*, si dhe uljes së kostos së mbajtjes së llogarisë bankare për individë dhe biznese të vogla, nga ana e administrimit tatimor, bazuar dhe në eksperiencat e vendeve të tjera mbi masat e marra prej tyre për të ulur përdorimin e pagesave *cash* në vend, Strategjia ka parashikuar masat e mëposhtme për të zhvendosur qarkullimin *cash* drejt pagesave elektronike. Kjo është në harmoni të plotë edhe me projektin e fiskalizimit.

- Aktiviteti 2.2.1.1: Vendosja e një limiti për pagesat *cash* mes individëve;
- Aktiviteti 2.2.1.2: Reduktimi i mëtejshëm për pagesat me para në dorë mes bizneseve nga 150.000 lekë që është aktualisht.
- Aktiviteti 2.2.1.3: Krijimi i rregullave të riskut, të cilat evidentojnë tatimpaguesit të cilët fragmentizojnë faturat për të mos kaluar limitin që përcakton ligji, tatimpaguesit që kanë nivel anormal të faturimit *cash* krahasuar me të ngjashmit e tyre.

Masa 2.2.2 Diskutimi me sektorin bankar për reduktimin e komisioneve bankare për tatimpaguesit që përdorin POS-et

- Aktiviteti 2.2.2.1: Krijimi i një grupi pune mes Ministrisë së Financave, Bankës së Shqipërisë dhe Shoqatës Shqiptare të Bankave për të ulur komisionet e përdorimit të terminaleve POS mes bankave të nivelit të dytë dhe tatimpaguesve.

V.4 Komponenti 2.3 Verifikimi i të ardhurave dhe kontrolli i pasurive të pajustifikuara Objektivi

Objektivi kryesor i këtij komponenti konsiston në ngritjen e sistemeve, regjistrave dhe kapaciteteve për hetimin e pasurive të pajustifikuara, si dhe kryerja e hetimeve të tatimpaguesve dhe individëve

bazuar në të dhënat e këtyre sistemeve, në përputhje të plotë me kushtet për afatin dhe treguesit e përcaktuar në Planin e Rritjes.

Konteksti

Ndër vite, në AT është investuar, lidhur me krijimin e sistemeve për të identifikuar evazionin tatimor apo për të pasur instrumente ndihmëse. Përpos projektit të fiskalizimit, me ligjin e vitit 2020 është krijuar Regjistri Qendror i Llogarive Bankare i cili është një bazë e të dhënave shtetërore. Qëllimi i krijimit të këtij regjistri është krijimi i kushteve për parandalimin e përdorimit të sistemit financiar në Republikën e Shqipërisë, për pastrimin e parave dhe produkteve me origjinë nga vepra penale, për parandalimin e financimit të terrorizmit, si dhe për lehtësimin e procedurave për mbledhjen e detyrimeve tatimore, taksat apo tarifën, në nivel qendror apo lokal.

Administrata Tatimore ka bërë përparime në përputhje me standardet e Shkëmbimit Automatik të Informacionit (AEOI) të OECD. Shqipëria mbetet e vetmi vend i Ballkanit Perëndimor që zbaton kuadrin ligjor AEOI dhe ndau informacionin e saj me më shumë se 77 juridiksione (përfshirë 24 shtete anëtare të BE-së) në vitin 2022.

Prioritet tashmë përbën fillimi i përpunimit dhe përdorimit të informacionit rreth taksapaguesve të marrë gjatë kësaj periudhe. Me strukturën e re të AT-së të miratuar në maj 2023, është krijuar Drejtoria e Informacionit – Sektori i Komunikimit, i cili do jetë përgjegjës edhe për CRS-të. AT është në fazën e rekrutimit të stafit dhe me rekrutimin e tij lind nevoja edhe për trajnimin e tij lidhur me CRS-të.

Prioritare do të jetë krijimi i dy sistemeve të rëndësishme, për AT-në për të pasur të dhënat e nevojshme mbi pasuritë totale të individëve, nga palët e treta, për të bërë investigimet përkatëse për përputhshmërinë tatimore.

Bazuar në sistemet ekzistuese, si dhe në sistemet e reja, në periudhën afatmesme AT-ja do të ndërmerret një seri auditimesh si të individëve ashtu edhe të tatimpaguesve.

Plani i Rritjes së Agjendës së Reformave të KE-së ka përcaktuar katër masa të qarta me indikatorët e afate lidhur me krijimin e regjistrit të aseteve, përdorimin e të dhënave të palëve të treta, auditimi i mbi 200 individëve të pasur brenda vitit 2026. Masat që do të ndërmerren nën këtë komponent, si dhe në komponentin 2.4, lidhur me zvogëlimin e shmangieve tatimore do të bëjnë të mundur realizimin e këtyre kushteve dhe të indikatorëve përkatës.

Prioritetet:

Prioritetet për periudhën 2024–2027 janë:

1. Zbatim plotësisht i kushteve sipas Planit të Rritjes në:

1. Ngritja e Regjistrit të Aseteve të tatimpaguesve me synimin e një vlerësimi real të pasurive të tatimpaguesit dhe plotësimi i regjistrit të pasurive të tatimpaguesve për 10% të tatimpaguesve brenda vitit 2026;

2. Përdorimi i të dhënave nga palë të treta si nga regjistri i shërbimeve publike (elektrike, ujë, regjistri i automjeteve, bashkive për t'i mundësuar AT-së hetimin e pasurive të pajustificuara të taksapaguesve (qershor 2025);

3. Kryerja e procedurave të auditimit për mbi 200 individë të pasur, bazuar në vlerësimin e riskut, brenda vitit 2026.

2. Shkëmbimi automatik i informacionit tatimor me administratat tatimore të huaja në kuadër të CRS-së dhe përdorimi i tij.

Masat dhe aktivitetet

Masa	Aktivitetet	Fillimi	Mbarimi	Institucioni përgjegjës
Masa 2.3.1 Përdorimi i metodave të tërthorta për vlerësimet tatimore	Aktiviteti 2.3.1.1: Përditësimi i Manualit të Kontrollit Tatimor Aktiviteti 2.3.1.2: Analizë e Hendekut Tatimor (<i>Tax Gap</i>) Aktiviteti 2.3.1.3: Monitorimi i zbatimit të Planit të Veprimit të strategjinë e pajtueshmërisë 3-vjeçare për individët më të pasur dhe përditësimi i saj deri në vitin 2027	2025	2026	DPT/MF

Masa 2.3.2 Identifikimi i mosdeklarimit, në lidhje me juridiksionet <i>offshore</i> bazuar në të dhënat e mbledhura AEOI, sipas kuadrit të Standardit të Raportimit të Përbashkët (CRS)	Aktiviteti 2.3.2.1: Bërja efektive në DPT të strukturës përgjegjëse për CRS-në dhe trajnimi i stafit; Aktiviteti 2.3.2.2: Zbatimi i Projektit të Shkëmbimit Automatik të Informacionit; Aktiviteti 2.3.2.3: Analiza periodike mbi rastet e evazionit tatimor në lidhje me juridiksionet <i>offshore</i> ; Aktiviteti 2.3.2.4: Zbatimi i rregullores së brendshme që përcakton mënyrën e rrjedhjes së informacionit në DPT si dhe monitorimin e bankave mbi zbatimin e verifikimit të duhur; Aktiviteti 2.3.2.5: Rishikimi i marrëveshjes dhe rritja e bashkëpunimit ndërinstytucional (FIU), lidhur me monitorimin e bankave si subjekte raportuese dhe rekomandimet e MONEYVAL; Aktiviteti 2.3.2.6: Zbatimi i Rregullave Globale Antierozionit (GloBE).	2024	2025	DPT
Masa 2.3.3: Ngritja e Regjistrat të Aseteve të tatimpaguesve me synimin e vlerësimit real të pasurive të tatimpaguesve	Aktiviteti 2.3.3.1: Krijimi i një Regjistrit të Aseteve me atributet përkatëse, për 10% të tatimpaguesve brenda vitit 2026; Aktiviteti 2.3.3.2: Analiza e të dhënave me raportet <i>Business Intelligence (BI)</i> .	2024	2026	DPT në bashkëpunim me AKSHI-n
Masa 2.3.4: Integrimi dhe përdorimi i të dhënave nga palët e treta, në mënyrë që të mundësojë programin e administratës hetimore tatimore të pasurisë së pajustificuar për taksapaguesit	Aktiviteti 2.3.4.1: Integrimi dhe përdorimi i të dhënave nga palët e treta; Aktiviteti 2.3.4.2: Shkëmbimi i të dhënave nëpërmjet <i>web-service</i> -ve.	2024	qershor 2025	DPT

Treguesit e performancës dhe vlerat e synuara

Treguesi	Vlera bazë (viti 2023)	Vlera e synuar			
		2024	2025	2026	2027
Numri i individëve të pasur të audituar	33			200	
Numri i individëve të investiguar nga AT-ja duke përdorur të dhënat nga palët e treta	Nuk ka				100
Numri i marrëveshjeve të bashkëpunimit të lidhura në fushën e investigimit financiar dhe korrupsioni midis Agjencive ligjzbatuese.					5
Krijimi i Regjistrat të Pasurive të Tatimpaguesve	0%			10% e tatimpaguesve	15% e tatimpaguesve

Më poshtë është një përshkrim i masave dhe aktiviteteve për realizimin e këtij komponenti.

Masa 2.3.1 Përdorimi i metodave të tërthorta për vlerësimet tatimore

Akumulimi i pasurive të pajustificuara - ku të ardhurat e deklaruara dhe burimet e fondeve janë qartësisht të pamjaftueshme për të financuar stilin e jetës dhe asetëve - është një faktor kryesor në minimizimin e besimit në sistemin tatimor.

Tradicionalisht, inspektorët e DPT-së mund të vlerësojnë përgjegjësinë tatimore vetëm kur ka prova të drejtpërdrejta të evazionit nga librat dhe regjistrimet ose informacionet e palëve të treta. Ligji për procedurat tatimore u ndryshua për të mundësuar qartazi përdorimin e metodave të tërthorta të auditimit dhe për të përcaktuar se vlerësimet e arsyeshme të detyrimeve tatimore, të mbështetura në metoda të tilla janë të vlefshme. Përrashtime bëjnë rastet kur tatimpaguesit të mund të shpjegojnë burimin e akumulimit të pasurisë ose mospërputhje të tjera. Administrata Tatimore do të përdorë metodat indirekte për të nxjerrë vlerësimet tatimore. Manualët e kontrollit do të rishikohen që të përfshijnë një kapitull të veçantë për metodat indirekte.

Programi i pajtueshmërie për individët më të pasur

Lidhur me zbatimin e një programi pajtueshmërie për individët më të pasur, administrata tatimore hartoi, në mesin e vitit 2022, Strategjinë e pajtueshmërisë 3-vjeçare për individët më të pasur, e cila u miratua me vendim të drejtorit të përgjithshëm të DPT-së me nr. 30, datë 2.6.2022. Plani për zbatimin e strategjisë së përputhshmërisë për individët më të ardhura të larta është miratuar edhe me vendimin nr. 4, datë 3.5.2023, të Komisionit të Riskut. DPT-ja ka filluar edhe analizat dhe kontrollet me informacione të bazuara në rrezik në bashkëpunim me palët e treta dhe deri tashmë janë kryer kontrole/auditime në 33 persona.

Aktualisht, DPT-ja po ndërmerr një projekt pilot me Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor të Shqipërisë për të krahasuar individët që zotërojnë makina luksoze me deklarimin e tyre të të ardhurave personale, (DIVA) si fazë e parë e këtij projekti dhe në të ardhmen për të zgjeruar shkëmbimin e informacionit në asetet e tjera të tatimpaguesit. Gjithashtu, po konsiderohen edhe individët subjekt sanksionesh në përputhje me marrëveshjen që vendi ynë ka me organizatat ndërkombëtare.

Strategjia e Pajtueshmërisë Individuale do të fillojë të zbatohet për të gjithë Individët që deklarojnë DIVA.

Gjatë periudhës 4-vjeçare, 2024–2027, për të adresuar evidentimin e rasteve të pasurisë së madhe të pashpjeguar nga individët, DPT-ja do të ndërmarrë këto masa:

- Aktiviteti 2.3.1.1: Përditësimi i Manualit të Kontrollit Tatimor, Manualet e kontrollit do të përfshijnë me një kapitull të veçantë për metodat indirekte.

- Aktiviteti 2.3.1.2: Analizë e Hendekut Tatimore (*Tax Gap*).

Kjo analizë do të synoj identifikimin e arsyeve përse nuk janë përmbushës tatimpaguesit dhe hartimi i masa të dedikuara që adresojnë çështjet kryesore, duke i ndihmuar tatimpaguesit të jenë përmbushës vullnetarë ose të shmangin mospajtueshmërinë.

- Aktiviteti 2.3.1.3: Monitorimi i zbatimit të Planit të Veprimit të strategjinë e pajtueshmërisë 3-vjeçare për individët më të pasur dhe përditësimi i saj deri në vitin 2027.

Masa 2.3.2 Identifikimi i mosdeklarimit, në lidhje me juridiksionet *offshore* bazuar në të dhënat e mbledhura AEOI sipas kuadrit të Standardit të Raportimit të Përbashkët (CRS)

Një tipar ndërkombëtar i evazionit tatimor (zakonisht nga individë relativisht të pasur) është kalimi i shumave të parave në vende *offshore*. Në adresim të këtij fenomeni, OECD-ja ka bashkuar 150 juridiksione (Forumi Global) për t'u angazhuar në shkëmbimin automatik të informacionit për llogaritë financiare. Shqipëria filloi shkëmbimet e para automatike në dhjetor 2020 (me ndihmë teknike nga autoritetet tatimore italiane) dhe do të fillojë të marrë informacione për individë shqiptarë që kanë llogari financiare në juridiksionet e huaja (përfshirë këtu edhe pjesën më të madhe të “strehëve” tradicionale *offshore*). Duke filluar nga viti 2022, administrata tatimore ndau informacionin e tij me më shumë se 77 juridiksione. DPT-ja do të fillojë përpunimin dhe përdorimin e informacionit të tatimpaguesit të marrë gjatë kësaj periudhe. Përvoja e vendeve që e kanë adaptuar më herët këtë masë, është që informacioni i shkëmbyer identifikon evazion të konsiderueshëm tatimor dhe Shqipëria nuk ka gjasa të jetë një përjashtim.

Në periudhë afatmesme, Shqipëria do të fillojë përgatitjet për zbatimin e Rregullave Globale Antierozionit (GloBE), të cilat ka të ngjarë të kenë një ndikim të rëndësishëm në sistemin e saj tatimor të brendshëm. Norma statutore e tatimit mbi të ardhurat e korporatave (CIT) është relativisht e ulët në krahasim me vendet e OECD-së dhe përdorimi i stimuljeve bujarë tatimore mund të ulë më tej normën efektive tatimore.

Gjithashtu, do të kryhen analiza periodike mbi rastet e evazionit tatimor, në lidhje me juridiksionet *offshore*. Bazuar te CRS-ja, DPT-ja ka hartuar një rregullore të brendshme që përcakton mënyrën e rrjedhjes së informacionit në DPT, si dhe mënyrën e monitorimit të bankave mbi zbatimin e verifikimit të duhur.

Me strukturën e re të DPT-së, të miratuar me urdhrin nr. 69, datë 26.5.2023, është krijuar Drejtoria e Informacionit – Sektori i Komunikimit, i cili do të jetë përgjegjës edhe për CRS-në. AT-ja është në fazën e rekrutimit të stafit për këtë sektor dhe me rekrutimin e tij lind nevoja edhe për trajnimin e tij lidhur me CRS-në.

- Aktiviteti 2.3.2.1: Bërja efektive në administratën tatimore të strukturës përgjegjëse për CRS-në dhe trajnimi i stafit;

- Aktiviteti 2.3. 2.2: Zbatimi i Projektit të Shkëmbimit Automatik të Informacionit;

- Aktiviteti 2.3.2.3: Analiza periodike mbi rastet e evazionit tatimor, në lidhje me juridiksionet *offshore*;

- Aktiviteti 2.3.2.4: Zbatimi i rregullores së brendshme që përcakton mënyrën e rrjedhjes së informacionit në administratën tatimore, si dhe monitorimin e bankave mbi zbatimin e verifikimit të duhur;

- Aktiviteti 2.3.2.5: Rishikimi i marrëveshjes dhe rritja e bashkëpunimit ndërinstitucional (FIU), lidhur me monitorimin e bankave si subjekte raportuese dhe rekomandimet e *Moneyval*;

- Aktiviteti 2.3.2.6: Zbatimi i Rregullave Globale Antierozionit (GloBE).

Masa 2.3.3 Ngritja e Regjistrit të Aseteve të tatimpaguesve me synimin e vlerësimit real të pasurive të tatimpaguesve

Ndërtimi i Regjistrit të Aseteve të Tatimpaguesve synon vlerësimin real të pasurisë së tatimpaguesve, ndërtimin e një sistemi verifikimi dhe gjurmimi të të ardhurave të tatimpaguesve, kontrollin e plotë të pagesave të kryera për tatimin në pronë. Disa nga problematikat e evidentuara për krijimin e Regjistrit të Pasurive të Tatimpaguesve janë:

1. Mungesa e regjistrave digjitalë nga palët e treta (Agjencia Shtetërore e Kadastrës (ASHK), Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor (DPSHTRR), Aviacioni Civil, Autoriteti Detar, etj.);

2. Informacioni që merret manualisht është i pastrukturuar;

3. Bërja e ndryshimeve në sistemet e shkëmbimit të të dhënave sipas fushave të caktuara, për të analizuar të dhënat me raportet e BI-së.

Plotësimi i regjistrit të pasurive të tatimpaguesve do të bëhet fillimisht për 10% të tatimpaguesve brenda muajit dhjetor 2026. Janë 128.000 taksapagues aktivë në vitin 2023 dhe pritet të ketë një regjistër për 10%, ose afërsisht për 12.800 taksapagues brenda vitit 2026.

Kjo masë është një kusht i Planit të Rritjes për t'u plotësuar brenda vitit 2026. Administrata tatimore ka nisur punën dhe në fakt, ajo zbatohet në një sistem aplikimi C@TS (sistemi i informacionit të administratës tatimore) ku të gjithë tatimpaguesit do të kenë mundësinë dhe detyrimin për të deklaruar aktivitetin e tyre, dhe për shumën e kontratave me furnizuesit e energjisë elektrike dhe ujit. Nga korriku deri në shtator, tatimpaguesit janë njoftuar dhe udhëzuar për mënyrën e deklarimit dhe nga data 1 tetor deri më 20 nëntor 2024 është afati i fundit për deklarimin e këtyre të dhënave. Nga të dhënat e deritanishme, procesi po shkon shumë mirë.

Krijimi i Regjistrit është parashikuar të bëhet brenda vitit 2026. Ky proces do të kalojë në 2 faza:

- Aktiviteti 2.3.3.1: Krijimi i një Regjistri të Aseteve me atributet përkatëse, për 10% të tatimpaguesve, brenda vitit 2026;

- Aktiviteti 2.3.3.2: Analiza e të dhënave me Raportet *Business Intelligent*.

Regjistri i asetëve për rreth 10 % të tatimpaguesve do të krijohet me të dhënat nga vetëdeklarimi që po kryejnë subjektet në modulën e adresave të *e-filling*. AKSHI do të asistojë administratën tatimore në sigurimin e të dhënave të vetëdeklaruarra sipas formularit.

Masa 2.3.4 Integrimi dhe përdorimi i të dhënave nga palët e treta për kryerjen e hetimeve tatimore të pasurisë së pajustificuar të taksapaguesve

Kjo masë e rëndësishme për përmirësimin dhe konsolidimin dhe administratën tatimore konsiston në përdorimin e të dhënave nga palët e treta, si përdorimi i të dhënave që lidhen me shërbimet e shërbimeve (energji, ujë) dhe regjistrimin e automjeteve, në mënyrë që të mundësohet administratës tatimore të kryejë hetime tatimore të pasurisë së pajustificuar për taksapaguesit. Kjo masë është kusht në Planin e Rritjes dhe Administrata Tatimore është plotësisht e angazhuar në sigurimin e asetëve nga palët e treta, brenda qershorit 2025.

Administrata tatimore vitet e fundit ka marrë një sërë iniciativash për sigurimin e informacionit nga palët e treta që disponojnë të dhëna në formë digjitale por jo vetëm të cilat e ndihmojnë në analizën

dhe evidentimin e tatimpaguesve ose individëve mospërbushës, ose me shmangie tatimore. Ajo ka nënshkruar një mori memorandumesh bashkëpunimi me agjenci shtetërore ose publike ndër të cilat mund të përmenden:

- Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore;
- Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor (Kadastra e automjeteve);
- Agjencia e Inteligjencës Financiare;
- Agjencinë Kombëtare të Bregdetit;
- Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike;
- bashkitë;
- Instituti i Sigurimeve Shoqërore.

Gjithashtu, në kuadrin e projektit për Regjistrin e Pasurive të Tatimpaguesve, masë e shpjeguar më lart dhe kusht i Planit të Rritjes së Agjendës së reformave, administrata tatimore në bashkëpunim dhe nën asistencën e Administratës Tatimore Suedeze ka zhvilluar një format elektronik deklarimi që i mundëson të gjithë tatimpaguesit të vetëdeklarojnë në sistemin informatik të AT-së të dhëna që kanë të bëjnë me vendushtimin e aktivitetit, pronësinë ose qiramarrjen e vendushtimit, të dhëna mbi natyrën e vendit ku ushtrohet aktiviteti (ndërtesë/sipërfaqje/vlera/kontratat me utilitarët, etj.).

Të gjitha këto të dhëna të siguruar do të ndihmojnë administratën tatimore të përmbushë shpenzimet e çdo tatimpaguesi në mënyrë që të vlerësojë nëse të ardhurat e vetëdeklaruara prej tyre janë në raport të drejtë me shpenzimet e kryera dhe nëse individët që disponojnë pasuri të mëdha (prona, automjete, mjete lundrimi etj.) e justifikojnë me të ardhurat e deklaruara nga aktiviteti tregtar ose me pagën e tyre.

Administrata tatimore ka pasur një projekt-pilot të ngjashëm në fillim të vitit 2022, në kudër të nismës për informalitetet në paga dhe rezultatet ishin domethënëse në vlerën e zbuluar edhe pse numri i rasteve të trajtuara ishte i vogël.

Të gjitha sa më sipër do të shërbejnë si burime shumë të rëndësishme informacioni që do të ndihmojnë në arritjen e kushtit dhe indikatorit tjetër të Planit të Rritjes që lidhet me hetimin e pasurisë së 200 individëve të pasur.

- Aktiviteti 2.3.4.1: Integrimi dhe përdorimi i të dhënave nga palët e treta

Administrata tatimore është plotësisht e angazhuar në sigurimin e të dhënave të palëve të treta dhe vazhdon të nënshkruajë memorandume bashkëpunimi me të gjitha institucionet përkatëse për të siguruar digjitalizimin e të gjitha regjistrave që përmbajnë të dhëna që ndihmojnë në identifikimin e pasurive të padeklaruara ose ndihmojnë në procesin e hetimit të njësive apo individëve jokonformistë. Gjithashtu, ka vijuar nënshkrimi i memorandumeve të bashkëpunimit me të gjitha institucionet për të siguruar në mënyrë të digjitalizuar të gjithë regjistrat në dispozicion për të ndihmuar në evidentimin e pasurive të padeklaruara ose për të ndihmuar procesin e hetimit të subjekteve apo individëve të paplotësuar. Administrata tatimore po punon që bazuar në memorandumet e bashkëpunimit të nënshkruara të integrojë informacionin dhe të dhënat që disponojnë këto institucione në sistemin informatik dhe në analizat, dhe vlerësimet e saj të riskut në mënyrë që këto të dhëna të përdoren për të evidentuar mospërbushjen, shmangien ose evazionin fiskal nga ana e tatimpaguesve.

- Aktiviteti 2.3.4.2: Shkëmbimi i të dhënave nëpërmjet *web-service*-ve

Administrata tatimore ka kërkuar që për të siguruar këtë informacion në mënyrë të shpejtë, transparent dhe të saktë, dhe mbi të gjitha të sigurt shkëmbimi i këtyre të dhënave bëhet nëpërmjet *web-servis*-eve që mundësohen nga AKSHI me kërkesë të administratës tatimore dhe institucioneve përkatëse.

V.5 Komponenti 2.4 Zvogëlimi i shmangies tatimore

Objekti

Objektivi kryesor i këtij komponenti konsiston në auditimin e 500 taksapaguesve bazuar në forcimin e hetimeve kundër mashtrimit tatimor nëpërmjet një liste konkrete masash, krijimin e instrumenteve të duhura për të investiguar rastet e shmangieve tatimore. Masat e ndërmarra do të sjellin përmbushjen e realizimit të numrit të investigimeve sipas Planit të Rritjes, si dhe rritjen e të ardhurave nga tatimi mbi fitimin dhe tatimin mbi qiranë me 0.87% të PBB-së ose 22,6 miliardë lekë për periudhën 4-vjeçare.

Konteksti

Nga analizat e brendshme rezulton se ka një ekspozim të ndjeshëm ndaj humbjeve tatimore nga shmangiet që vijnë nga një kombinim i shumë “zonave gri” në ligjet tatimore dhe mundësi nga tatimpagues, të vetëpunësuar dhe kompanitë ndërkombëtare për të shfrytëzuar boshllëqet dhe mospërputhjet. Këto çështje duhet të adresohen për të parandaluar dhe pakësuar humbjet tatimore.

Tabela 14: Rritja e të ardhurave nga tatimi mbi fitimin dhe mbi qiratë

Në milionë lekë					
Të ardhurat nga komponenti 2.5	2024	2025	2026	2027	Totali 2024–2027
Tatim fitimi	5,466	6,030	3,316	3,482	18,294
TAP-i mbi qiranë	487	1,067	1,280	1,536	4,369
Totali	5,952	7,097	4,597	5,018	22,664
në % të PBB-së					
Tatim fitimi	0.22%	0.24%	0.12%	0.12%	0.71%
TAP-i mbi qiranë	0.02%	0.04%	0.05%	0.05%	0.16%
Totali	0.24%	0.28%	0.17%	0.18%	0.87%

Prioritetet:

Prioritetet për periudhën 2024–2027 janë:

- Zbatimi i kushteve të Planit të Rritjes për hetimet tatimore për rastet e shmangies së taksave, nëpërmjet:

- Kryerjes së hetimeve ndaj 500 tatimpaguesve, brenda qershorit 2027;
- Kryerjes së investigimeve për raste të antishmangies tatimore nëpërmjet një liste konkrete masash;
- Fuqizimi të investigimeve tatimore;
- Udhëzimi mbi zbatimin e rregullave për antishmangien tatimore;
- Administrata tatimore ka kapacitetet njerëzore dhe instrumentet e duhura për të bërë investigime

në fushën e antishmangies tatimore;

- Plane sektoriale për rastet e vetëpunësimit dhe ndarjes artificiale të bizneseve;
- Rritja e të ardhurave nga tatimi mbi fitimin me 0.7% e PBB-së, për katër vjet;
- Rritja e të ardhurave nga tatimi mbi qiratë me 0.16% të PBB-së, për katër vjet;

Masat dhe aktivitetet

Masa	Aktivitetet	Fillimi	Mbarimi	Institucioni përgjegjës
Masa 2.4.1 Rregulli i përgjithshëm antiabuzim (GAAR) zbatohet në mënyrë efektive dhe të veprojë si frenues për organizimet artificiale tatimore	Aktiviteti 2.4.1.1: Trajnime për stafin e administratës tatimore mbi rregullat dhe kontrollet për antishmangien tatimore.	2026	2027	DPT/MF
Masa 2.4.2 Hartimi i masave antievazion për të luftuar organizimet artificiale më të përhapura si të vetëpunësuarit fiktiv dhe ndarja artificiale e subjekteve	Aktiviteti 2.4.2.1: Evidentimi dhe trajtimi i tatimpaguesve që përfitojnë nga vetëpunësimi fiktiv dhe ndarja artificial e subjekteve; Aktiviteti 2.4.2.2: Hartimi i një plani sektorial për të evidentuar tatimpaguesit me marzhe të vogla në tatim fitim; Aktiviteti 2.4.2.3: Digitalizimi i deklarimit të qirave në sistemin CATS dhe kontrollet për çmimet e aplikuar të qirave.	2024	2025	DPT
Masa 2.4.3 Forcimi i hetimeve kundër mashtrimit tatimor	Aktiviteti 2.4.3.1: Krijimi i një seti të ri kriteresh risku bazuar në të dhënat që sigurohen nga pasqyrat financiare vjetore të dorëzuara nga tatimpaguesit, si dhe shkeljeve të tjera të mundshme të legjislacionit tatimor; Aktiviteti 2.4.3.2: Analiza dhe investigimi i shitjeve fiktive të aksioneve të kompanive aksionere; Aktiviteti 2.4.3.3: Hetimi i skemave të mashtrimit me TVSh-në (Skema karusel); Aktiviteti 2.4.3.4: Analizimi i të dhënave nga palët e treta (Dogana) për evidentimin e skemave të mashtrimit tatimor;	2024	Qershor 2027	DPT

	Aktiviteti 2.4.3.5: Analiza dhe investigimi i sektorëve dhe fenomeneve me risk si informaliteti në paga në sektorët e ndërtimit, industrinë e turizmit, shërbimeve të ndryshme, etj.; Aktiviteti 2.4.3.6: Analiza dhe investigimi i informalitetit në sektorin e fushës së ndërtimit dhe nënkontraktorëve të cilët ofrojnë shërbime dhe aksesore për këtë fushë; Aktiviteti 2.4.3.7: Analiza dhe investigimi i informalitetit në sektorin e fushës së operatorëve të turizmit; Aktiviteti 2.4.3.8: Analiza dhe investigimi i informalitetit në sektorin e fushës së shitjeve dhe blerjeve <i>online</i>; Aktiviteti 2.4.3.9: Analiza dhe investigimi i informalitetit në sektorin e fushës së subjekteve që ofrojnë shërbime konsulence, shërbime IT, shërbime inxhinierie dhe të tjera në teknologjinë e informacionit; Aktiviteti 2.4.3.10: Analiza dhe investigimi i informalitetit në sektorin e fushës farmaceutikës dhe kozmetikës; Aktiviteti 2.4.3.11: Analiza dhe investigimi i informacioneve të siguruar nga palë të treta si, qytetarë, media, institucione të tjera shtetërore dhe private; Aktiviteti 2.4.3.12: Analiza dhe investigimi i informacioneve të siguruar nga institucione të tjera me trajtim të rasteve që kanë të bëjnë me pastrimin e parave, transaksionet e dyshimta, etj.			
--	---	--	--	--

Treguesit e performancës dhe vlerat e synuara

Treguesi	Vlera bazë (viti 2023)	Vlera e synuar			
		2024	2025	2026	2027
Rritja e të ardhurave nga tatimi mbi fitimin me 0.7% e PBB-së brenda 2027	Të ardhurat nga TF 2.4% e PBB-së	0.22% e PBB-së	0.24% e PBB-së	0.12% e PBB-së	0.12% e PBB-së
Rritja e të ardhurave nga tatimi mbi qiranë me 0.16% të PBB-së, brenda 2027	Të ardhurat nga tatimi mbi qiranë, 0.21% e PBB-së	0.02% e PBB-së ose 15% rritje e të ardhurave nga tatimi mbi qiratë	0.04% e PBB-së ose 20% ardhurave nga tatimi mbi qiratë	0.05% e PBB-së ose 20% rritje e të ardhurave nga tatimi mbi qiratë	0.05% e PBB-së ose 20% rritje e të ardhurave nga tatimi mbi qiratë
Staf i trajnuar mbi investigimet e shmangieje tatimore		12 inspektorë të trajnuar			12 inspektorë të trajnuar
Plan veprimi për rastet e ndarjes artificiale të bizneseve	Nuk ka		Plani i veprimit është miratuar		
Numri i hetimeve tatimore të kryera nga administrata tatimore ⁷	193	50	150	150	150

Gjithashtu, nga masat e marra nën këtë komponent vlerësohet të arrihet rritje në të ardhurat tatimore nga masat që do të merren nga plani i veprimit, por efekti statistikor në të ardhura nuk mund të vlerësohet.

Masa 2.4.1 Rregulli i përgjithshëm antiabuzim (GAAR) zbatohet në mënyrë efektive dhe të veprorë si frenues për organizimet artificiale tatimore

Me ligjin e tatimit mbi të ardhurat dhe në ligjin e procedurave tatimore ka përcaktime të rëndësishme ligjore, lidhur me rregullin e përgjithshëm antiabuzim. Zbatimi i drejtë i këtyre dispozitave kërkon së pari një staf të trajnuar. Për këtë arsye, një theks i rëndësishëm në këtë masë është trajnimi i 12 inspektorëve vetëm për rastet e shmangieje tatimore, për të cilin është përcaktuar Aktiviteti 2.4.1.1: Trajnime për stafin e administratës tatimore mbi rregullat dhe kontrollet për antishmangien tatimore.

Masa 2.4.2 Hartimi i masave antievazion për të luftuar organizimet artificiale më të përhapura si të vetëpunësuarit fiktiv dhe ndarja artificiale e subjekteve

Me qëllim lehtësimin e barrës tatimore të bizneseve të vogla dhe të mesme, që të rriten dhe zgjerohen, kemi aplikuar prej vitesh një politikë përjashtimi nga tatimi të ardhurat individuale të personave fizikë të kategorizuar si biznese të vogla. Bazuar në politikën fiskale të përjashtimit nga tatimi i bizneseve me të ardhura deri në 14 milionë lekë, rezulton se 90% e bizneseve janë të përjashtuar nga tatimi. Mbi pragun prej 14 milionë lekë, aplikohet norma 15% e tatimit.

⁷ Ky është një kusht në Planin e Rritjes për të kryer 500 hetime ndaj tatimpaguesve, brenda 2027.

Megjithatë, ky progresivitet i tatimit mbi të ardhurat në disa momente ka krijuar një incentivë të gabuar, në lidhje me favorizimin e trajtimit të të vetëpunësuarve jashtë skemës së tatimit mbi të ardhurat personale nga puna ose ndarje artificiale të subjekteve.

Pragu i skemës së progresivitetit nxit shmangie të tatimeve që tatimpaguesit të qëndrojnë poshtë këtij pragu dhe për rrjedhojë t'i shmangen tatimeve. Ose ka raste kur bizneset që arrijnë prapun me qarkullim mbi 14 milionë lekë, copëzohen me qëllim që të shmangin tatimet.

Për të adresuar këto fenomene, gjatë kohës së kësaj Strategjie, administrata tatimore do të jetë e fokusuar në:

- Aktivitetin 2.4.2.1: Evidentimi dhe trajtimi i tatimpaguesve që përfitojnë nga vetëpunësimi fiktiv dhe ndarja artificiale e subjekteve;
- Aktivitetin 2.4.2.2: Hartimi i një plani sektorial për të evidentuar tatimpaguesit me marzhe të vogla në tatim fitim;
- Aktivitetin 2.4.2.3: Digjitalizimi i deklarimit të qirave në sistemin CATS dhe kontrollet për çmimet e aplikuarra të qirave.

Masa 2.4.3 Forcimi i hetimeve kundër mashtrimit tatimor

Në kuadër të planit të rritjes janë parashikuar të kryhen 500 hetime ndaj tatimpaguesve, brenda qershorit 2027. Realizimi i këtij indikator do të bazohet në fenomenet, sektorët dhe llojet e taksave të përcaktuar në një listë prej 12 aktiviteteve, si më poshtë vijon.

1. Aktiviteti 2.4.3.1: Krijimi i një seti të ri kriteresh risku bazuar në të dhënat që sigurohen nga pasqyrat financiare vjetore të dorëzuara nga tatimpaguesit, si dhe shkeljeve të tjera të mundshme të legjislacionit tatimor;

2. Aktiviteti 2.4.3.2: Analiza dhe investigimi i shitjeve fiktive të aksioneve të kompanive aksionere;

3. Aktiviteti 2.4.3.3: Hetimi i skemave të mashtrimit me TVSh-në (Skema *karusel*);

4. Aktiviteti 2.4.3.4: Analizimi i të dhënave nga palët e treta (Dogana) për evidentimin e skemave të mashtrimit tatimor;

5. Aktiviteti 2.4.3.5: Analiza dhe investigimi i sektorëve dhe fenomeneve me risk si informaliteti në paga në sektorët e ndërtimit, industrinë e turizmit, shërbimeve të ndryshme, etj.;

6. Aktiviteti 2.4.3.6: Analiza dhe investigimi i informalitetit në sektorin e fushës së ndërtimit dhe nënkontraktorëve të cilët ofrojnë shërbime dhe aksesore për këtë fushë;

7. Aktiviteti 2.4.3.7: Analiza dhe investigimi i informalitetit në sektorin e fushës së operatorëve të turizmit;

8. Aktiviteti 2.4.3.8: Analiza dhe investigimi i informalitetit në sektorin e fushës së shitjeve dhe blerjeve *online*;

9. Aktiviteti 2.4.3.9: Analiza dhe investigimi i informalitetit në sektorin e fushës së subjekteve që ofrojnë shërbime konsulence, shërbime IT, shërbime inxhinierie dhe të tjera të teknologjisë së informacionit;

10. Aktiviteti 2.4.3.10: Analiza dhe investigimi i informalitetit në sektorin e fushës farmaceutikës dhe kozmetikës.

11. Aktiviteti 2.4.3.11: Analiza dhe investigimi i informacioneve të siguruarra nga palë të treta si, qytetare, media, institucione të tjera shtetërore dhe private;

12. Aktiviteti 2.4.3.12: Analiza dhe investigimi i informacioneve të siguruarra nga institucione të tjera me trajtim të rasteve që kanë të bëjnë me pastrimin e parave, transaksionet e dyshimta etj.

V.5 Komponenti 2.5 Reduktimi i punës së padeklaruar dhe nëndeklarimit të pagës reale

Objektivi

Synimi në lidhje me komponentin 2.2 konsiston në rritjen në skemën e kontributeve me 5.5% të punonjësve (pozicioneve të punës) dhe rritjen e deklarimit të pagës reale të 16% të punësuarve. Në saj

të masave që do të ndërmerren nën këtë komponent, synohet që të rriten të ardhurat nga tatimi mbi pagën dhe kontributet, me 0.18% të PPB-së ose 4.9 miliardë lekë, për një periudhë 4-vjecare.

Konteksti

Punësimi informal i punonjësve përfshin 4 komponentë: mosregjistrim i punonjësve, mosdeklarim i saktë i pagës, mosdeklarim i saktë i kohës së punës dhe mosdeklarim i saktë i kategorisë së punësimit ose profesionit. Në saj të zhvillimit ekonomik të vendit dhe punës së administratës tatimore, gjatë periudhës 2019–2023, numri i pozicioneve të punës është rritur me 33,343 ose 5%, ndërsa të ardhurat nga kontributet janë rritur me 45 miliardë lekë ose 47%. Ndikim në normën e lartë të rritjes së kontributeve kanë ndikuar reformat e pagave në administratën publike pra rritja e pagave ndjekur edhe nga sektori privat. Të dhënat e deri tanishme tregojnë për rritje të konsiderueshme ndër vite të numrit të pozicioneve të punës paraqitet si më poshtë:

Tabela 16: Numri i pozicioneve të punës, 2019-2023

Vitet	2019	2020	2021	2022	2023
Numri i pozicioneve të punës	699,801	686,271	701,736	719,696	733,144

Ecuria e të ardhurave nga kontributet paraqitet si më poshtë:

Tabela 17: Të ardhurat nga kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, që mbledhen nga AT, 2019–2023

Në % të PBB-së

Viti	2019	2020	2021	2022	2023
Të ardhurat ndër vite nga kontributet	5.57%	5.71%	5.73%	5.54%	6.02%

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve

Punësimi informal nënraportimi

Në kuadër të luftës kundër informalitetit në tregun e punës, AT-ja monitoron problematikën e pagës mesatare në nivel drejtorie rajonale. Rritja e deklarimit të pagës reale është prioritet i administratës tatimore e cila është e angazhuar maksimalisht për evidentimin e çdo mosregjistrimi apo nëndeklarimi.

Gjatë vitit 2023, administrata tatimore ka pasur një fokus të shtuar tek elementet e pagës, duke evidentuar çdo detyrim në kontributet sociale dhe shëndetësore, dhe duke gjurmuar e hetuar skemat e mundshme të ngritura nga këto subjekte për mospagesë të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore. Periodikisht, në mënyrë mujore evidentohen tatimpaguesit të cilët nuk deklarojnë, deklarojnë me zero ose ndryshojnë deklaratat e mëparshme me ulje.

Në kuadër të kësaj strategjie, nën këtë komponent janë parashikuar 7 masa që do ndërmerren për të adresuar fenomenin. Ndërmarrja e këtyre masave pritet të sjellë një rritje të të ardhurave tatimore me 4.9 miliardë lekë për tatimin mbi të ardhurat personale dhe kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.

Tabela 17: Të ardhurat shitesë nga komponenti 2.2 sipas zërave të taksave

Në milionë lekë					
Të ardhurat nga komponenti 2.2	2024	2025	2026	2027	Totali 2024–2027
Tatimi mbi pagën	82	273	382	491	1,229
Kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore	390	907	1,088	1,322	3,708
Totali	472	1,180	1,470	1,814	4,936
në % të PPB-së					
Tatimi mbi pagën	0.003%	0.01%	0.01%	0.02%	0.05%
Kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore	0.02%	0.04%	0.04%	0.05%	0.14%
Totali	0.02%	0.05%	0.05%	0.06%	0.18%

Prioritetet:

Prioritetet për periudhën 2024–2027 janë:

1. Rritja me 0.18% e PPB-së së të ardhurave nga tatimi mbi pagën dhe kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore;
2. Rritja e deklarimit të pagës reale të 16 % të punësuarve;
3. Përfshirja në skemën e kontribuesve me 5.5 % pozicione të rinj pune;
4. Hartimi i planit sektorial për identifikimin e punës së padeklaruar dhe nëndeklaruar.
5. Zhvillimi i një fushate të gjerë ndërgjegjësimi mbi përfitimet e punës së deklaruar.

Masat dhe aktivitetet

Masa	Aktivitetet	Fillimi	Mbarimi	Institucioni përgjegjës
Masa 2.5.1: Hartimi i një plani të integruar në drejtim të mosdeklarimit të punonjësve	Aktiviteti 2.5.1.1: Hartimi i një Plani Sektorial për identifikimin e punës së padeklaruar.	2025	2027	DPT/Inspektorati i Punës/Shoqatat e biznesit
Masa 2.5.2: Përmirësimi i bashkëpunimit ndërinstitucional për koordinimin e veprimeve në kuadër të identifikimit të punës së padeklaruar ose nëndeklaruar, mbështetur në një strategji të qartë	Aktiviteti 2.5.2.1: Përmirësimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit me Institutin e Sigurimeve Shoqërore dhe Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore lidhur me shkëmbimin e të dhënave Aktiviteti; 2.5.2.1: Hartimi i një Plani Operacional Ndërinstitucional me strukturat AT, ISSH dhe ISHPSHSH	2025	2027	DPT në bashkëpunim me ISHPSHSH dhe ISSH
Masa 2.5.3: Analizimi i kategorive të personave të cilët kanë detyrimin të plotësojnë deklaratën individuale vjetore të të ardhurave	Aktiviteti 2.5.3.1: Analizimi i deklaratave të DIVA-s, brenda vitit 2024.	2024	2024	DPT
Masa 2.5.4: Përmirësimi i analizave dhe shkëmbimit të të dhënave me palë të treta për të punën e padeklaruar ose nëndeklaruar	Aktiviteti 2.5.4.1: Përbushja nëpërmjet Dizajnimit (<i>Compliance by Design</i>). Përcaktimi dhe krijimi i kontrolleve në sistemin e deklarimit të listëpagesave që parandalojnë shmangien e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore; Aktiviteti 2.5.4.2: Krijimi dhe përditësimi i kriterëve të riskut në Modulën e Riskut që kanë të bëjnë me shmangien e pagesës së kontributeve të sigurimeve shoqërore; Aktiviteti 2.5.4.3: Marrja e informacioneve nga planet sektoriale mbi të dhënat dhe analizat e kryera; Aktiviteti 2.5.4.4: Organizimi i kontrolleve bazuar në përfundimet që rezultojnë nga kryqëzimi i të dhënave.	2024	2026	DPT/pala që mirëmban sistemin, në bashkëpunim me AKSHI
Masa 2.5.5 Fushata të ndërgjegjësimit publik lidhur me përfitimet e pagesës së kontributeve	Aktiviteti 2.5.5.1: Hartimi dhe implementimi i fushatës mbi përfitimet e punës së deklaruar.	2025	2027	DPT/ ISSH/ISHPSHSH
Masa 2.5.6: Zhvillimi i partneriteteve me përfaqësuesit e biznesit dhe të komunitetit për identifikimin e informalitetit në punësim	Aktiviteti 2.5.6.1 Takime periodike me grupet e sipërmarrësve për të diskutuar mbi faktorët e informalitetit në punësim.	2025	2027	DPT/ Shoqatat e Biznesit

Treguesit e performancës dhe vlerat e synuara (në përqindje)

Treguesi	Vlera bazë (viti)	Vlera e synuar			
		2024	2025	2026	2027
Rritja me 0.18% e PBB-së së të ardhurave nga tatimi mbi pagën dhe kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore	7.48% e PBB-së në 2023-shin	0.02% të PBB-së	0.05% të PBB-së	0.05% të PBB-së	0.06% të PBB-së
Rritja e deklarimit të pagës reale të 16 % të punësuarve, në fund të 2027-s	20 % e punonjësve me pagë nën kufirin e përjashtimit	2% të punonjësve u rritet deklarimi i pagës	3.4 % të punonjësve u rritet deklarimi i pagës	4.7 % të punonjësve u rritet deklarimi i pagës	4.7 % të punonjësve u rritet deklarimi i pagës
Rritja e numrit në skemën e kontribuesve me 5.5 % të punonjësve, në fund të 2027.	733.144 në vitin 2023	1% të punonjësve të rinj në skemë	1.6% të punonjësve të rinj në skemë	1.3% të punonjësve të rinj në skemë	1.6% të punonjësve të rinj në skemë

Më poshtë është një përshkrim i masave dhe aktiviteteve për realizimin e këtij komponenti.

Masa 2.5.1 Hartimi i një Plani të Integruar në drejtim të mosdeklarimit të punonjësve

Hartimi i tërësisë së masave për adresimin e punës informale do të synojë në rritjen me 5.5 % të numrit të të punësuarve, të cilët do të formalizohen. Kalimi i punonjësve nga ekonomia informale te punësimi formal është i vështirë. Përveç zbulimit dhe sanksioneve, do të ndiqen qasje politikash të integruara, AT-ja do të hartojë një Plan Sektorial për të adresuar këtë problematikë.

- Aktiviteti 2.5.1.1: Hartimi i një Plani Sektorial për identifikimin e punës së padeklaruar.

Masa 2.5.2 Përmirësimi i bashkëpunimit ndërinstitucional për koordinimin e veprimeve, në kuadër të identifikimit të punës së padeklaruar ose nëndeklaruar, mbështetur në një strategji të qartë

Institucione përgjegjëse për trajtimin e informalitetit në punë janë: Administrata Tatimore (AT) në lidhje me tatimet dhe taksat, Instituti i Sigurimeve Shoqërore, në lidhje me kontributet shoqërore dhe Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHSH), në lidhje me respektimin e Kodit të Punës. AT-ja ka pasur një koordinim më të mirë ndërinstitucional në nivel operacional me këto institucione. Megjithatë, ekziston nevoja për të përmirësuar modelet e bashkëpunimit duke avancuar në shkëmbime të dhënash më të detajuara, si dhe një planifikim operacional më të organizuar (në vend të kontrolleve sporadike), bazuar në një qasje tërësore dhe të integruar.

- Aktiviteti 2.5.2.1: Përmirësimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit me Institutin e Sigurimeve Shoqërore dhe Inspektoratin Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, lidhur me shkëmbimin e të dhënave.

Rishikimi i marrëveshjeve aktuale të bashkëpunimit dhe ndërtimi i formave të komunikimit nëpërmjet sistemeve dhe *web-servis*-eve për shkëmbimin e të dhënave ndërmjet palëve.

- Aktiviteti 2.5.2.2: Hartimi i një Plan Operacional Ndërinstitucional për bashkëpunimin dhe kontrollet mes AT-së, ISSH-së dhe ISHPSSH-së.

Bashkëpunimi mes Administratës Tatimore, ISSH-së dhe Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore do të fokusohet jo vetëm për kontrollet e përbashkëta për punësimet në të zezë, por edhe për nëndeklarimet e pagës reale, sidomos të punonjësit të cilët punojnë me turne dhe për të cilat aplikohet një shtesë page mbi pagën bazë.

Masa 2.5.3 Analizimi i kategorive të personave të cilët kanë detyrimin të plotësojnë deklaratën individuale vjetore të të ardhurave

Në ndryshimet ligjore të ndërmarra gjatë vitit 2019 dhe 2023, pjesë e kategorisë së individëve të cilët kishin detyrimin për plotësimin e Deklaratës Individuale Vjetore të të Ardhurave (DIVA) u bë edhe kategoria e individëve të punësuar në më shumë se një punëmarrës. Ky ndryshim ligjor ndikoi në rritjen e numrit të deklaratave të plotësuara nga 13,553 deklarata që rezultojnë gjatë vitit 2019, në rreth 73.000 deklarata të pritshme për t'u dorëzuar në vitin 2023. Në vitet pasuese bazuar në ligjin e ri "Për tatimin mbi të ardhurat" pritet një zgjerim të individëve të cilët do duhet të plotësojnë DIVA-n, pasi kufiri ndryshon nga 2 milionë lekë në 1.2 milionë lekë, si dhe do të ndërmerren hapa të mëtejshëm për ndërgjegjësimin e tatimpaguesve në lidhje me plotësimin e kësaj deklarate.

- Aktiviteti 2.5.3.1: Kryerja e analizave nga deklarata e DIVA-s brenda vitit 2024.

Kjo masë është kusht i Planit të Rritjes. Komisioni i Riskut të administratës tatimore në datën 29.4.2024, me vendimin nr. 18, ka miratuar propozimet nga Drejtoria e Kontrollit të Specializuar e cila është drejtoria kryesore e përfshirë në këtë proces:

a) Plani i përmbytjes së individëve me të ardhura të larta 2022 – Auditimi i 100 individëve me të ardhura të larta;

b) Plani i Veprimit për Individët DIVA 2023.

Bazuar në Planin e Veprimit të DIVA-s individët 2023, janë identifikuar 6708 individë të mospërrputshmërisë për DIVA 2023 dhe për ta janë dhënë sanksione sipas ligjit për procedurat tatimore si: bllokimi i llogarive bankare. Për shkak të këtyre masave janë paguar rreth 15 milionë lekë. Ka nisur puna për DIVA 2024, në të cilin ndryshimi i madh është pragu i poshtëm me 1,2 milionë lekë për deklarimin DIVA.

Masa 2.5.4 Përmirësimi i analizave dhe shkëmbimit të të dhënave me palë të treta për të evidentuar punonjësit e paregjistruar dhe nëndeklarimin e pagës reale

DPT-ja do të ketë fokus të veçantë identifikimin e punonjësve jashtë listëpagesave të deklaruara në sistem. Administrata Tatimore do të identifikojë grupimet më të larta të punës së mundshme informale

midis statistikave të fuqisë punëtore, që tregojnë aktivitetin e vërtetë ekonomik dhe numrin e punëtorëve. Përputhja sistematike e të dhënave me palët e treta, Instituti i Sigurimeve Shoqërore (ISSH) dhe Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHSH) është, gjithashtu, e nevojshme për të pasur efektivitet në identifikimin e tatimpaguesve të peregjistruar. Grupimi i madh i të ardhurave të deklaruar në ose nën pagën minimale, gjithashtu, do të jetë pjesë e auditeve dhe do të hetohen duke përdorur teknika analitike.

Në këtë drejtim, DPT-ja do të ndërmarrë hapat e mëposhtëm:

- Aktiviteti 2.5.4.1: Përbushja nëpërmjet dizenjimit (*Compliance by Design*). Përcaktimi dhe krijimi i kontrolleve në sistemin e deklarimit të listëpagesave që parandalojnë shmangien e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësor;

- Aktiviteti 2.5.4.2: Krijimi dhe përditësimi i kriterëve të riskut në Modulën e Riskut që kanë të bëjnë me shmangien e pagesës së kontributeve të sigurimeve shoqërore;

- Aktiviteti 2.5.4.3: Marrja e informacioneve nga planet sektoriale mbi të dhënat dhe analizat e kryera;

- Aktiviteti 2.5.4.4: Organizimi i kontrolleve bazuar në përfundimet që rezultojnë nga kryqëzimi i të dhënave.

Masa 2.5.5 Fushata të ndërgjegjësimit publik, lidhur me përfitimet e pagesës së kontributeve

Përpos tërësisë së masave të mësipërme, do të organizohet një fushatë e gjerë kombëtare sensibilizuese mbi punësimin formal. Synimi i fushatës është që gradualisht do të ndihmojë në ndryshimin e vlerave, normave dhe besimeve në lidhje me përfitimet. Zhvillimi i një fushate të gjerë ndërgjegjësimi, duke garantuar konfidencialitetin e të dhënave të individit, dhe rritjen e ndërgjegjësimit se raportimi i punës së pa deklaruar dhe nëndeclarimet e pagës, janë një përfitim jo vetëm për shtetin por mbi të gjitha për individin. Gjithashtu, elemente të kësaj fushate do të jenë:

- Edukimi i tatimpaguesve në lidhje me rreziqet jotatimore të nëndeclarimit të të ardhurave, si për shembull: pakësimi i pagesës së kontributeve të sigurimeve, qasje të kufizuar në kredi dhe aftësi e kufizuar për të shitur një biznes në të ardhmen;

- Marrja e informacionit të detajuar nga tatimpaguesit, me qëllim rritjen e aftësive për të zbuluar dhe trajtuar aktivitetet e ekonomisë informale. Kjo ka për qëllim rritjen e besimit të komunitetit në efektivitetin e administratës duke demonstruar se shmangësit e tatimeve janë vënë para përgjegjësisë dhe do shërbejë si një pengesë e rëndësishme për të tjerët që mund të mendojnë të angazhohen në mosrespektimin e ligjit;

- Publikimi i masave/veprimeve kundër evazionit. Raportimi i rezultateve të arritura duke përfshirë ndjekjet penale të suksesshme që rrjedhin nga këto aktivitete.

Në mënyrë të përmbledhur, aktiviteti do të jetë.

- Aktiviteti 2.5.5.1: Hartimi i Planit të informimit dhe përcaktimi i elementeve të fushatës mbi përfitimet e punës së deklaruar.

Masa 2.5.6 Zhvillimi i partneriteteve me përfaqësuesit e biznesit dhe të komunitetit për identifikimin e informalitetin në punësim

Në këtë drejtim, DPT-ja do të zhvillojë takime periodike me grupet e interesit dhe kategori të ndryshme biznesi që janë identifikuar si problematike, në kuadër të trajtimit të punës së padeklaruar, për të diskutuar dhe për t'i dhënë zgjidhje punës së padeklaruar dhe konkurrencës së padrejtë, sipas specifikave të bizneseve.

- Aktiviteti 2.5.6.1: Takime periodike me grupet e biznesit për të diskutuar mbi faktorët e informalitetit në punësim

V.6 Komponenti 2.6 Reduktimi i kostove të pajtueshmërisë dhe rritja e besimit tek administrata tatimore

Objektivi

Objektivi kryesor i këtij komponenti konsiston në uljen e kostove të pajtueshmërisë dhe rritjen e cilësisë së shërbimit së administratës tatimore dhe besimit të komunitetit dhe zbatimi i kushteve të përcaktuara në Planin e Rritjes.

Konteksti

Sikurse është evidentuar në sesionet e mësipërme të kësaj strategjie, progres i dukshëm është arritur në uljen e kostove dhe lehtësimin e pajtueshmërisë vullnetare për tatimpaguesit. Një ekuilibër i duhur midis ofrimit të shërbimit, uljes së kostove dhe lehtësi për pajtueshmërinë vullnetare nga njëra anë dhe zbatimit të masave ndëshkuese ndaj kategorive mospërbushëse nga ana e administratës tatimore është thelbësor për përmirësimin e klimës, konkurrueshmërisë dhe barazisë në të bërit biznes. Për këtë arsye, në këtë Strategji janë parashikuar prioritetet dhe masat, si më poshtë.

Prioritetet:

Prioritetet për periudhën 2024–2027 janë:

- Zbatimi plotësisht i kushteve sipas Planit të Rritjes:

a) 100% e deklaratave individuale të të ardhurave personale do të parambushen brenda dhjetorit 2026;

b) Hartimi dhe miratimi i Planit të Integritetit të administratës tatimore brenda 2025-s.

- Hartimi dhe miratimi i Strategjisë së Shërbimit të tatimpaguesve.

Masat dhe aktivitetet

Masa	Aktivitetet	Fillimi	Mbarimi	Institucioni përgjegjës
Masa 2.6.1 Hartimi dhe miratimi i strategjisë për shërbimin e tatimpaguesve	Aktiviteti 2.6.1.1: Përmirësimi i udhëzuesve shpjegues për subjektet tatimpaguese dhe konsulentët e tyre; Aktiviteti 2.6.1.2: Përmirësimi i proceseve tatimore nëpërmjet ndërveprimit dhe komunikimit të rregullt dhe në kohë me tatimpaguesit dhe konsulentët e tyre.	2024	2025	DPT në bashkëpunim me administratën tatimore suedeze (SIDA)
Masa 2.6.2 Ulja e kohës mesatare të rimbursimit të TVSh-së	Aktiviteti 2.6.2.2 Finalizimi i modulit të automatizimit të pagesës së shumës së miratuar për rimbursim nëpërmjet realizimit të lidhjes automatike ndërmjet sistemit C@ts të Tatimeve dhe sistemit AFMS të Thesarit.	2025	2026	DPT/ MF/Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit
Masa 2.6.3 Digitalizimi i proceseve të punës	Aktiviteti 2.6.3.1: Publikimi i shërbimit <i>UserTest</i> në <i>web. tatime.gov.al</i> , për informimin e individëve në lidhje me detyrimin për deklaram të DIVA; Aktiviteti 2.6.3.2: Implementimi i deklaratave të reja të Tatimit në Burim dhe DIVA dhe paraplotësimi i deklaratave; Aktiviteti 2.6.3.3: Implementimi i deklaratave të reja, në zbatim të ligjit të ri “Për tatimin mbi të ardhurat”; Aktiviteti 2.6.3.4: Digitalizimi i deklarimit të të dhënave pronësi/qira të ambienteve të ushtrimit të aktivitetit nga ana e tatimpaguesve; Aktiviteti 2.6.3.5: Vendosja e rregullave të reja në plotësimin e deklaratave (<i>Compliance by Design</i>); Aktiviteti 2.6.3.6: Përmirësim i procedurave të mbledhjes së Borxhit, finalizimi i projektit “Digitalizimi i komunikimit me Bankat për bllokimin/zhblokimin e llogarive bankare”.	2024	2026	DPT/AKSHI
Masa 2.6.4 Ngritja e një kuadri më të strukturuar për sigurimin e pacenueshmërisë së vlerave dhe integritetit të AT-së	Aktiviteti 2.6.4.1: Hartimi dhe zbatimi i Planit të Integritetit për Administratën Tatimore;	2024	2025	DPT
	Aktiviteti 2.6.4.2: Zbatimi i një programi të dedikuar për antikorrupsionin.	2024	2026	
Masa 2.6.5 Dizajnimi i proceseve të punës dhe shërbimeve në ndërveprim me tatimpaguesit dhe konsulentët e tyre	Aktiviteti 2.6.5.1: Krijimi i një Forum Këshillimor pranë DPT-së me ekspertë fiskalë, kontabilitetë dhe përfaqësues të shoqatave profesionale për dizajnimin e proceseve dhe shërbimeve tatimore.	2025	2026	DPT/MF

Treguesit e performancës dhe vlerat e synuara

Treguesi	Vlera bazë (viti 2023)	Vlera e synuar			
		2024	2025	2026	2027
Rritja e cilësisë së shërbimit të tatimpaguesve	49% e bizneseve konstatojnë përmirësim në komunikimin me AT-në. 72% e bizneseve kanë qartësi mbi informacionin tatimor.				60% e bizneseve konstatojnë përmirësim në komunikimin me AT-në 90% e bizneseve kanë qartësi mbi informacionin tatimor (do të ndryshohen indikatorët sipas vlerave bazë)
Implementimi i deklaratave të reja të Tatimit në Burim dhe paraplotësimi i deklaratës DIVA	73,000 deklarata			100%	
Ulja e kohës mesatare të rimbursimit të TVSh-së	Afati mesatar 35 ditë				Afati mesatar brenda 25 ditëve
Krijimi i një Forumi këshillues tek DPT me ekspertët kontabël, kontabistët e shoqatat e biznesit.			Qershor 2025		Krijohet
Hartimi i Planit të integritetit të Administratës tatimore			Qershor 2025		

Më poshtë është një përshkrim i masave dhe aktiviteteve për realizimin e këtij komponenti.

Masa 2.6.1 Hartimi i një strategjie për shërbimin e tatimpaguesve

Përmirësime pozitive janë bërë ndër vite nga administrata tatimore për digjitalizimin e shërbimeve dhe rritjen e rolit këshillues të saj. Shërbimi për tatimpaguesit, si prioritet i rëndësishëm, është pjesë e Strategjisë së përgjithshme të Administratës Tatimore.

Brenda vitit 2025, nën asistencën dhe partneritetin e Administratës Tatimore Suedeze do të hartohet Strategjia për Shërbimin e Tatimpaguesit. Strategjia do të përshkruajë vizionin e shërbimeve që AT-ja do të sigurojë për tatimpaguesit dhe konsulentët e tyre. Për të adresuar këtë rekomandim, AT-ja do të punojë drejt përmirësimit të udhëzimeve interpretuese për taksapaguesit dhe konsulentët e tyre, si dhe përmirësimin e shërbimeve dhe proceseve tatimore nëpërmjet ndërveprimit të rregullt me përdoruesit e shërbimeve të administratës tatimore.

- Aktiviteti 2.6.1.1: Përmirësimi i udhëzuesve shpjegues për subjektet tatimpaguese dhe konsulentët e tyre.

- Aktiviteti 2.2.6.2: Përmirësimi i shërbimeve dhe proceseve tatimore nëpërmjet ndërveprimit dhe komunikimit të rregullt dhe në kohë me përdoruesit e shërbimeve të administratës tatimore.

Masa 2.6.2 Ulja e kohës mesatare të rimbursimit të TVSh-së

- Aktiviteti 2.6.2.1: Automatizimi i pagesës së shumës së miratuar për rimbursim nëpërmjet realizimit të lidhjes automatike ndërmjet dy sistemeve, sistemit C@ts të Tatimeve dhe sistemit *Afimis* të Thesarit.

Masa 2.6.3 Digjitalizimi i proceseve të punës

- Aktiviteti 2.6.3.1: Publikimi i shërbimit *UserTest* në *web*: *tatime.gov.al*, për informimin e individëve në lidhje me detyrimin për deklaram te DIVA.

- Aktiviteti 2.6.3.2: Implementimi i deklaratave të reja të Tatimit në Burim dhe DIVA dhe paraplotësimi i deklaratave.

- Aktiviteti 2.6.3.3: Implementimi i deklaratave të reja, në zbatim të ligjit të ri “Për tatimin mbi të ardhurat”.

- Aktiviteti 2.6.3.4: Digjitalizimi i deklaramit të të dhënave pronësi/qira të ambienteve të ushtrimit të aktivitetit nga ana e tatimpaguesve.

- Aktiviteti 2.6.3.5: Vendosja e rregullave në plotësimin e deklaratave (*Compliance by Design*).

- Aktiviteti 2.6.3.6: Përmirësim i procedurave të mbledhjes së borxhit, finalizimi i projektit “Digjitalizimi i komunikimit me bankat për bllokimin/zhblokimin e llogarive bankare”.

Aktiviteti për zbatimin e deklaratave të reja të tatimit në burim dhe DIVA dhe plotësimi paraprak i deklaratave është kusht i Planit të Rritjes që do të përmbyllet brenda vitit 2026.

Kjo lidhet edhe me zbatimin e ligjit të ri për të ardhurat.

Administrata tatimore ka një kontratë me zhvilluesin 'Për përmirësimin e sistemit C@TS' është lidhur në 2 gusht 2024 dhe zgjat një vit. Kjo kontratë përfshin zbatimin e ligjit të ri dhe përmirësimin e sistemit C@TS.

Sipas planit të punës të rënë dakord me zhvilluesin, duhet të realizohen sa vijon:

- Zbatimi i 5 deklaratave të reja (lista e pagesës, deklarata e tatimit në burim, pasqyra e tatimit mbi fitimin e korporatës, pasqyra e tatimit mbi të ardhurat e biznesit personal, pasqyrat individuale), e cila përfshin analiza, zhvillim, testim, zbatim;

- Ndryshime në Modulin e Regjistrimit (shtimi i responsiveve të reja, formularët e regjistrimit ose ndryshime të të dhënave nga *e-albania*, C@TS, rregullat e regjistrimit, kombinimi i sfungjerëve, procedurat automatike të regjistrimit/regjistrimit, kodet e të ardhurave;

- Analiza dhe përditësimi i raporteve ekzistuese në C@TS, për të dhënat e deklaratave, detyrimit tatimor, historikut të punësimit, kryqëzimit të faturave nga fiskalizimi etj., si dhe raporteve të reja të regjistrimit, riskut etj.;

- Analiza e Modullit të Shkaqeve dhe përditësimi për çështjen e regjistrimit, kontrollit, rimbursimit, nënshkrimit digjital të vizitës së tatimpaguesit, etj.

Masa 2.6.4 Ngritja e një kuadri më të strukturuar për sigurimin e pacenueshmërisë së vlerave (integritetit)

Administrata tatimore do të fokusohet në zhvillimin e një kornizë më gjithëpërfshirëse të sigurimit të integritetit që përcakton, komunikon dhe promovon standardet e sjelljes; monitoron dhe zbaton ato standarde, korrigjon gabimet, vlerëson dhe raporton mbi rezultatet e punës së çdo inspektori.

- Aktiviteti 2.6.4.1: Hartimi dhe zbatimi i Planit të Integritetit për Administratën Tatimore

Ky është një kusht i Planit të Rritjes që duhet të plotësohet brenda qershorit 2025. Puna ka nisur nga administrata tatimore. Administrata Tatimore ka përfunduar draftin e Planit të Integritetit dhe është në diskutime me aktorët kryesorë. Ky draftplan është rezultat i një procesi vlerësimi të gjatë dhe të detajuar, i cili ka nisur në nëntor 2023 dhe ka përfunduar në tetor 2024. Ky plan integriteti është hartuar në kuadër të projektit "Forcimi i integritetit për përmirësimin e shërbimeve publike", i zbatuar nga Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim, me mbështetjen financiare të Ambasadës Suedeze në Tiranë, e cila bashkëpunoi ngushtë me grupin e punës të ngritur nga drejtori i përgjithshëm dhe stafin kyç të DPT-së. Procesi përfshin identifikimin dhe analizimin e rreziqeve të integritetit, si dhe diskutimin e sjelljeve joetike dhe joprofesionale që mund të shfaqen brenda institucionit.

- Aktiviteti 2.6.4.2: Zbatimi i një programi të dedikuar për antikorrupsionin. Kryerja e trajnimeve dhe njohja e punonjësve të administratës tatimore mbi mënyrat e sjelljes (Kodi i Etikës), ligjin për Bilbilfryrësit dhe ligjin për konfliktin e interesit.

Masa 2.6.5 Procese dhe shërbime tatimore në ndërveprim të rregullt me përdoruesit e shërbimeve të DPT-së

Ndërsa AT-ja angazhohet herë pas herë me tatimpaguesit dhe ekspertët fiskalë apo kontabilistët, nuk ka një forum të rregullt me këta aktorë. Këshilli Tatimor është forum, i cili përfshin AT-në dhe përfaqësues të komunitetit të biznesit, por ky Këshill është i fokusuar të ofrojë konsultime dhe këshillime për Ministrinë e Financave për sa lidhet me çështjet e dispozitave ligjore dhe nënligjore të politikave fiskale.

Përfshirja në diskutime dhe angazhimi i tatimpaguesve, kontabilistëve dhe ekspertëve fiskalë në hartimin e akteve ligjore dhe nënligjore tatimore, formularëve, procedurave dhe sistemeve të deklarimit, do të ndihmojë në thjeshtimin e sistemit tatimor dhe uljen e kostove të pajtueshmërisë së detyrimeve tatimore.

- Aktiviteti 2.6.5.1: Krijimi i një Forumi Këshillimor pranë AT-së me ekspertë fiskalë, kontabilistë dhe përfaqësues të shoqatave profesionale për dizënjimin e proceseve dhe produkteve tatimore.

V.6 Komponenti 2.7 Përmirësimi i cilësisë së shërbimit të ofruar nga administratës tatimore nëpërmjet zhvillimit të kapaciteteve institucionale

Objektivi

Objektivi është rritja e efikasitetit të administratës bazuar në parimet e një Administrate Tatimore Efektive dhe rritja e bashkëpunimit me palët e treta.

Konteksti

Forcimi dhe modernizimi i agjencive të administrimit të të ardhurave është thelbësor për mbledhjen efektive të të ardhurave. Ndërkohë që përfshirja e masave të reja të politikës së të ardhurave mund çojë në rritje të tyre, pjesa më e madhe varet nga efikasiteti i administratës bazuar në parimet e një Administrate Tatimore Efektive.

Janë ndërmarrë disa hapa të rëndësishëm për të përmirësuar efektivitetin e AT-së vitet e fundit.

Prej viti 2015, deklarimi elektronik është forma e vetme e deklarimit të çdo deklarate tatimore, për çdo përgjegjësi dhe për çdo tatimpagues.

Prej vitit 2017, Administrata Tatimore ka vijuar me ofrimin e shërbimeve *online* për tatimpaguesit dhe individët, ku aktualisht 95% e kërkesave trajtohen elektronikisht nëpërmjet portalit *e-albania*. Aktualisht AT-ja është në fazën e zhvillimeve për automatizimin dhe digjitalizimin e disa proceseve, gjithashtu, pritjet të shtohen edhe 10 shërbime të reja *online*. Tashmë, AT-ja ka një sistem modern të IT-së, bashkëveprimi elektronik me taksapaguesit është procedurë normale duke përfshirë regjistrimin elektronik të deklaratave tatimore. Struktura e AT-së është thjeshtuar, është krijuar një Qendër Kombëtare e Thirrjeve dhe është bërë një progres domethënës në zhvillimin e një qasjeje moderne të menaxhimit të riskut të pajtueshmërisë.

Në partneritet me Institutin e Statistikave dhe Regjistrin Kombëtar të Biznesit, AT-ja ka ndërmarrë, gjithashtu, një rifreskim gjithëpërfshirës të kodeve ekonomike të bizneseve dhe të dhënave të tjera të tatimpaguesve të regjistruara në regjistrin e saj kombëtar të tatimpaguesve. Për më tepër, projekti i Fiskalizimit po i siguron AT-së të dhëna sasiore dhe cilësore në kohë reale.

Faqja e internetit të Administratës Tatimore është konceptuar për të qenë *user-friendly* në funksion të informimit të tatimpaguesve dhe individëve për lehtësimin dhe rritjen e nivelit të përmbushjes së detyrimeve tatimore. Kjo faqe përmban informacion të përditësuar për legjislacionin tatimor në fuqi, kalendarin tatimor, njoftime periodike për ndryshimet ligjore dhe detyrimet apo afatet e deklarimit dhe pagesës, kontaktet dhe kanalet e komunikimit me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve dhe Drejtoritë Rajonale Tatimore etj., si dhe është e ndërtuar dhe orientuar sipas kategorive të tatimpaguesve: Individë, Biznese, OJF & Ente publike.

Gjithashtu, një menu e veçantë për Fiskalizimin ofron informacion të detajuar si për tatimpaguesit ashtu edhe për ofruesit e zgjidhjeve *softwerike*. Në kuadër të zbatimit të ligjit të ri për tatimin mbi të ardhurat, në faqe u krijua një menu e dedikuar me informacion të detajuar për bazën ligjore, si dhe informacione të tjera të nevojshme.

Qendra e Thirrjeve është strukturë, pjesë përbërëse e Drejtorisë së Shërbimit për Tatimpaguesit, e cila pret thirrjet nga tatimpaguesit apo publiku i interesuar, si dhe kryen thirrje dalëse sipas planeve të përbashkëta ta punës me funksionet e tjera të Administratës Tatimore.

Prioritetet:

Prioritetet për periudhën 2024–2027 janë:

- Ngritja e kapaciteteve institucionale në administratën tatimore;
- Fuqizimi i aftësive të Drejtorisë së Menaxhimit të Riskut (DMR);
- Zhvillimi i një administrate tatimore të aftë dhe efektive.

Masat dhe aktivitetet

Masa	Fillimi	Mbarimi	Institucioni përgjegjës
Masa 2.7.1 Fuqizimi i Qendrës së Thirrjeve, si pjesë përbërëse e Strategjisë së Shërbimit për Tatimpaguesit	2024	2026	DPT/Shërbimi i Tatimpaguesve në bashkëpunim me administratën tatimore

			suedeze (SIDA)
Masa 2.7.2 Trajnimi për përdorimin, përpunimin dhe analizimin e të dhënave sasiore që sigurohen nga fiskalizimi dhe për të kryer projekte të veçanta të analizës, duke përfshirë detyrimin për transferimin e aftësive të personeli i DPT-së	2024	2026	DPT, nën asistencën e partnerëve FMN-së
Masa 2.7.3 Shtrirja e analizave të riskut në çdo funksion të administratës tatimore	2024	2027	DPT/Shërbimi i Tatimpaguesve
Masa 2.7.4 Trajnim i stafit të Njësisë së Tatimpaguesve të Mëdhenj, me qëllim rritjen e kapaciteteve për analizën dhe kontrollin e sektorëve specifikë të ekonomisë	2026	2027	DPT në bashkëpunim me Shoqatat e Biznesit
Masa 2.7.5 Memorandume bashkëpunimi me universitetet për të zhvilluar kurse të analizës së të dhënave dhe shkencës së psikologjisë së sjelljes	2026	2027	DPT në bashkëpunim me universitetet
Masa 2.7.6 Bashkëpunim me universitetet, administratat e tjera tatimore dhe shoqatare profesionale për hartimin e programeve që synojnë zgjidhjen e boshllëqeve në aftësi	2024	2027	DPT në partneritet me QTAD/CEF/FMN

Treguesit e performancës dhe vlerat e synuara

Treguesi	Vlera bazë (viti)	Vlera e synuar			
		2024	2025	2026	2027
Përfshirja në Strategjinë e Shërbimit për Tatimpaguesit të Qendrës së Thirrjeve	Nuk ka		Strategjia është miratuar		
Numri i punonjësve të DTM-së të trajnuar				20 punonjës	30 punonjës
Marrëveshje me Universitetin e Tiranës, Fakulteti i Ekonomisë dhe Fakulteti i Sociologjisë				Marrëveshje e lidhur	
Numri i programeve të zbatuara me universitetin				Marrëveshje e lidhur 4 programe	4 programe

VI. Shtylla 3: Mirëadministrimi doganor

VI.1 Hyrje

Objektivi specifik i shtyllës 3 është përmirësimi i shërbimit doganor dhe rritja e të ardhurave doganore me 0.17% e PBB-së ose 4.5 miliardë lekë brenda një periudhe katërvjeçare.

Administrata doganore ndër vite ka bërë progres të konsiderueshëm në procedurat doganore dhe lehtësimin e tregtisë. Aktualisht, administrata doganore mbledh rreth 43% të të gjitha taksave dhe detyrimeve tatimore.

Kodi Doganor Shqiptar është në përputhje me Kodin Doganor të BE-së. Administrata doganore mbështetet nga sistemet *online* dhe përpunimin automatik të të dhënave duke përdorur sistemin e automatizuar të të dhënave doganore (ASYCUDA *World*). Ky sistem përfshin një modul që kategorizon importet sipas nivelit të riskut.

Administrata doganore ka përparuar dukshëm në përmirësimin e performancës së lehtësimit të tregtisë. Në treguesit e lehtësimit të tregtisë, OECD⁸ konstaton se që nga viti 2019, Shqipëria është përmirësuar në fushat e: disponueshmërisë së informacionit, përfshirjes së komunitetit tregtar, procedurat e apelimit, uljes së tarifave, thjeshtimi dhe harmonizimi i dokumenteve, automatizimi, modernizimi i procedurave dhe bashkëpunimi i agjencive kufitare të brendshme dhe të jashtme. Shqipëria ka tejkaluar mesataren e vendeve të OECD-së, lidhur me procedurat e apelimit dhe është në nivelin e vendeve të OECD-së lidhur me nivelin e tarifave. Në vitin 2022, Shqipëria, gjithashtu, i tejkaloi vendet e Ballkanit Perëndimor në tre fusha: disponueshmëria e informacionit, procedurat e apelimit dhe niveli i tarifave.

Megjithatë, janë identifikuar hapësira për përmirësim të mëtejshëm, si për shembull duke rritur numrin e Operatorëve të Autorizuar Ekonomik, dhe futjen e *Single Window* dhe zbatimin e sistemit të ri të kompjuterizuar të tranzitit.

⁸ Raporti i OECD: *Competitiveness and Private Sector Development, Western Balkans Competitiveness Outlook 2024: Albania*.

Administrata doganore përballet me sfida operationale në trajtimin e evazionit fiskal, kontrabandës, menaxhimit të riskut dhe kontrollit, dhe për këtë arsye një theks i rëndësishëm i është vënë vazhdimisht tek investimet në sisteme TI (Teknologjisë së Informacionit).

Në këtë strategji, mirëadministrimi doganor i të ardhurave fokusohet në 9 komponentë që konsistojnë në ngritjen e sistemeve të reja doganore, si dhe adresimin e çështjeve kryesore doganore. Për zbatimin e këtyre komponentëve do të ndërmerren disa masa për përmirësimin e performancës së administrimit doganor gjatë periudhës 4-vjeçare (2024–2027), paraqitur në kutinë më poshtë.

Komponenti 3.1 Modernizimi i proceseve të biznesit, duke përfshirë centralizimin e funksionit të profilizimit të riskut
Synimi i këtij objekti është zhvillimi i sistemeve/moduleve të IT-së dhe kapaciteteve të administratës doganore për të rritur efektivitetin në mbledhjen e të ardhurave doganore.
Masat për vitet 2024–2027:

- Masa 3.1.1 Përmirësimi i përzgjedhjes së kanaleve të riskut;
- Masa 3.1.2 Centralizimi i profileve të riskut për të përfshirë edhe akcizën;
- Masa 3.1.3 Implementimi i lidhjes në kohë reale midis sistemeve ASYCUDA World dhe ASYHUB;
- Masa 3.1.4 Fuqizimi i kapaciteteve të punonjësve të AD-së përmes përmirësimit të praktikave të burimeve njerëzore dhe ofrimit të zhvillimit të kapaciteteve.

Komponenti 3.2 Zhvillimi i aftësive të zgjeruara analitike të të dhënave
Synimi është që brenda vitit 2027, administrata doganore të ketë zhvilluar modele makroekonomike që rrisin aftësitë analitike dhe parashikuese të fenomeneve ekonomike.
Masat për vitet 2024–2027:

- Masa 3.2.1 Krijimi i modeleve të reja ekonometrike për analizimin e të dhënave.
- Masa 3.2.2. Analizimi më i detajuar i të dhënave të gatshme në sistemin ASYCUDA World.

Komponenti 3.3 Rritja e investimeve në zhvillimin e sistemeve të IT-së (Teknologjisë së Informacionit)
Synimi i këtij komponenti është që brenda vitit 2027 të jenë kryer zhvillime teknologjike IT për përmirësimin e infrastrukturës aktuale të administratës doganore.
Masat për vitet 2024–2027:

- Masa 3.3.1 Zhvillime IT për uljen e kohës së procesimit të çdo kërkesë nga subjektet.

Komponenti 3.4 Zhvillimi dhe zbatimi plotësisht i një kornize integriteti për të ndihmuar në ndërtimin e besimit të komunitetit
Synimi është që brenda vitit 2027 të jetë hartuar dhe të jetë në zbatim një plan gjithëpërfshirës integriteti, me qëllim që të rritet besimi i komunitetit tek administrata doganore.
Masat për vitet 2024–2027 janë:

- Masa 3.4.1 Hartimi dhe miratimi i Planit të Integritetit dhe planit të veprimit;
- Masa 3.4.2 Trajnime të vazhdueshme të punonjësve të administratës doganore;
- Masa 3.4.3 Shmangia e konfliktit të interesit.

Komponenti 3.5 Rritja e numrit të Operatorëve Ekonomikë të Autorizuar
Synimi i këtij komponenti është zhvillimi i Programit për Operatorët Ekonomikë të Autorizuar, me qëllim rritjen e numrit të autorizimeve të dhëna për AEO, si dhe nënshkrimi i një marrëveshjeje për njohje reciproke me BE-në.
Masat për vitet 2024–2027 janë:

- Masa 3.5.1 Sensibilizimi i subjekteve mbi rëndësinë e pasjes së statusit AEO për kompanitë shqiptare.
- Masa 3.5.2 Monitorimi i vazhdueshëm i AEO-ve të miratuara.
- Masa 3.5.3 Nënshkrimi i një marrëveshjeje me BE-në për njohjen reciproke të AEO-ve.

Komponenti 3.6 Implementimi i Dritares së Vetme Kombëtare (National Single Window)
Synimi i këtij komponenti është që brenda vitit 2026 të jetë krijuar Drita e Vetme Kombëtare (National Single Window-NSW)
Masat për vitet 2024–2027 janë:

- Masa 3.6.1 Zhvillimi i konceptit dhe strukturës institucionale të Dritares së Vetme Kombëtare (National Single Window);
- Masa 3.6.2 Rishikimi dhe ndryshimi i legjislacionit dhe i rregulloreve për Dritaren e Vetme Kombëtare (National Single Window);
- Masa 3.6.3 Zhvillimi dhe vendosja e zgjidhjes së IT-së për Dritaren e Vetme Kombëtare (National Single Window);
- Masa 3.6.4 Drita e Vetme Kombëtare (National Single Window) është plotësisht funksionale.

Komponenti 3.7 Implementimi i Sistemit të Ri të Kompjuterizuar të Transistit (NCTS)
Synimi i këtij komponenti është që Shqipëria të bëhet pjesë e tranzitit Evropian brenda vitit 2027.
Masat për vitet 2024–2027 janë:

- Masa 3.7.1 Arkitektura dhe vendosja e Aplikacionit Kombëtar të Tranzitit dhe Regjistrimi, dhe Identifikimi i Operatorit Ekonomik (EORI) plotësisht në përputhje me EU-NCTS;
- Masa 3.7.2 Implementimi dhe testimi në nivel kombëtar;
- Masa 3.7.3 Aderimi në Konventën Ndërkombëtare të Tranzitit (CTC);
- Masa 3.7.4 Lidhja e sistemit shqiptar me sistemin ndërkombëtar të tranzitit.

Komponenti 3.8 Rritja e bashkëpunimit në luftën kundër informalitetit, kontrabandës, korrupsionit dhe importit të mallrave të falsifikuara
Synimi është që brenda vitit 2027 të jetë rritur bashkëpunimi në luftën kundër informalitetit, kontrabandës, korrupsionit dhe importit të mallrave të falsifikuara.
Masat për vitet 2024–2027 janë:

- Masa 3.8.1 Bashkëpunimi me organet ligjzbatuese për rritjen e kapjeve të mallrave të falsifikuara;
- Masa 3.8.2 Shkëmbimi i informacionit me dogana homologe;
- Masa 3.8.3 Bashkëpunimi me kompanitë importuese për sensibilizimin/regjistrimin/verifikimin e markave origjinuese.

Komponenti 3.9 Zgjerimi i shkëmbimit të informacionit me partnerët vendas dhe ndërkombëtarë për të përmirësuar profilin e riskut.
Synimi në 2027 është që të jetë zgjeruar shkëmbimi i informacionit me partnerët vendas dhe ndërkombëtarë për të përmirësuar profilin e riskut.
Masat për vitet 2024–2027 janë:

- Masa 3.9.1 Trajnimi i vijueshëm i pikave të kontaktit, ekzistuese dhe të reja.

Zbatimi i këtyre masave pritet të ulë kostot e biznesit, lidhur me procedurat doganore, si dhe të gjenerojë të ardhura shtesë në rreth 0.17% e PBB-së ose 4.5 miliardë lekë. Vlerësuar sipas komponentëve, të ardhurat shtesë paraqiten në tabelën më poshtë.

Tabela 18: Të ardhura shtesë nga shtylla 3 “Mirëadministrimi doganor”, sipas komponentëve

Në % të PPB-së

Rritja e të ardhurave doganore	2024	2025	2026	2027	Total 2024–2027
Komponenti 3.1 Modernizimi i proceseve të biznesit, duke përfshirë centralizimin e funksionit të profilizimit të riskut	0.02%	0.02%	0.01%	0.01%	0.05%
Komponenti 3.5 Rritja e numrit të Operatorëve Ekonomikë të Autorizuar	0.02%	0.02%	0.02%		0.06%
Komponenti 3.8 Rritja e bashkëpunimit në luftën kundër informalitetit, kontrabandës, korrupsionit dhe importit të mallrave të falsifikuara	0.01%	0.01%	0.003%	0.003%	0.02%
Zgjerimi i shkëmbimit të informacionit me partnerët vendas dhe ndërkombëtarë për të përmirësuar profilin e riskut	0.01%	0.01%	0.01%	0.01%	0.04%
Total	0.05%	0.06%	0.04%	0.02%	0.17%

VI.2 Komponenti 3.1 Modernizimi i proceseve të biznesit, duke përfshirë centralizimin e funksionit të profilizimit të riskut

Objektivi

Synimi i këtij komponenti është zhvillimi i sistemeve/moduleve të IT-së dhe kapaciteteve të administratës doganore për të rritur efektivitetin në mbledhjen e të ardhurave doganore.

Konteksti

Modernizimi i proceseve të biznesit, duke përfshirë centralizimin e funksionit të profilizimit të riskut do të përfshijë katër masa të rëndësishme:

1. Masa 3.1.1 Përmirësimi i përzgjedhjes së kanaleve të riskut.
2. Masa 3.1.2 Centralizimi i profileve të riskut për të përfshirë edhe akcizën.
3. Masa 3.1.3 Implementimi i lidhjes në kohë reale midis sistemeve *ASYCUDA World* dhe *ASYHUB*.
4. Masa 3.1.4 Fuqizimi i kapaciteteve të punonjësve të AD-së përmes përmirësimit të praktikave të burimeve njerëzore dhe ofrimit të zhvillimit të kapaciteteve.

Përmirësimi i përzgjedhjes së kanaleve të rrezikut

Sistemi Operativ i Menaxhimit të Integruar Doganor i përdorur nga Administrata Doganore Shqiptare është *ASYCUDA World* (AW), që përpunon të gjitha procedurat e tregtisë së jashtme dhe përshpejton zhdoganimin e mallrave nëpërmjet kompjuterizimit të transaksioneve dhe procedurave doganore.

Çdo deklaratë doganore në procedurat e importit, eksportit dhe transitit e regjistruar në sistemin elektronik kalon në Modulin e Selektivitetit të Sistemit Elektronik Doganor (AW).

Sistemi i automatizuar i menaxhimit të rrezikut (RMS) kontribuon për të pasur një ekuilibër të drejtë ndërmjet lehtësisë të tregtisë dhe kontroleve doganore.

Kontrollet doganore të bazuara në analizën e rrezikut kryhen përmes Modulit të Selektivitetit të Sistemit Elektronik Doganor *ASYCUDA World*. Ky modul është një mjedis i automatizuar që mundëson një selektivitet të bazuar në rrezik për të gjitha importet, eksportet dhe transitet. Sistemi krahason automatikisht një grup të caktuar të dhënash (p.sh. nga një deklaratë mallrash) me të gjitha profilet aktuale të rrezikut.

Çdo deklaratë doganore e regjistruar në Sistemin Elektronik kalon në Modulin e Selektivitetit. Bazuar ose në kriteret e përzgjedhjes në nivel kombëtar/vendor ose në mënyrë të rastësishme, sistemi automatikisht do të sigurojë një kanal përzgjedhjeje (kuqe/verdhë/jeshile) në një deklaratë doganore. Moduli i Selektivitetit zgjedh për kontroll sipas niveleve të përcaktuara të rrezikut.

Ky sistem kontrolli i targetimit përbëhet nga profile specifike rreziku dhe përzgjedhje të rastësishme, të cilat përzgjedhin deklaratat doganore sipas një kanali të caktuar, për t'iu nënshtruar më pas një kontrolli specifik.

Llojet e profileve të rrezikut në modulin e selektivitetit AW janë: profile specifike dhe profile të rastësishme

Profilet specifike

Këto profile përbëhen nga një ose një kombinim treguesish që synojnë përzgjedhjen e ngarkesave ose mjeteve të caktuara të transportit që kërkojnë më shumë vëmendje nga Dogana.

Profilet e rastësishme

Ndihmoni në zbulimin e rreziqeve të panjohura dhe duhet të ekzistojë, gjithmonë, aty ku nuk ka profile specifike. Në parametrat e selektivitetit, për çdo kanal përzgjedhjeje përcaktohet koeficienti “shkalla minimale e rastësishme”.

Aktualisht, kemi rreth 28% e deklaratave doganore procesohen duke qenë në kanal të gjelbër, e cila është plotësisht në përputhje me objektivin tonë. Nëpërmjet masave që do të ndërmerren në këtë Strategji, synohet të rritet përqindja e shfrytëzimit të kanalit të gjelbër me rreth 33%.

Centralizimi i profileve të riskut për të përfshirë edhe akcizën për produktet vendase të akcizës

Moduli aktual i Përzgjedhjes në sistemin ASYCUDA *World* nuk mundëson përzgjedhjen me risk në fushën e prodhimit vendase të akcizës, përveçse për mallrat në import. Profilizimi i riskut është i centralizuar, megjithëse sistemi mundëson edhe krijimin e profileve lokale të riskut. Sidoqoftë, meqenëse ‘centralizimi’ nënkupton përfshirjen e fushës së akcizës në të njëjtin Moduli të Përzgjedhjes/Selektivitetit (njëlloj si për profilet e importit të mallrave të akcizës), administrata doganore po punon aktualisht për zbatimin e modulit të rrezikut në fushën e produkteve vendase të akcizës, duke qenë kështu në përputhje me këtë masë shpresojmë brenda vitit 2024 ose më së voni brenda tremujorit të parë të vitit 2025.

Implementimi i lidhjes në kohë reale midis ASYCUDA *World* dhe ASYHUB

Administrata doganore do të vazhdojë të ketë si një nga synimet dhe prioritetet kryesore, modernizimin e procedurave doganore si pjesë e strategjisë sonë afatgjatë, duke u fokusuar kështu në ngritjen e kapaciteteve dhe zhvillimet e TI-së, mbetet vendimtar për ne. Gjatë viteve të fundit janë realizuar zhvillime të rëndësishme në sistem që kanë modernizuar proceset e biznesit, të tilla si:

1. Implementimi në *web* nëpërmjet *e-Albania* i të dhënave personale të biznesit si: statusi i deklaratës doganore, statusi i tranzitit, statusi i pagesës dhe gjendja e llogarisë bankare.

2. Implementimi në sistem i plumbosjes doganore, si një proces që ka përfunduar.

3. Implementimi i AEO-s në sistem, proces tashmë i përfunduar. UNCTAD-i ka vënë në dispozicion një demo në ambientin test *Ayycuda*, i cili është në fazë testimi nga DPD-ja. Nga UNCTAD-i nevojitet të bëhen disa ndryshime deri në implementimin e plotë të këtij zhvillimi.

Në këtë drejtim, do të fillohet të fillojmë të pilotohet ASYHUB për përpunimin para mbërritjes dhe para nisjes së ngarkesave detare për shkëmbimin digjital B2G (biznes ndaj qeverisë) midis sistemeve TIK të ofruesve të të dhënave të anijes dhe sistemeve ASYCUDA *World* në Shqipëri. Njësitë e kontrollit të portit do të jenë më pas në gjendje të kryejnë vlerësimin e rrezikut dhe të përpunojnë të dhënat paraprake të ngarkesave me synimin për të menaxhuar në mënyrë më efektive lëvizjen ndërkufitare të mallrave të rrezikshme dhe/ose të paligjshme, të përgatisin vendimin e lirim të përpara se mallrat të mbërrijnë në portin e hyrjes/portin e daljes, duke mundur kështu lirin e mallit të zhdoganuar menjëherë pas mbërritjes.

Ky projekt do të finalizohet brenda kohëzgjatjes së strategjisë.

Brenda kohëzgjatjes së strategjisë, do të finalizohet implementimi i lidhjes në kohë reale midis ASYCUDA *World* dhe ASYHUB, sistem i cili bën identifikimin e kontejnerëve që në momentin e nisjes nga çdo port në botë.

Fuqizimi i kapaciteteve të punonjësve të AD-së përmes përmirësimit të praktikave të burimeve njerëzore dhe ofrimit të zhvillimit të kapaciteteve.

Administrata doganore i ka kushtuar një rëndësi të veçantë trajnimit dhe ritrajnimit të stafit për të rritur profesionalizmin dhe aftësitë bashkëkohore. Në zbatim të programit vjetor të miratuar me QTATD (Qendra e Trajnimeve të Administratës Tatimore dhe Doganore) për rritjen e aftësisë profesionale dhe në përputhje me nevojat e punonjësve, është zbatuar Programi i Trajnimeve sipas Kalendarit të aprovuar me QTATD-në. Sipas Kalendarit vjetor të miratuar:

1. Për target grupin “Nivelin funksional të Administratës Doganore” janë zhvilluar 10 tematika ku janë trajnuar 180 punonjës.

2. Për target grupin “Nivelin vazhduar të Administratës Doganore” janë zhvilluar 5 tematika ku janë trajnuar 85 punonjës.

3. Për target grupin “Punonjësit e rinj” pritet përfundimi i procesit të rekrutimit për të zhvilluar 17 tematikat e planifikuara.

Gjithashtu, janë zhvilluar 13 tematika në bashkëpunim me institucione të tjera me pjesëmarrjen e 240 punonjësve të ADSH-së.

Prioritetet:

Prioritetet për periudhën 2024–2027 janë:

- Rritja e përdorimit të kanalit të gjelbër;
- Administrimi më i mirë i akcizës përmes sistemeve të riskut;
- Zhvillimi i sistemeve/moduleve IT që rrisin efektivitetin e administratës doganore;
- Rritja e kapaciteteve të burimeve njerëzore tek administrata doganore.

Masat dhe aktivitetet

Masa	Aktivitetet	Fillimi	Mbarimi	Institucioni përgjegjës
Masa 3.1.1 Përmirësimi i përzgjedhjes së kanaleve të riskut	Aktiviteti 3.1.1.1: Përfshirja e më shumë kompanive në kanalën jeshil Aktiviteti 3.1.1.2: Dhënia prioritet e kompanive të besueshme Aktiviteti 3.1.1.3: Rishqyrtimi i kriterëve të riskut	2024	2024	DPD/Drejtoria e Riskut
Masa 3.1.2 Centralizimi i profileve të riskut për të përfshirë edhe akcizën	Aktiviteti 3.1.2.1: Krijimi Teknik i Modelit të Selektivitetit të produkteve vendase të akcizës; Aktiviteti 3.1.2.2: Testimi praktik i Modulit; Aktiviteti 3.1.2.3: Mundësimi i përdorimit të modulit, rindërtimi i profileve të riskut në fushën e akcizës për shtëpiaket (të ndryshme nga importi).	2024	2027	DPD/Drejtoria e Riskut dhe Departamenti i Akcizës
Masa 3.1.3 Implementimi i lidhjes në kohë reale midis ASYCUDA World dhe ASYHUB	Aktiviteti 3.1.3.1: Kryerja e aktivitetëve të lidhura me zhvillimin dhe të shërbimeve të sistemit. Testimi i profileve të rrezikut në sistem. Mbajtja e një MoU me <i>Mariner Company</i> që lejon shkëmbimin e të dhënave	2024	2024	DPD
Masa 3.1.4 Fuqizimi i kapaciteteve të punonjësve të AD-së përmes përmirësimit të praktikave të burimeve njerëzore dhe ofrimit të zhvillimit të kapaciteteve.	Aktiviteti 3.1.4.1: Trajnime të vazhdueshme për punonjësit e administratës doganore	2024	2026	DPD në bashkëpunim me QTATD/Komisioni i KE-së

Treguesit e performancës dhe vlerat e synuara

Treguesi	Vlera bazë viti 2023)	Vlera e synuar			
		2024	2025	2026	2027
Përqindja e shfrytëzimit të kanalit të gjelbër	28%	30%	33%	> 33%	> 33%
Rritja e të ardhurave doganore nga përmirësimi i kanaleve të riskut		0.01% e PBB-së	0.01% e PBB-së	0.005% e PBB-së	0.005% e PBB-së
Rritja e të ardhurave nga zbulimi i shkeljeve në mallrat e akcizës		0.006% e PBB-së	0.008% e PBB-së	0.005% e PBB-së	0.005% e PBB-së

VI.3 Komponenti 3.2 Zhvillimi i aftësive të zgjeruara analitike të të dhënave

Objektivi

Synimi i këtij komponenti është që brenda vitit 2027 administrata doganore të ketë zhvilluar modele makroekonomike që rrisin aftësitë analitike dhe parashikuese të fenomeneve ekonomike.

Konteksti

Aftësitë analitike të administratës doganore janë zgjeruar dhe plotësuar me informacione dhe funksione. Raportimet kryhen në kohë shumë të shkurtër dhe me saktësi të plotë. Gjenerohen raporte analitike të përgjithshme, si edhe raporte specifike për të pasur një pamje të plotë të të gjitha fenomeneve pozitive apo negative në procedurat doganore.

Raportet mujore për analizimin e të ardhurave doganore që prodhon administrata doganore për tregues të caktuar makroekonomikë, si: vëllimi dhe vlera e tregtisë së jashtme sipas produkteve, ndikimet nga kursi i këmbimit dhe ndryshimet në tregjet e brendshme, janë shumë të dobishme dhe duhet të zhvillohen më tej për t'i bërë ato më specifike në analizimin e fenomeneve të të bërit tregti. Bazuar në këto analiza, do të rritet jo vetëm saktësia e parashikimeve të të ardhurave, por edhe evidentimi i fenomeneve ekonomike që lidhen me procedurat e zhdoganimit.

Prioritetet:

Prioritetet për periudhën 2024–2027 janë:

- Krijimi dhe përdorimi i modeleve makroekonomike

Masat dhe aktivitetet

Masa		Fillimi	Mbarimi	Institucioni përgjegjës
Masa 3.2.1 Përditësimi dhe krijimi i modeleve të reja ekonomike për analizimin e të dhënave	Aktiviteti 3.2.1.1: Bashkëpunimi me sektorin IT, si dhe me institucione homologe për krijimin e analizave të reja	2024	2027	DPD/Drejtoria e Statistikës
Masa 3.2.2 Analizim i detajuar i të dhënave të gatshme në sistemin ASYCUDA <i>World</i>	Aktiviteti 3.2.2.1: Formimi i analizave të reja për të konstatuar detaje të cilat mund të sjellin rezultate të reja analitike	2024	2027	DPD/Drejtoria e Statistikës

Treguesit e performancës dhe vlerat e synuara

Treguesi	Vlera bazë(viti 2023)	Vlera e synuar			
		2024	2025	2026	2027
Numri i modeleve makroekonomike që përdor me administrata doganore	1 model që lidhet me analizimin e të ardhurave doganore		Modeli ekzistues është përmirësuar	1 model i ri	-

VI.4 Komponenti 3.3 Rritja e investimeve në zhvillimin e sistemeve të Teknologjisë së Informacionit

Objektivi

Synimi i këtij komponenti është që brenda vitit 2027 të jenë kryer zhvillime teknologjike TI për përmirësimin e infrastrukturës aktuale të administratës doganore.

Konteksti

Baza e sistemeve të teknologjisë dhe informacionit të administratës doganore është ASYCUDA *World*. Automatizimi i procedurave doganave ka përbërë një prioritet të rëndësishëm gjatë viteve të fundit dhe janë bërë përpjekje për të futur dhe përmirësuar sisteme, të tilla si: Sistemi i Ri i Kompjuterizuar i Transitit (NCTS), Sistemi i Integruar i Menaxhimit të Tarifave (ITMS) dhe përmirësimi i moduleve ekzistuese në ASYCUDA *World* (sistemi kryesor në Administratën Doganore). Gjithashtu, ofrimi i shërbimit ndaj operatorëve është përmirësuar për shkak të rinxhinierimit të shumë proceseve, si thjeshtësimi i procedurave dhe futja e menaxhimit doganor pa letra për të thjeshtuar pajtueshmërinë. Këto ndryshime rezultuan në përmirësimin e procedurave doganore *online*, reduktimin e kohës së përpunimit doganor dhe rritjen e përdorimit të vlerësimit të riskut.

Vazhdimi i zhvillimeve në TI do të krijojë të gjitha kushtet që ASYCUDA *World* të bashkëveprojë me të gjitha risitë që preken, me qëllim që zhvillimet të jenë në funksion të efikasitetit dhe eficiencës së administratës doganore. Ulja e kohës së procesimit është e lidhur me të gjitha risitë dhe futjen *online* të shërbimeve.

Prioritetet:

Prioritetet për periudhën 2024–2027 janë:
- Përmirësimi i moduleve.

Masat dhe aktivitetet

Masa	Aktiviteti	Fillimi	Mbarimi	Institucioni përgjegjës
Masa 3.3.1 Zhvillime IT për uljen e kohës së procesimit të çdo kërkesë nga subjektet	Aktiviteti 3.3.1.1: Përmirësimi i moduleve dhe zhvillimi i moduleve të reja në rast nevojë	2024	2027	DPD/Drejtoria IT AKSHI

Treguesit e performancës dhe vlerat e synuara

Treguesi	Vlera bazë (viti 2023)	Vlera e synuar			
		2024	2025	2026	2027
Koha e përpunimit të deklaratës doganore	99.1 minuta	Trend rënës	Trend rënës	Trend rënës	Trend rënës

VI.5 Komponenti 3.4 Zhvillimi dhe zbatimi plotësisht i një kornizë integriteti për të ndihmuar në ndërtimin e besimit të komunitetit

Objektivi

Synimi është që brenda vitit 2027 të jetë hartuar dhe të jetë në zbatim një plan gjithëpërfshirës integriteti, me qëllim që të rritet besimi i komunitetit tek administrata doganore.

Konteksti

Drejtoria e Antikorrupsionit dhe Standardeve Profesionale është në funksion prej 10 vitesh dhe janë vendosur shtylla të rëndësishme të kornizës së integritetit për stafin e administratës doganore, si: Kodi i Etikës, Deklarata për Konfliktin e Interesit, linjë telefonike për raportimin e rasteve të korrupsionit, etj.

Rritja e niveleve të integritetit brenda administratës doganore është një element i rëndësishëm në ndërtimin e besimit të komunitetit. Drejtoria e Antikorrupsionit dhe Standardeve Profesionale është trajnuar me qëllim që të përcaktojë, komunikojë dhe promovojë standardet.

Administrata doganore do të vazhdojë të ketë në fokus zhvillimin e një kornize më gjithëpërfshirëse të sigurimit të integritetit që përcakton, komunikon dhe promovon standardet e sjelljes; monitoron dhe zbaton ato standarde, korrigjon gabimet; vlerëson dhe raporton mbi rezultatet e punës së çdo inspektori. Gjithashtu, nëpërmjet një personeli të trajnuar, DPD-ja do të monitorojë zbatimin e standardeve dhe të raportoje apo të korrigjojë gabimet.

Bashkëpunimi me shoqatat e biznesit, shoqërinë civile, zbatimi i vetëkontrollit dhe rishikimeve të ndërsjella nga punonjësit, publikimi i informacionit, lidhur me integritetin dhe matja e rregullt e niveleve dhe tendencave në perceptimin e korrupsionit doganor janë përbërës të dobishëm në forcimin e besimit të komunitetit. Për këtë arsye, Drejtoria e Antikorrupsionit është përfshirë në hartimin e planit të integritetit me urdhrin e drejtorit të përgjithshëm nr. 80, datë 26.10.2023, i cili do të hartohet brenda vitit 2026.

Prioritetet:

Prioritetet për periudhën 2024–2027 janë:

1. Rritja e besimit të komunitetit tek administrata doganore.
2. Hartimi dhe miratimi i Planit të Integritetit brenda vitit 2026.

Masat dhe aktivitetet

Masa	Aktiviteti	Fillimi	Mbarimi	Institucioni përgjegjës
Masa 3.4.1 Hartimi dhe miratimi i Planit të Integritetit dhe planit të veprimit	Aktiviteti 3.4.1.1: Hartimi dhe miratimi i Planit të Integritetit dhe planit të veprimit me urdhrë të DPD-së	2024	2026	DPD
Masa 3.4.2 Trajtime të vazhdueshme për punonjësit e administratës doganore – përfshirja në trajnime të specialistëve nga institucione të ndryshme, si Prokurori/Gjykata/Universitete etj.	Aktiviteti 3.4.2.1: Trajtime të dhëna nga specialistë nga institucione të ndryshme, si Prokurori/Gjykata/Universitete, etj.	2024	2027	DPD në bashkëpunim me Prokurori/Gjykata/Universitete/ /Komisionin e KE-së
Masa 3.4.3 Shmangia e konfliktit të interesit	Aktiviteti 3.4.3.1: Organizimi i trajnimeve të dedikuara mbi shmangien e konfliktit të interesit me pedagogë universiteti/specialist të ILDKPI-së /punonjës me eksperiencë të DPD-së	2024	2027	DPD në bashkëpunim me Universitetet dhe ILDKP-në

Treguesit e performancës dhe vlerat e synuara

Treguesi	Vlera bazë (viti 2023)	Vlera e synuar			
		2024	2025	2026	2027
Miratimi i Planit të Integritetit dhe planit të veprimit		-	-	Plani është hartuar	-
Numri i trajnimeve të zhvilluara	18 trajnime	Trend rritës	Trend rritës	Trend rritës	Trend rritës

VI.6 Komponenti 3.5 Rritja e numrit të Operatorëve Ekonomikë të Autorizuar

Objekti

Synimi i këtij komponenti është zhvillimi i Programit të Operatorit Ekonomik të Autorizuar, me qëllim rritjen e numrit të autorizimeve të dhëna për OEA-në dhe rritjen e flukseve të shkëmbimeve tregtare dhe nënshkrim i një marrëveshjeve për njohje reciproke me BE-në.

Konteksti

Shqipëria ka përafruar gjerësisht legjislacionin doganor me *acquis* të BE-së në fushën doganore dhe, gjithashtu, ka avancuar me zbatimin e programit të Operatorëve Ekonomikë të Autorizuar (OEA) duke autorizuar operatorët e parë ekonomikë në vitin 2021.

Legjislacioni doganor për Operatorët Ekonomikë të Autorizuar është i njëjtë me atë të BE-së dhe në vitin 2020 ka miratuar udhëzuesin “Për zbatimin praktik të procedurave për aplikimin, miratimin, funksionimin dhe mbikëqyrjen e thjeshtimeve doganore dhe Operatorët Ekonomikë të Autorizuar”, i cili është plotësisht në përputhje me direktivën nr. 6, të udhëzimeve të BE-së për OEA-në.

Në vitin 2021, Dogana Shqiptare i ka dorëzuar zyrtarisht Sekretariatit të CEFTA-s kërkesën për Njohje Reciproke të Programit të OEA-së.

CEFTA mori në konsideratë kërkesën e paraqitur nga Administrata Doganore, duke bërë të mundur dërgimin e ekipit të Validimit në Shqipëri nga data 7–10 qershor 2022. Pas një kontrolli të detajuar të dokumentacionit që vërteton procedurën e autorizimit, Grupi i Validimit të CEFTA-s (pjesëmarrës Kosova, Serbia, Mal i Zi, Bosnjë, Moldavi, Maqedonia e Veriut) me këshilltarë nga DG TAXUD arritën në përfundimin se:

- Dogana ka zbatuar dhe vënë në funksion Autorizimin dhe Monitorimin e OEA-së.
- Programi Shqiptar i OEA-së plotëson pritshmëritë dhe kriteret e Protokollit Shtesë 5 të CEFTA-s dhe është në përputhje me standardet e Programit të BE-së për OEA-në dhe (WCO).
- Ekipi i Validimit të CEFTA-s do t'i japë një opinion pozitiv Komitetit të Lehtësimit të Tregtisë së CEFTA-s dhe do t'i rekomandojë Komitetit të Përbashkët të CEFTA-s (Komiteti i Përbashkët) Njohjen e Përbashkët të Programit OEA të Shqipërisë.

Shqipëria ka nënshkruar, gjithashtu, 2 marrëveshje për Njohjen e ndërsjellë të OEA-ve me Serbinë dhe Maqedoninë e Veriut.

Nënshkrimi i një marrëveshjeje me BE-në për njohjen reciproke të OEA-ve do të jetë një hap i rëndësishëm për OEA-në shqiptare.

Aktualisht janë miratuar 16 operatorë ekonomikë të autorizuar nga 22 aplikacione të dorëzuara për këtë qëllim dhe në vazhdimësi po ndiqen politika promovuese për të rritur interesimin për të pasur më shumë aplikacione.

Prioritetet

Prioritetet për periudhën 2024–2027 janë:

- Rritja e numrit të autorizimeve OEA.
- Marrëveshje me BE-në për njohjen reciproke të OEA-ve.

Masat dhe aktivitetet

Masa	Aktivitetet	Fillimi	Mbarimi	Institucioni përgjegjës
Masa 3.5.1 Sensibilizimi i subjekteve mbi rëndësinë e pasjes së statusit OEA për kompanitë shqiptare	Organizimi i fushatave informuese dhe aktiviteteve të ndryshme promovuese të OEA-ve	2024	2027	DPD
Masa 3.5.2 Monitorimi i vazhdueshëm i OEA-ve të miratuara	Kryerja e auditimeve të operatorëve të autorizuar ekonomikë	2024	2027	DPD
Masa 3.5.3 Nënshkrimi i një marrëveshjeje me BE-në për njohjen reciproke të OEA-ve	Negocimi dhe nënshkrimi i marrëveshjes		2026	DPD në bashkëpunim me MF-në, MEPJ-në dhe Shërbimet e Komisionit Evropian

Treguesit e performancës dhe vlerat e synuara

Treguesi	Vlera bazë (viti 2023)	Vlera e synuar			
		2024	2025	2026	2027
Rritja e numrit të subjekteve që përfitojnë statusin OEA	13	16	Trend rritës	Trend rritës	Trend rritës
Rritja e të ardhurave doganore nga OEA		0.02% e PPB-së	0.02% e PPB-së	0.02% e PPB-së	
Numri i OEA-ve të audituara		3 auditime	4 auditime	3 auditime	3 auditime
Marrëveshje për njohjen reciproke me BE-në				Marrëveshja është hartuar dhe nënshkruar	

VI.7 Komponenti 3.6 Implementimi i Dritares së Vetme Kombëtare (*National Single Window*)

Objektivi

Brenda vitit 2026 të jetë krijuar Dritarja e Vetme Kombëtare (*National Single Window*-NSW)

Konteksti

Lidhur me Komponentin NSW, më 14 tetor CFCU-ja në Ministrinë e Financave ka publikuar procedurën e tenderit për Aktivitetin wBTTF-ALB-112CDEF “Zgjidhja në dorë e projektit të zbatimit të kontratës NSW”. Ky publikim do të jetë deri më 10 dhjetor 2024. Është ngritur Komisioni i Vlerësimit të Ofertave për këtë qëllim.

Konsulenti IOS& Epes që është përgjegjës për aktivitetin WBTTF-ALB-111AB-112AB–“dizenjimi i projektit, specifikimet teknike, mbikëqyrja dhe siguri i cilësisë së zbatimit të dritares së vetme kombëtare (NSW) në Shqipëri (Kontrata PSQA)” ka dorëzuar detyrën 4 “Ndrysho Strategjia e Menaxhimit dhe Plani i Ngritjes së Kapaciteteve për Mbikëqyrjen e projektit për Mbështetjen e Menaxhimit dhe sigurimin e cilësisë të zbatimit të NSW në Shqipëri”, kur miratohet nga Përfituesi dhe Banka Botërore.

Dritarja e Vetme Kombëtare (*National Single Window*) bën të mundur komunikimin elektronikisht midis autoriteteve doganore dhe të gjitha institucioneve kombëtare që lëshojnë leje, licenca, autorizime etj., të cilat janë të domosdoshme për kryerjen e procedurave doganore në import-eksportin e mallrave. Kjo sjell uljen e kohës së zhdoganimit, uljen e kostove për bizneset, lehtësi dhe transparencë. Sipas vlerësimeve të Bankës Botërore, kostot tregtare ulen me 10%.

Prioritetet:

Prioritetet për periudhën 2024–2027 janë:

- Implementimi i Dritares së Vetme Kombëtare (*National Single Window*) brenda vitit 2026.

Masat dhe aktivitetet

Masa	Aktivitetet	Fillimi	Mbarimi	Institucioni përgjegjës
Masa 3.6.1 Zhvillimi i konceptit dhe strukturës institucionale të Dritares së Vetme Kombëtare (<i>National Single Window</i>)	Aktiviteti 3.6.1.1: Përzgjidhja e kompanisë që do të kryejë aplikimin teknik	2024	Qershor 2024	Banka Botërore
Masa 3.6.2 Rishikimi dhe ndryshimi i legjislationit dhe i rregulloreve për Dritaren e Vetme Kombëtare (<i>National Single Window</i>)	Aktiviteti 3.6.2.1: Hartimi dhe miratimi i paketës ligjore	2024	2026	Njësia e Menaxhimit të Projektit DPD/ (PIU)
Masa 3.6.3 Zhvillimi dhe vendosja e zgjidhjes së TI-së për Dritaren e Vetme Kombëtare (<i>National Single Window</i>)	Aktiviteti 3.6.3.1: Zhvillimi/instalimi/Testimi i plotë i programit nga kompania kryen të gjitha veprimet për një program funksional	2025	2026	Banka Botërore/DPD/ AKSHI dhe institucione të tjera të përfshira
Masa 3.6.4 Dritarja e Vetme Kombëtare (<i>National Single Window</i>) është plotësisht funksionale	Aktiviteti 3.6.4.1: Kryerja e gjithë aplikimeve të mundshme që Dritarja e Vetme (<i>National Single Window</i>) quhet e realizuar	2026	2027	Banka Botërore/DPD/ AKSHI dhe institucione të tjera të përfshira

Treguesit e performancës dhe vlerat e synuara

Treguesi	Vlera bazë (viti)	Vlera e synuar			
		2024	2025	2026	2027
Dritarja e Vetme Kombëtare (<i>National Single Window</i>)		-	-	Krijuar	-

VI.8 Komponenti 3.7 Implementimi i Sistemit të Ri të Kompjuterizuara të Transisit (NCTS)

Objektivi

Synimi i këtij komponenti është që Shqipëria të bëhet pjesë e tranzitit Evropian brenda vitit 2027.

Konteksti

Sistemi i Ri i Kompjuterizuar i Tranzitit (NCTS) është thelbësor për të siguruar kontrollin e lëvizjeve tranzit në të gjithë territorin e Komunitetit. Aderimi në Konventën e Tranzitit të Përbashkët është një kusht për anëtarësimin në BE. Deri në atë datë, aplikacioni i Tranzitit Kombëtar, plotësisht i pajtueshëm me NCTS duhet të jetë i disponueshëm për Shqipërinë. Kjo do të thotë që sistemi IT të jetë plotësisht i testuar në mënyra kombëtare dhe ndërkombëtare.

Aktualisht, statusi i aktivitetit që lidhet me zhvillimin dhe zbatimin e Sistemit të Përbashkët të Transisit NCTS P5 është si më poshtë:

Banka Botërore/Ministria e Financave ka nënshkruar kontratën me kompaninë fituese “*Net Company/Intrasoft*” në qershor 2024, me tenderin e vetëm të produktit Soft, pasi pajisjet dhe rrjeti i produkteve *hard* do të sigurohen nga institucioni. të AKSHI-it.

Në bashkëpunim me kompaninë që do të zbatojë sistemin NCTS, me konsulencën e një eksperti ndërkombëtar dhe PIU-në (njësia e zbatimit të projektit), administrata doganore po harton dokumentin me specifikimet teknike kombëtare, ka miratuar urdhrin për krijimin e grupit të punës që do të marrë pjesë në këtë proces gjatë të gjithë fazës së zbatimit dhe ka përgatitur dokumentin NCTS

P5 të NPP “Plani Kombëtar i Projektit dhe Strategjia e IT-së” dhe e dërgon atë në Drejtorinë e Përgjithshme *Taxud* të Komisionit Evropian.

Kompania zbatuese ka nisur me instalimin në mjedisin e testimit të sistemit ERMIS (NCTS).

Prioritetet:

Prioritetet për periudhën 2024–2027 janë:

- NCTS-ja është funksionale në 2026 dhe Shqipëria bëhet pjesë e tranzitit Evropian brenda vitit 2027

Masat dhe aktivitetet

Masa	Aktiviteti	Fillimi	Mbarimi	Institucioni përgjegjës
Masa 3.7.1 Arkitektura dhe vendosja e Aplikacionit Kombëtar të Tranzitit dhe Regjistrimi dhe Identifikimi i Operatorit Ekonomik (EORI) plotësisht në përputhje me EU-NCTS		2024	Qershor 2026	Banka Botërore/DPD/AKSHI
Masa 3.7.2 Implementimi dhe testimi në nivel kombëtar	Aktiviteti 3.7.2.1: Kryerja e testeve që të japin rezultatin final të punës së kompanisë zbatuese	2026	2027	Banka Botërore/DPD/AKSHI
Masa 3.7.3 Aderimi në Konventën Ndërkombëtare të Tranzitit (CTC)		2027	Në vazhdim	Banka Botërore/DPD/AKSHI
Masa 3.7.4 Lidhja e sistemit shqiptar me sistemin ndërkombëtar	Aktiviteti 3.7.4.1: Zhvillim i mëtejshëm i mjedisit të TI-së të NCTS Aktiviteti 3.7.4.2: Kryerja e ndërlidhjeve mes sistemeve	2027	Në vazhdim	Banka Botërore/DPD/AKSHI

Treguesit e performancës dhe vlerat e synuara

Treguesi	Vlera bazë (viti)	Vlera e synuar			
		2024	2025	2026	2027
Sistemi i Ri i Kompjuterizuar i Tranzitit (NCTS)				NCTS funksional	

VI.9 Komponenti 3.8 Rritja e bashkëpunimit në luftën kundër informalitetit, kontrabandës, korrupsionit dhe importit të mallrave të falsifikuara

Objektivi

Synimi në 2027 është që brenda vitit 2027 të jetë rritur bashkëpunimi në luftën kundër informalitetit, kontrabandës, korrupsionit dhe importit të mallrave të falsifikuara.

Konteksti

Administrata Doganore Shqiptare në kuadër të misionit fiskal, ekonomik dhe mbrojtës ka për detyrë mbrojtjen e të drejtave të pronësisë intelektuale me qëllim:

- Mbrojtjen e ambientit të biznesit të cilët janë mbajtës dhe/ose përdorues të një të drejte të pronësisë intelektuale nga konkurrenca e pandershme;
- Mbrojtjen e konsumatorit dhe shëndetit publik nga mallra të falsifikuara/piratë për pasojat që shkaktojnë;
- Kufizimin e mundshëm të humbjeve të të ardhurave në buxhetin e shtetit që vijnë si pasojë e mallrave që cenojnë një të drejtë të pronësisë intelektuale.

Për këto arsye, vitet në vijim do të kenë një fokus të shtuar në këtë drejtim.

Prioritetet:

Prioritetet për periudhën 2024–2027 janë:

- Brenda vitit 2027 të jetë rritur bashkëpunimi në luftën kundër informalitetit, kontrabandës, korrupsionit dhe importit të mallrave të falsifikuara.

Në kuadër të ngritjes së kapaciteteve administrative, Drejtoria për Mbrojtjen e Pronësisë Intelektuale, së bashku me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, kanë organizuar disa trajnime në dogana të ndryshme. Këto trajnime janë organizuar së bashku me mbajtësit e të drejtave të “Procter & Gamble”, Gucci, Lacoste dhe Gant, lidhur me kontrollin fizik nga doganierët, në të cilat kanë sqaruar detajet që dallojnë mallin origjinal nga ai i falsifikuar.

Masat dhe aktivitetet

Masa	Fillimi	Mbarimi	Institucioni përgjegjës
Masa 3.8.1 Bashkëpunimit me organet ligjzbatuese për rritjen e kapjeve të mallrave të falsifikuara	2024	2027	DPD/Drejtoria e Markave dhe Patentave

Masa 3.8.2 Shkëmbimi i informacionit me doganat homologe	2024	2027	DPD/Drejtoria e Markave dhe Patentave
Masa 3.8.3 Bashkëpunimi me kompanitë importuese për sensibilizimin/regjistrimin/verifikimin e markave origjinuese	2024	2027	DPD/Drejtoria e Markave dhe Patentave

Treguesit e performancës dhe vlerat e synuara

Treguesi	Vlera bazë (viti)	Vlera e synuar			
		2024	2025	2026	2027
Rritja e kapjeve të mallrave të falsifikuar për të siguruar tregti të ndershme dhe me vlerë reale të materialit/punës/tregut		0.01% e PBB-së	0.01% e PBB-së	0.003% e PBB-së	0.003% e PBB-së

VI.10 Komponenti 3.9. Zgjerimi i shkëmbimit të informacionit me partnerët vendas dhe ndërkombëtarë për të përmirësuar profilin e riskut

Objektivi

Zgjerimi i shkëmbimit të informacionit me partnerët vendas dhe ndërkombëtarë për të përmirësuar profilin e riskut.

Konteksti

Aktualisht DPD-ja ka marrëveshje bashkëpunimi me disa institucione ligjzbatuese. Në shtator 2022 u nënshkrua marrëveshja për shkëmbimin e të dhënave me administratën doganore italiane. Platforma SEED është në përdorim për shkëmbimin e informacionit me administratat doganore të palëve CEFTA. Funksionimi i shkëmbimit të informacionit ndërmjet palëve të CEFTA-s në zbatim të parashikimeve të Protokollit Shtesë 5 të kësaj marrëveshje do të ndikojë pozitivisht në arritjen e këtij objekti.

Me synimin për të rritur më tej efikasitetin e profilizimit tonë të rrezikut, duke trajtuar sigurinë ndërkufitare, luftën kundër trafikut të paligjshëm, respektimin e standardeve të Bashkimit Evropian të procedurave doganore dhe lehtësimin e shkëmbimeve tregtare, DPD-ja nga njëra anë dhe Doganat Italiane dhe *Guardia di Finanza* nga ana tjetër, nënshkruan një memorandum të përbashkët më 4 prill 2024, duke përfshirë një program të plotë aktivitetesh për doganierët tanë. Një nga aktivitetet lidhur me këtë protokoll u zhvillua në Shqipëri në maj 2024, misioni i parë “për vlerësimin e mangësive dhe nevojave për analizën e rrezikut”, me pjesëmarrjen e strukturave ligjzbatuese doganore dhe ekspertëve italianë të kësaj fushe.

Të gjitha këto përpjekje janë plotësisht në përputhje me praktikën e mirë ndërkombëtare dhe duhet të ndiqen më tej në veçanti me BE-në, vendet fqinje dhe partnerët kryesorë tregtarë.

DPD-ja ka një oficer ndërlidhës të vendosur në mënyrë të përhershme në Bukuresht dhe të bashkangjitur në Qendrën SELEC. Versioni i Organizatës Botërore të Doganave (OBD) nCEN 3.3.1 ka 39 përdorues në DPD, të cilët po analizojnë, gjithashtu, informacionin përmes Zyrave të Ndërlidhjes së Inteligjencës Rajonale të Organizatës Botërore të Doganave. Aktualisht shkeljet (përveç atyre të raportuara përmes Modulit të Raporteve të Parregullive) pasqyrohen në një sistem të dedikuar RESHDA, i cili përditësohet kur zbulohet shkelja dhe vendimi i duhur merret nga Dega e Doganës.

Funksionimi i sistemit të Rrjetit Kombëtar të Zbatimit të Doganave (nCEN) të Organizatës Botërore të Doganave, i instaluar në DPD, do të ketë një ndikim pozitiv në arritjen e këtij objekti. Shkëmbimi i informacionit do të sjell verifikim më të saktë të vlerave të transaksionit, si edhe rritje të ndërgjegjësimit të subjekteve lidhur me deklarin në doganë.

Bashkëpunimi me Policinë e Shtetit është rritur përmes kontrolleve të përbashkëta në pikat kufitare, si dhe përmes shkëmbimit të informacionit në kohë reale nëpërmjet platformave dhe mjeteve të teknologjisë së informacionit me këto institucione, si dhe me partnerët ndërkombëtarë përmes platformave CENcomm, iArms dhe Siena.

Prioritetet:

Prioritetet për periudhën 2024–2027 janë:

- Rritja e efektivitetit të bashkëpunimit me palët e treta.

Masat dhe aktivitetet

Masa	Fillimi	Mbarimi	Institucioni përgjegjës
Masa 3.9.1 Trajnimi i vijueshëm i pikave të kontaktit ekzistuese dhe të reja	Janar 2024	2027	DPD & Qendra e Trajnimit të Administratës Tatimore dhe Doganore
Masa 3.9.2 Trajnimi i vazhdueshëm për doganierët në bazë të zgjatjes së protokollit me Doganën Italiane dhe <i>Guardia di Finanza</i> edhe për vitin 2025.	Janar 2025	Dhjetor 2025	DPD

Treguesit e performancës dhe vlerat e synuara

Treguesi	Vlera bazë (viti)	Vlera e synuar			
		2024	2025	2026	2027
Rritje e të ardhurave doganore nga zgjerimi i shkëmbimit të informacionit		0.01% e PPB-së	0.01% e PPB-së	0.01% e PPB-së	0.01% e PPB-së

VII. Risqet dhe masat zbutëse

Për të siguruar menaxhimin efektiv të reformave është e domosdoshme një qasje më proaktive për menaxhimin e riskut. Kjo përfshin jo vetëm adresimin e risqeve që lidhen me zbatimin e aktiviteteve, por edhe marrjen parasysh të risqeve të mundshme për objektivat kryesore të Shtyllave dhe komponentëve të tyre përkatës.

Institucionet përgjegjëse sipas shtyllave/komponentëve kanë për detyrë monitorimin e vazhdueshëm të zbatimit të Planit të Veprimit të Strategjisë, me fokus të veçantë në propozimin e masave zbutëse sa herë që materializohen risqet e identifikuar. Më poshtë janë përcaktuar risqet kryesore që lidhen me zbatimin e Strategjisë, të shoqëruara me informacion se si këto sfida mund të zbuten në mënyrë efektive.

Risku politik

- Tranzicionet politike, ndryshimet në udhëheqje ose ndryshimi i prioriteteve mund të rezultojnë në një angazhim të lëkundur ndaj agjendës së reformës. Për të zbutur këtë risk:

- Rritja e ndërgjegjësimit midis liderëve politikë dhe vendimmarrësve kryesorë, në lidhje me rëndësinë dhe përfitimet e reformave të Strategjisë;
- Sigurimi i integritetit të reformave të strategjisë në planet dhe strategjitë më të gjera të qeverisë;
- Kryerja e fushatave të ndërgjegjësimit të publikut për të informuar qytetarët mbi rëndësinë e reformave të strategjisë, duke shfrytëzuar mbështetjen publike për të ndikuar në prioritizimin dhe qëndrueshmërinë politike.

Risqet institucionale

- Kapaciteti dhe aftësitë e pamjaftueshme brenda institucioneve qeveritare paraqesin risqe të konsiderueshme për reformat e parashikuara. Për të zbutur këto risqe:

- MF-ja dhe institucionet e tjera të përfshira janë të përkushtuara për të investuar në një vlerësim gjithëpërfshirës të nevojave për trajnim dhe zhvillimin e programeve të përshtatura të trajnimit;
- Forcimi i bashkëpunimit me partnerët dhe organizatat ndërkombëtare për mbështetje shtesë;
- Mbajtja e angazhimit të vazhdueshëm në investimet e kapitalit njerëzor, duke e njohur atë si thelbësore për ruajtjen e rezultateve pozitive.

Risku ligjor

- Ndryshimet rregullatore të planifikuara vonohen. Për të zbutur këtë risk:
- Krijimi i kanaleve të rregullta të komunikimit me organet përkatëse rregullatore të përfshira në Shtyllat e strategjisë;
- Kërkimi i mbështetjes nga liderët politikë dhe institucionet kyçe për të dhënë prioritet dhe për të lehtësuar zbatimin e ndryshimeve rregullatore;
- Advokimi për rëndësinë e reformave rregullatore në kohë për të arritur objektivat.

Risqet financiare

- Burimet e kufizuara financiare mund të pengojnë zbatimin e reformave gjithëpërfshirëse. Për të zbutur këto risqe:

- Kryerja e një rishikimi të plotë të burimeve të nevojshme për zbatimin e tij;
- Marrja në konsideratë e një qasjeje të zbatimit me faza nëse është e nevojshme;
- Eksplorimi i burimeve alternative të financimit, duke përfshirë financimin e donatorëve ndërkombëtarë.

Risku teknologjik

- Ndërsa një pjesë e rëndësishme e masave mbështeten gjithnjë e më shumë në teknologji, risku i kërcënimeve të sigurisë kibernetike rritet. Për të zbutur këtë risk:
 - Formulimi i një politike gjithëpërfshirëse të sigurisë kibernetike që përshkruan standardet, protokollet dhe udhëzimet për mbrojtjen e sistemeve të informacionit;
 - Theksimi i monitorimit të vazhdueshëm dhe përshtatshmërinë ndaj kërcënimeve në zhvillim si komponentë thelbësorë të një plani të suksesshëm të sigurisë kibernetike.

Risqet sociale

- Konsultimi dhe komunikimi i pamjaftueshëm me palët kryesore të interesit mund të çojë në rezistencë sociale ose keqkuptime. Për të zbutur këtë risk:
 - Angazhimi gjerësisht i palëve të interesuara gjatë procesit të përgatitjes së Strategjisë dhe monitorimit të saj.
 - Vënia në dispozicion për publikut të të gjitha raporteve të monitorimit për të garantuar transparencë dhe për të nxitur besimin.

Tabela e mëposhtme thekson risqet e mundshme të parashikuara në fazën e përgatitjes së Strategjisë dhe do të përbëjë bazën për monitorimin e risqeve.

Tabela 19: Risqet kryesore të mundshme

Vlerësimi i riskut (probabiliteti dhe ndikimi): L = Lartë M = Moderuar U = Ulët	Faktorët kryesorë të riskut						
	Ndryshim e të vonuara ligjore/rr egullative	Sigurimi i pamjaftue shëm financiar	Zhvillimi jo i qëndrueshë m i kapaciteteve të burimeve njerëzore	Disponuesh mëria e pamjaftuesh me e Burimeve Njerëzore	Sfidat e zhvillim it të TI- së ose prokurim it	Dispon ueshmë ria në kohë e AT / mbësht etjes	Koordin im i papërsht atshëm
Shtylla 1: Rishikimi i politikës tatimore							
Rishikimi i politikës tatimore të taksave mbi konsumin	M	U	M	M	U	M	U
Rishikimi i politikës tatimore të taksave direkte	M	M	M	M	U	U	U
Rishikimi i politikës tatimore të taksës mbi pasuritë e paluajtshme	M	L	M	L	L	M	L
Shtylla 2: Mirëadministrimi tatimor							
Zvogëlimi i hendekut të pajtueshmërisë në lidhje me TVSh-në	M	L	M	L	L	M	M
Ulja e pagesave me para në dorë në ekonomi	M	L	M	L	L	M	M
Verifikimi i të ardhurave dhe kontrolli i pasurive të pajustifikuara	M	L	M	L	L	M	M
Zvogëlimi i shmangies tatimore	M	L	M	L	L	M	M
Reduktimi i punës së padeklaruar dhe të nëndeklarimit të pagës reale	M	L	M	L	L	M	M
Reduktimi i kostove të pajtueshmërisë dhe rritja e sigurisë tatimore dhe besimit tek administrata tatimore	M	L	M	L	L	M	M
Përmirësimi i cilësisë së shërbimit të ofruar nga Administrata Tatimore (AT) nëpërmjet zhvillimit të kapaciteteve institucionale të administratës tatimore	M	L	M	L	L	M	M
Shtylla 3: Mirëadministrimi doganor							
Modernizimi i proceseve të biznesit, duke përfshirë centralizimin e funksionit të profilizimit të riskut	M	L	M	L	L	M	M
Zhvillimi i aftësive të zgjeruara analitike të të dhënave	M	L	M	L	L	M	M
Rritja e investimeve në zhvillimin e sistemeve të Teknologjisë së Informacionit	M	L	M	L	L	M	M
Zhvillimi dhe zbatimi plotësisht i një kornize integriteti për të ndihmuar në ndërtimin e besimit të komunitetit	M	L	M	L	L	M	M

Vlerësimi i riskut (probabiliteti dhe ndikimi): L = Lartë M = Moderuar U = Ulët	Faktorët kryesorë të riskut						
	Ndryshim e të vonuara ligjore/rr egullative	Sigurimi i pamjaftue shëm financiar	Zhvillimi jo i qëndrueshë m i kapaciteteve të burimeve njerëzore	Disponuesh mëria e pamjaftuesh me e Burimeve Njerëzore	Sfidat e zhvillim it të TI- së ose prokuri mit	Dispon ueshmë ria në kohë e AT/ mbësht etjes	Koordin im i papërsht atshëm
Rritja e numrit të operatorëve ekonomikë të autorizuar	M	L	M	L	L	M	M
